Lediana Paja

Mëkati i Heshtjes

5 drama

Botimet PRINCI
Titulli: Mëkati i heshtjes
Autor: Lediana Stillo Paja
Redaktor: Lediana Stillo Paja
Dizajni: Shpend Bengu

© Copyright Autori, 2011

Shtypja u krye në shtypshkronjën "Kristalina"
Tiranë, prill 2011

Përmbajtja

Një akt pa fjalë.....5
Spin.....10
Nënë Shpresa dhe fëmijët e saj.....23
Mëkati i heshtjes 36
Requiem për një ëndërr.....61

NJË AKT PA FJALË

Në skenë mbizotëron një gjysëm errësire. Një tog librash janë të hedhura sa andej këndej. Në kuzhinë gjënden dollape të përmbysura dhe cifla pjatash e gotash. Një currilë dheu rrjedh nga lart. Muret janë të plasaritura, pa tavan, më shumë rrënoja ku nuk mund të shkelet. Një gur i madh ndodhet mbi sallonin e pritjes dhe nuk merret vesh nëse është brenda apo jashtë. Pas mureve shihet e njëjta gjë. Gërmadhë kudo.

Njeriu në skenë ka rroba të shkalafitura e të grisura, mezi mbahet në këmbë. Ecën duke iu marrë mentë. Bie. Qëndron ashtu disa sekonda. Hiqet zvarrë deri tek gurri në sallon. Ulet me vështirësi. Sheh përreth. Fiksohet në zbrazëti.

Çohet. Mezi mbahet në këmbë. Sheh këmbët. Lëviz gishtat e këmbëve. Trishtohet. Mbledh duart pas kraharorit. Gishtat e këmbës vazhdojnë të lëvizin. Heq duart nga kraharori dhe sheh këmbët. Këtë rradhë i sheh më pak dhe më indiferent. Mbledh duart kryq. Gishtat e këmbës vazhdojnë të lëvizin. Heq duart nga gjoksi. I sheh me kërcënim. Ato vazhdojnë të luajnë. Ai ulet tek guri. Gishtat vazhdojnë të luajnë. Ai fiksohet pas tyre. I kërcënon me gisht. Ato vazhdojnë të luajnë. Ai sheh gishtin. Vëren duart. Ato dridhen. I bashkon gishtërinjtë. Ato fillojnë të luajnë si dhe këmbët. I ndan me inat. Gishtat e këmbës vazhdojnë të luajnë. Duart kërkojnë të bashkohen. Ai lufton të mos i bashkojë më.

Çohet në këmbë. Fillon të ecë me ngadalë. Gishtat e këmbës nuk lëvizin. Ai kënaqet. Ndalon. Ul kokën poshtë. Gishtat fillojnë të lëvizin. Nevrikoset. Vazhdon të ecë. Sheh rreth e rrotull. Ndalon. Gishtat vazhdojnë të lëvizin. Duart kërkojnë të

takohen. Ai është indiferent. Sheh nga kuzhina. Sheh nga salloni. Sheh gurin ku ishte ulur. Gishtat lëvizin. Duart puthiten. Ai i ndan me zor. I mbështjell pas vehtes. Sheh nga jashtë mureve. E pushton më fort veten.

Sheh me trishtim përreth. Duart i qarkon më shumë pas vehtes. Gishtërinjtë e duarve kërkojnë të takohen. Ato lëvizin me ngadalë. Gishtërinjtë e këmbeve lëvizin. Ai sheh poshtë. Kërkon ti ndajë duart me nervozizëm. Ato vazhdojnë të lëvizi në përpjekje për tu takuar. I shkul me zor nga vetja. Gishtërinjtë e këmbës vazhdojnë të lëvizin. Ai fillon të vrapojë në skenë. Ndalet. Mezi merr frymë. Sheh poshtë këmbët. Gishtat nuk lëvizin. I kërcënon me gisht. Ato nuk lëvizin. Përkulet mbi to. Ato vazhdojnë të mos lëvizin. I sheh me trishtim. Ato s'lëvizin. Fillon të qajë. Ato s'lëvizin. Ai ngre trupin dhe shkon të ulet tek guri. Sheh i përhumbur përreth. Ul kokën poshtë. Gishtat qëndrojne palëvizur. Nxjerr gishtin ti kërcënojë dhe fokusohet mbi të. Gishti qëndron në ajër. Ai ul kokën si fajtor. Gishti fillon të ulet. Dora prek barkun. E perkëdhel. Sheh përreth. Shikimi i tij takon një top të kuq mbi pirgun me dhe. Çohet me hap të shpejtë dhe drejtohet ta marrë. E sheh me nostalgji. Ia fshin dheun me mëngë. E kundron. Ngre syte lart i perhumbur. Sheh sërisht topin. E vërtit nga njëra dorë në tjetrën dhe fokuson shikimin në ajër. Fillon ta përplasë topin në tokë. Më pas e lë të lirë. Topi rrokulliset drejt currilës së dheut. Kthehet ta shohë. Një zhurmë dëgjohet nga jashtë. Mban vesh. Ulet në tokë ta dëgjojë. Asnjë zhurmë nuk ndihet më. Ngrihet në këmbë. Sheh hijen e tij. Trëmbet. Vazhdon ta shohë. Lëviz këmbën. Hija bën të njëjtën gjë. Lëviz dorën. Hija bën po ashtu. Kthehet në ije. Bën sikur ha. Hieja përtypet. Vë dorën në bark. Hieja po ashtu. Ai nënqesh me ironi. Hieja hesht. Ai e fton hijen në vallzim. Hieja

e shoqëron. Mërzitet. Ia heq dorën hijes. Hieja po ashtu. Matet ta gjuajë hijen. Dora e hijes fshihet. Bën sikur e gjuan. Hieja mbetet aty. Bën sikur gjuan veten dhe bie përtokë. Hieja fshihet pas tij. Ai çon kokën ta shohë. Qëndron në gjunjë. Kërkon me sy hijen. Nuk e gjen. Hieja është pas tij. Çohet i mërzitur.

Shkon tek guri. Ulet. Mendohet. Fokusohet në ajër. Çohet dhe shkon në kuzhinë. Fillon të rrëmojë në sirtare. Gjen një thikë. E merr dhe e lë mënjanë. Shkon tek sirtari tjetër. Gjen një pirun dhe një lugë. E merr dhe e lë mënjanë. Shkon tek një sirtar tjetër dhe merr një konservë. Gjen një picetë dhe pasi fshin lugën dhe thikën e vendos në fyt. Hap konservën. Fillon ta presë me delikatesë. Sheh rreth e rrotull dhe vazhdon të përtypet. Aty-këtu përshëndet me kokë në shenjë aprovimi. Pret një copë tjetër dhe e fut në gojë. Vazhdon ta përtypë me delikatesë. Duke parë rreth e rrotull shpreh një pakënaqësi me kokë. Lëshon mbi konservë thikën dhe pirunin. Vë duart në fut. Përpiqet ta godasë shpinën me njerën dorë. Me tjetrën mban me dorë fytin. Çohet. Kërkon sërisht në kabinetet e shkatërruara. Sheh një shishe verë të thyer. Mallënjgjehet dhe dëshpërohet njëkohësisht. E merr në dorë. E sheh me vëmendje. Përqëndrohet në vëndet e thyera. Afron fytyrën dhe sheh brenda saj. Njërin sy e mbyll. E heq shikimin prej saj. E përmbys. Asgjë nuk bie. Sheh me dyshim. E përmbys sërisht. Asgjë nuk bie. E shkund fort me inat. Asgjë nuk bie. E hedh poshtë me inat. Gjysëm shishja thyhet. Reagon menjëherë. Shkon pranë saj. Merr një copë të vogël dhe e përkund. E lë në tokë me ngadalë dhe shkon të ulet sërisht mbi gur. Merr thikën dhe pirunin në dorë. Perkulet mbi kutinë e konservës. Pret një copë tjetër. E fut në gojë. Sheh këmbët. Gishtat fillojnë të lëvizin me ngadalë. Përtypet dhe vazhdon t'i shohë. Gishtat

lëvizin pak më shpejt. Kënaqet dhe pret dhe një kafshatë tjetër. Sheh këmbët.

Gishtat vazhdojnë të lëvizin më shpejt. Pret një copë tjetër. E përtyp. Sheh këmbët me kënaqësi. Gishtat fillojnë të lëvizin më shpejt. Sheh nga konserva. Lë pirunin dhe thikën poshtë. Merr kokën e peshkut dhe e shikon. Fokuson shikimin në sytë e tij. Futet brenda në sytë e tij. Tund kokën pa lëvizur sytë nga peshku. Me një gisht lëmon kokën e peshkut. Me dorën tjeter e mban për gryke. Tund kokën në shenjë aprovimi. Buzëqesh. E afron peshkun afër fytyrës. Bën sikur e kafshon në ajër. Zgërdhihet. E sheh kokën e peshkut me dhimbshuri. E afron. Fokuson shikimin e tij në sytë e peshkut. Duart lëvizin në shenjë proteste me peshkun në majë të gishtërinjve. Ai heq kokën dhe e fsheh sa në një anë shpatulle në tjetrën. Duart qetësohen. Peshku mban qëndrim. Me një gisht heq pak lëkurë nga koka e peshkut. Dora me peshkun s'lëviz. Vazhdon të heqë dhe pak lëkurë. Dora me peshkun s'lëviz. Sa bëhet të heqë dhe pak lëkurë dora lëshon kokën e peshkut poshtë. Ai mërzitet dhe kërcënon me gishtin e dorës tjetër. Gishti i kundërvihet atij. Dora tjetër bëhet gati të mbajë fytin e tij. Gishti i dorës tjetër e perkëdhel në faqe. Ai tmerrohet dhe lëviz me vrap nëpër sallë. Duart qetsohen. Ulen poshtë. Ai ndalon. Sheh duart. Ato rrinë palëvizur. Sheh këmbët. Gishtat nuk lëvizin. Ul kokën i mërzitur. E ngre prapë.

Shkon dhe ec drejt pirgut me dhe. Me një dorë sheshon dheun me gishtin e dorës tjetër pikturon një shtëpizë, një mashkull, një femër dhe një fëmijë. Ai pikturon si fëmijë në rërë. E sheh. Sytë i mbushen me lot. Merr picetën nga gryka dhe fshin lotët. Sheh rretherrotull. Çohet. Fillon të mbledhë gurët shpërndarë përdhe dhe i vendos në bluzë. I lë afër njërit

mur të shtëpisë. Çohet mer dy gurë të tjerë. I lë prapë afër murit. Çohet. Sa bën të marrë dy gurë të tjerë sheh pikturën në dhe. I lë gurët dhe shkon tek piktura. Përqëndohet. I përvidhet. Sheh në ajër. Sheh nga piktura. Sheh përreth. Fshin gruan dhe fëmijën. Sheh përreth. Fshin gjysmën e shtëpisë. Sheh përreth. Fshin mashkullin nga piktura. Ul kokën. Bien perdet.

SPIN

Personazhe:

Një vajzë, 19 vjeç

Një burrë rreth të 40-tave

Vajza vjen rreth e rrotull vetes duke u rrotulluar në skenë. Burri sheh drejt saj me kuriozitet.

Vajza (*duke u rrotulluar*): Fly.. Fly hard! *

Burri: Mos doje të thoje "Live free or Die hard? **

Vajza (*duke u rrotulluar rreth vetes*): Thashë "Fly hard!"

Burri: Pse rrotullohesh kështu?

Vajza: Jam në dietë. Dietë gravitacionale. Si Yoga. Kontroll i mëndjes.

Burri: Aha, paske shkarë me pak fjalë..

Vajza: (*Ndal për pak, i jep një vështrim ironik dhe vazhdon të rrotullohet*) Marrë parasysh se kë kam përballë mund ta quash këtë fakt një të vërtetë të mundshme.

Burri: Po tallesh?

Vajza: Jooo. Po luaj lojën e gravitetit të Tokës në rrotullimin e saj rreth vehtes. Sheh ndonjë problem këtu? Nuk të pëlqen loja ime? Bukur.. Mund të largohesh atëherë!

Burri: Por unë të dua

Vajza: Kësaj po që i thonë shkarje ledhi.

Burri: E dija se nuk më doje...

Vajza: Nuk thashë atë. Thashë se, nëse s'të pëlqen ç'bëj, je i lirë të shkosh.

Burri: Nuk mundem. Graviteti i dashurisë më ka ngrirë këmbët. Shiko. Nuk mund të lëviz. (*Ai përpiqet të lëvizë këmbët duke u sforcuar.)*

Vajza: Oh, i shkreti ti! I shkreti ti "djalosh".

Burri: A mund të ndalësh të lutem?

Vajza: Jo!

* Fluturo.. Fluturo e lirë

** Ose jeto i lirë ose vdis

Burri: Të lutem…

Vajza: Jo!

Burri: Pse nuk më dëgjon kurrë?

Vajza: Infeksion veshi supozoj.

Burri: Ah! Atëherë le të shkojmë tek doktori.

Vajza: Pyet Tokën. Vetëm ajo mund të ta thojë.

Burri: Po tallesh me mua tani?

Vajza: Nëse je duke më pyetur seriozisht, po!

Burri: Më thuaj pse po rrotullohesh?

Vajza: Sepse jam një elektron. Një elektron i lirë. Kupton?

Burri: Mos do të thotë kjo se je duke u praktikuar se si do të më vish rrotull, gjithmonë?

Vajza: Çdo të thuash?

Burri: Që të kujdesesh për mua?!

Vajza: KURRË!

Burri: Hë tani.. E di se më do!

Vajza: Të dua?

Burri: E di se je dhe pak e turpshme!

Vajza: Kjo nuk më sugjeron asnjë lloj force në përbërien e saj. Meqë ra fjala kam vendosur të merrem më shumë me studimin e tyre. Duhet të zbuloj se nga do të rrjedhi forca ime, si grua. Ajo, "NUKLEARJA", për atë e kam fjalën. Me pak fjalë, si të hedhesh zgupthi në tokë speciet si puna jote.

Burri: E çdo të thuash me këtë?

Vajza: Ah, është një fakt i fshehur, nuk mund të ta them.

Burri: Gratë...

Vajza (*duke ngritur zërin*):Çfarë?!

Burri (I frikësuar): … Janë krijesat më të bukura që Zoti ka sjellë në këtë tokë…

Vajza sheh drejt tij me ironi.

Burri (*ul zërin*): Gratë. As mund të…

Vajza: Thuaje, vetem thuaje dhe do ta shohësh çka për të ngjarë.

Burri (*duke filluar të rrotullohet rreth vetes*): Një riversë. Një trekëndësh. Një kon. Një piramidë. Një thesar…

Vajza *(e shokuar*): Pse po rrotullohesh? (*ajo ndalon së rrotulluari*)

Burri: Nuk mund të ta them pse. Është një lojë. Loja e Tokës. Mendoj se tashmë është instaluar në sistemin tim mendor.

Vajza: Është instaluar çfarë?

Burri: Virusi. Loja jote ishte një virus. Ti e di se une jam shumë i lidhur me lojrat në play-station.

Vajza: Ti ke luajtur mëndsh. Më thuaj çfarë sheh?

Burri: Një hije. Vjen rrotull si dhe unë.

Vajza: Ajo është hija jote, idiot.

Burri: Mund të jetë ose jo. Po ndiej një lloj presioni të madh midis meje dhe saj.

Vajza: Do të thuash se po zihesh me hijen tënde?

Burri: (*tendos duart drejt qiellit*): Shpata ime është shumë e rëndë. Ia ndiej peshën në këmbët e mia.

Vajza: Por po e mban me duar. Interesante. Aspak një surprizë….

Burri: As që mund ta mbaj dot, por po vij rrotull, ashtu siç më mësove.

Vajza: Po aktron tamam si një majmun.

Burri: Ç'është ky? Haet? Në fakt mua më thotë këtu: Gabim. Ju po përpiqeni të shfletoni një opsion që do ta hedhë në erë lojën tuaj.

Vajza: O Zot. Paske fshirë gjithë informacionin tokësor?

Burri: Sigurisht. Sa herë që nis një lojë të re të gjitha të mëparshmet prishen.

Vajza: Po tani, çfarë sheh?

Burri: Një vajzë të bukur lart në qiell. Është kaq e bukur. Brilante.

Vajza: Tradhëtar. E dija që kishte për të ndodhur herët a vonë.

Burri: S'mund të bëj dot asgjë. Jam midis parajsës dhe ferrit, tokës doja të thoja. Ajo do të më puthë. Shihe!

Vajza: Si guxon të më flasësh kështu?

Burri: Qenka një lojë dashurie. Hahaha! Tani të paktën e

kuptoj se si po më tradhëtoje dhe mua.

Vajza: Unë?

Burri: Oh gënjeshtarja ime e ëmbël. E sheh? Ajo do të më puthë por forca e gravitetit nuk ndihmon atë por ty.

Vajza: Shko tek ajo pra! Ç'pret? Ja se të ndihmoj dhe unë…

(Sheh përreth dhe gjen nje shkop me të cilin fillon ta gjuajë burrin)

Burri: Ke çmendur?

Vajza: Jo, po përpiqesha të vendosja një tjetër force në rrotullimin tënd kështu mund të humbje disa lidhje me atë të gravitetit.

Burri: Dhe çfarë do të thotë kjo?

Vajza: Me të dëgjuar e kam që shpirtrat nuk kanë peshë.

Burri: Dhe… Ti tani do më vrasësh me një shkarpë? Hahahaha!

Vajza: Kur dashuria ime të duket ferr, ç'pret të bëj tjetër?

Burri: E çdo të thuash me këtë?

Vajza: Gjithmonë vetëm më ke akuzuar se unë të lëndoja.

Burri (*Ndalon së rrotulluari*): Boll pra se shaka po bëja. Sa seriozisht i merr o zot!

Vajza: Aspak. Më thuaj kush është ajo? Kush?

Burri: Nuk jam ende i apasionuar pas ndonjërës, por nëse do …- (ai përpiqet që të fillojë të rrotullohet por vajza shtrëngon shkopin me kërcënim në dorë. Ai qëndron siç është.)

Vajza: Nëse dua unë çfarë?

Burri: Mund të kujdesem rreth kësaj çështjeje.

Vajza: Me vërtet e ke?

Burri: Jo jo. Po tallem.

Vajza: Pse ke kaq frikë prej meje?

Burri: Të gjithë burrat kanë frikë nga gratë e tyre.

Vajza: Huh?! E pse? Ne jemi shumë herë më të pafuqishme se ju. Pastaj ju vetë na keni vendosur emra si lule, trëndafil etj duke personifikuar kështu delikatesen tonë, apo jo?

Burri: Po po. Aty mbahu ti. Por ndonjëherë seç është një si shtrigë që ju hip në çaçkë të kokës dhe ec e prite rezultatin e krijuar…

Vajza: Si kështu? E pamundur.

Burri: Më pyet mua për pse-në?! Pse-në s'e di as Nastradini, do ta di unë…

Vajza: (nënqesh) Mos ka ndonjë forcë përmes të cilës ngjitet kjo shtriga në trupin tim?

Burri: Forcë xhelozie, le ta quajmë.

Vajza: Por jo gravitacionale aman.

Burri: Më vdiqe. Nuk e di. Por e di me siguri që ajo ngjitet në trupin tënd,

(*Vajza sheh trupin e saj*)

Burri: përmes këmbëve të tua,

(*Ajo sheh këmbët*)

Burri: gjoksit tënd,

(*Ajo sheh gjoksin*)

Burri: dhe më pas kapërcen mbi kokën tënde.

(*Ajo fillon të rrotullohet*)

Burri: Të zuri prapë kriza ty?

Vajza: Më ka mbërthyer. Ajo qenka mbi kokën time.

Burri: O idiote, unë po tallesha.

Vajza: Shumë vonë. Ajo po më rrotullon. Mund të them që e ndiej forcën e saj. Është forca që po ëndërroja të gjeja midis elektroneve, të kujtohet? Atë pra, forcën e fshehur.

Burri: Seriozisht e ke?

Vajza: Po.

Burri: Dukesh si budallaqe.

Vajza: (Vazhdon të rrotullohet) Vërtet?

Burri: Po, dukesh shumë budallaqe tani, në këtë moment.

Vajza: E pra. Forca po vepron tangentisht mbi mua. Saktë!

Burri: Saktë çfarë?

Vajza: Dhe po vepron gjithashtu forca gravitacionale. Tashmë po rrotullohem për të ndryshuar fatin tim.

Burri: Çdo të thuash me këtë?

Vajza: Dhe po shpreh një dëshirë që shpresoj të bëhet sa më shpejt e mundur një realitet sa kohë që kjo shtrigë është mbi kokën time.

Burri: I paske lënë shëndetin kësaj bote me një fjalë.

Vajza: E çfarë pastaj?!

(Pauz)

Burri: Ç'po ëndërron aman?

Vajza: Nuk mund të ta them.

Burri: Pse?

Vajza: Nëse ta them do të humb krejt fuqitë e mia.

Burri: Hë pra, se e di se më do.

Vajza: Të dua?

Burri: As që e vë në dyshim!

Vajza: E si e di ti këtë?

Burri: Sepse e pashë se si xhelozove kur të thashë qëpari për puthjen.

Vajza: Burrat janë si erërat. Kudo që të shkojnë do ta gjejne një "qëndrim të shkurtër".

Burri: Nëse vërtet mendon këtë po më fyen inteligjencën. Unë të dashuroj. Fiksoje mirë në tru këtë.

Vajza: Po po. Ti më dashuron aq shumë sa s'mund të më thuash qoftë dhe një sekret tëndin.

Burri: E kam sinqerisht. Të dua shumë. Dhe vërtet që të mendoj si destinacionin tim të përjetshëm.

Vajza: Sapo molla të bierë nga pema drejt dorës tënde, prej forcës gravitacionale, do ta kafshosh dhe do ta hedhësh më pas.

Burri: E vërtetë.

Vajza: Të paktën e aprovon.

Burri: Por ti nuk je një mollë, apo jo?

Vajza: Shijoj si ajo, apo jo?

Burri: A mund të mos rrotullohesh?

Vajza: Jo.

Burri: Ja se të ndaloj unë.

(*Ai shkon drejt saj dhe përpiqet ta puthë. S'mund ta arrijë. Përpiqet përsëri por ajo ende rrotullohet. Merr një karrige dhe tenton sërisht. Ai rrëzohet. Shkon sërisht mbi karrige dhe përpiqet ta puthë. Të dy bien.*)

Burri: Je mirë?

Vajza nuk lëviz.

Burri: Më dëgjon? A je mirë?

Ai e shkund atë. Vajza nuk lëviz..

Burri: O Zot! Ç'të bëra? Po më bëjnë sytë apo po rrjedh gjak prej kokës tënde?

(*Ai e kthen atë mbrapsht dhe I prek lëkurën.)*

Burri: Hmmm. Ç'shije. Sa e ëmbël je!

(*E kthen mbarë*).

Burri: Mund të flasësh?

(*Vendos veshin mbi gjoksin e saj*).

Burri: Nëse nuk do të më flasësh do të shtrihem këtu. Është kaq butë.

Vajza: Idiot, çohu!

Burri: Oh, e dija që po luaje me mua.

Vajza: Nuk po luaj! Më vrave!

Burri: S'është e vërtetë. Unë vetëm sa të ndihmova.

Vajza: Si? Duke kërcyer mbi kokën time e quan ndihmë? Në të kundërt shoh se ke larguar shtrigëzën prej meje.

Burri: Mrekulli.

Vajza: Si do ta gjej tashmë përgjigjen? Si?

(*Ajo fillon të qajë.*)

Burri: Vogëlushe, ishte veç një ëndërr. Nuk ka shtrigëzë mbi trupin tënd. Unë u talla kur të thashë ashtu.

Vajza: Pra nuk ke frikë prej meje?

Burri: S'kam pas kurrë.

Vajza: Atëherë më thuaj pse më the se ke frikë prej shtrigëzës time?

Burri: Po ta them me mijëra herë, po TALLESHA.

Vajza: (*ngrihet*) Duhet ta gjej atë. Ti nuk tallesh kurrë. Për

më tepër pashë se si reagoje ti teksa më flisje për të.

Burri: Për çfarë dreqin po flet se s'po të kupoj.

Vajza: Saktë, çfarë dreqin po më thoje ti mua?

Burri: Unë të pyeta a më doje, vetëm kaq

Vajza: Në djall me gjithë ndienjat. Në djall vafsh dhe ti. Duhet të gjej shtrigëzën.

(*Fillon të kërkojë përreth*)

Vajza: Shtrigëzë, shtrigëzë, ku je ti? Eja…

Burri: Nuk ka nevojë për të, besomë.

Vajza: Saktë. Nuk ka nevojë sepse ti e ke frikë atë.

Burri: Nuk është kjo o zemër.

Vajza: Ajo mund të përdorë një porcion magjik.

Burri: Dhe?

Vajza: Dhe është e vetmja që mund të më thotë çdogjë rreth teje, e për më tepër se pse ti ke frikë dhe çke bërë kundra meje.

Burri: Aty mbaju ti.

Vajza: E shikon? Ka diçka që ti ma ke fshehur dhe fsheh prej kohësh dhe unë nuk di se kujt t'ia vë gishtin.

Burri: O perëndi. Asgjë nuk po të fsheh, o njeri!

Vajza: Të gjithë burrat e fshehin të vërtetën.

Burri: Jo të gjithë dhe jo e gjithë e vërteta mund të thuhet.

Vajza: Pse?

Burri: Sepse unë nuk dua të të lëndoj.

Vajza: Fshehja shkakton më shumë dhimbje se sa e vërteta e hidhur, besomë.

Burri: Por s'kam se si të të them gjëra që skanë të bëjnë me

ne të dy.

Vajza: Atëherë s'kanë pse të më lëndojnë.

Burri: Saktë!

(Pauz)

Vajza: Atëherë pse nuk m'i thua?

Burri: Sepse nuk kanë rëndësi as për mua! O zemër -

Vajza: Por kanë tek unë aman.

Burri: Pse je kaq kurioze xhanëm?

Vajza: Sepse jam një grua!

Burri: E vërtetë!

Vajza: Po s'u bëra unë kurioze, kush do bëhet pastaj? Ti?

Burri: Mirë. Mirë. Kam fjetur vetëm njëherë me Anne.

Vajza: Çfarë?

Burri: Por nuk e dua atë, të dua ty. Isha I dehur.. dhe.. s'munda.. ta menaxhoja zinxhirin.. dhe…

Vajza: Kur ndodhi?

Burri: Javën e kaluar.

Vajza: Çfarë?

Burri: Po. E shikon se çfarë po të bën shtriga?

Vajza: Pse nuk ma ke thenë?

Burri: Sepse s'ka aspak rëndësi.

Vajza: Jo tek unë veç. Tani e kuptoj gjithçka….

Burri: Shtrigëza. Shttt. Është mu lart mbi kokën tënde.

Vajza: Qepe dhe më dëgjo ç'po të them!

Burri: Ajo po përdor një ilaç magjik. Po ta hedh mbi kokë. Iiiiii!

Vajza: Qepe të thashë.

Burri: Oh, ajo do që ti të dukesh e shëmtuar para meje.

Vajza: Ma hiq prej koke, të përgjërohem.

(Burri vendos duart e tij mbi kokën e saj dhe përpiqet të shkulë prej kokës shtrigëzën imagjinare)

Burri: S'mundem!

Vajza: Si munde vallë të ma bëje këtë? E me kë? Me … Anne? Hahahaha! Me atë gomarmashkull? Ç'shaka...

Burri: Jo unë, shtrigëza. Ajo ende është duke përdorur atë ilaç magjik.

Vajza: Pse përpiqesh të më bësh të ndihem e çmëndur?

Burri: Jo unë pra, shtrigëza. Shihe. Ajo po të gjuan.

Vajza tronditet.

Vajza: Agrrrrrrr! Largoju prej meje! Largoju prej meje tani.

Burri: Ajo është ende mbi kokën tënde. Unë e shoh!

Vajza: I poshtër! Si munde vallë të më thoje se më doje? Si mundet të vazhdosh ende të luash me mua?

Burri: Sa e trashë je, për Zotin. Nuk jam unë po të them. Shtrigëza t'i fut këto ide në kokë.

Vajza: Të dëgjova me veshët e mi. Nuk ishte aspak shaka. Pse tallesh ende me mua?

Burri: Nuk po tallem pra. NUK JAM UNË, të thashë. Është shtrigëza.

(*Vajza fillon të rrotullohet*)

Burri: Pse vjen rrotull?

(Vajza nuk flet).

Burri: Më dëgjon?

(Vajza doesn't talk.)

Burri: Oh të lutem, vetëm më fol.

Vajza nuk flet.

Burri: Mos më ler vetëm.

Vajza nuk flet.

Burri: Kam frikë!-

Vajza nuk flet. Ajo vazhdon të rrotullohet dhe ngre drejt qiellit duart e saj.

Burri: Po lutesh?

Vajza nuk flet. Ajo ende rrotullohet me duart e saj të ngritura lart.

Burri: Zot! Po më ndodh sërisht. Po rikthehem në një elektron të pavarur.. si ti. Shih. Po rrotullohem. Po rrotullohemi bashke. E pamundur hë?

Vajza nuk flet. Ajo ende rrotullohet. Burri rrotullohet gjithashtu.

Burri: Kurioziteti yt ka për të më vrarë. Pse ma bëre këtë? Pse?

Të dy rrotullohen. Dritat fillojnë të ulen. Perdet bien.

NËNË SHPRESA DHE FEMIJËT E SAJ

(Titulli është i afërt me dramën e B. Breht – Mother Courage and her children)

Personazhe:

Nëna – një grua rreth të 40-tave

Driloni – fëmija i madh, 13 vjeç

Eva – fëmija e dytë, 11 vjeçe

Dëshira – fëmija e tretë, 9 vjeçe

Eduart – fëmija i katert, 6 vjeç.

Ngjarja zhvillohet në një ish stallë kuajsh. Tre krevate janë vendosur njëri pas tjetrit në këndë. Stalla është relativisht e vogël. Ka një llampë të vendosur në tavan. Një televizor i djegur në një cep të dhomës dhe një tavolinë në mes, shumë e vogël. Dy fëmijët (Driloni dhe Eduarti) rrinë në këmbë tek krevati më i gjërë, përballë me skenën. Dy vajzat e tjera (Eva dhe Dëshira) rrinë në dy krevatet e tjerë, njera tek ana e majtë e skenës, tjetra tek ana e djathtë e saj. Ata rrinë si kukulla mbi krevate. Stalla ka një dritare ku në vënd të xhamave ka qese plastmasi. Në parvazin e dritares, në një gotë bosh, është mbjellë një lule. Skena është e errët. Drita bie mbi nënën e shtrirë në dysheme. Ajo po fle aty. Qetësia e gjumit të saj prishet nga një zhurmë e fuqishme që dëgjohet nga jashtë. Nëna tmerrohet dhe zgohet.

Nënë Shpresa: Ç'po ndodh? Diçka u kris. (*vë veshin në tokë*). Nuk besoj se më kanë bërë veshët. Kërcitjen e tokës e ndiejnë dhe urithat. (*Ulet në skenë, përdhe. Rregullon flokët me dorë.*)

Jetë qënjsh.

(Pauz.)

Urithi i tokës unë, gërmoj me dhëmbët e mia kurrizin e jetës. Kruaj kockat. Ç'të bëj. Krenaria më ka mësuar të mos ta ul kokën dhe kur duhet të lyp. Fëmijët e mi duan të hanë. Ata kanë uri. Çdo natë vë në zjarr ujë për të zier. Do t'u premtoj se do të bëj një supë me pulë e patate. Uji do të zieje. Do i mbaj zgjuar duke u përrallisur me fjale të bukura se kecat do ta ziejnë ujkun një ditë në një kusi të madhe. Ata do t'i zerë gjumi dhe në ëndrra do të hanë kockat e pulës së premtuar. Eh! Ndonjëherë kur çohen nëpër gjumë do t'ju them se supën e kanë ngrënë e se do të duhet të presin për supën e nesërme.

(Pauz. Ajo sheh nga qielli.)

Nuk e di nëse ti ekziston. Madje po marr guximin të ta them hapur se nëse ti ekzsiton duhet të të vije turp për ekzistencen tënde!

(Pauz)

Duket se vrima në ujë di të lerë shenjën e vet veç sa fundoset guri. Tani asgjë më ska kuptim. (*Drejton sytë nga qielli*) As ti! E kupton? As TI s'ke më kuptim. Fëmijët e mi i gënjej çdo ditë në emrin tënd. Ka Zot u them. Ka zot, por ka dhe heshtje, them nën zë. (*nënqesh me ironi*)

(*Pauz*)

Duhet të vuajmë, u them, që të na dojë Zoti. Ata janë ketu. Ti nuk ke duar. Nuk të lejoj të bësh asgjë kundra dëshirës time.

E kupton? JO ME TA! Largohu! O hije që kërkon të më përpish frymën e fundit. Unë do të tretem një ditë, por emri im jo. E ty, çdo të të mbetet me pas? Hahahah! Emri im është i shenjtë. I fundit që mbetet në kuti, si gjithmonë.

(Pauz. Ajo vështron duart. Sheh nga salla)

U rrita jetime. Pa baba. Më martuan 18 vjeç. Hanim barishte. Unë i mblidhja me dorë. Në thonj dheu më pëshpëriste mbeturinën amfibe timen, atë çka do mbetesha. Ç'ka isha e dinte dhe miu i arrave me të cilin dridhja ndonjë cigare aty-këtu, kur më binte rasti ta takoja. Hahahah! Barku im rritej si topth i qelqtë dhe kriste çdo 2 vjet. Mbi kurriz më klithte çdo natë një rrip pantallonash. Unë zbëzaja. Heshtja dhe pranoja fatin tim derisa një ditë shpërtheva si bombë.

(*Pauz e shkurter*)

Kur e mendoj tani se ku e gjeta forcën me dridhen leqet e këmbëve. Unë, femra e hekurt! - Ashtu më quajti im shoq. - Mbeturina e një qeseje plehrash që ngre zërin për drejtësi. Ndoshta kishte të drejtë. Por ja që aty u dëgjua zëri, vetëm për lutjet e mia jo.

(Drita ndricon dy djemtë mbi krevat. Ata nuk lëvizin.

Driloni: Nënë ma rregullo pak krahun. Duket se më ka ngecur e s'mund ta lëviz-

Nënë Shpresa: Ta rregullon nëna shpirt!

(Ajo shkon tek Driloni dhe I fërkon këmbën)

Eduarti: Nënë më është mpirë këmba. Ma fërko pak.

Nënë Shpresa: Ta fërkon nënë Shpresa ty…

(Ajo i fërkon këmbën Eduartit. Fëmijët rrinë të ngrirë. Nëna vërtitet në shtëpi. Drita bie mbi Evan.)

Eva: Nënë, nesër kam shkollë. Më duhen dy fletore të reja. Të vjetrat i kam mbaruar.

Nënë Shpresa: T'i blen nëna zemër. Sot kur të shkoj në punë, më premtoni se nuk do të bëni zë. Duarti do t'ju ruajë. Komshiu. Do ta telefonoj herë pas herë nga lokali ku do të këndoj. Pas çdo kënge do ta marr në telefon. Sapo të dal prej aty, do të jetë ora që dyqani do të hapet dhe do të të ble fletoret. Mos u mërzit. Mirë?

Eva: Mirë nënë!

(Fëmija e tretë ngrin. Nëna vërtitet në shtëpi. Drita bie mbi Dëshirën)

Dëshira: Nënë, unë e mora deftesën e notave. I kisha të gjitha 10(dhjeta).

Nënë Shpresa: (Duke lotuar nën zë) E mira e nënës ti.

(Fëmija i katërt ngrin. Nëna vërtitet në dhomë duke rregulluar rrëmujërat)

Driloni: Duhet bërë diçka.

Eduarti: Ça mund të bëjmë ne? Ne jemi vetëm fëmijë.

Eva: Nëna duket e lodhur. Ne duhet ta ndihmojmë atë.

Dëshira: Si?

Driloni: Duhet bërë diçka. Duhet bërë..

Eduarti: A shkojmë të luajmë?

Eva: Ti mendjen vetëm për të luajtur e ke!

Dëshira: Edhe unë dua të luaj. Fundja s'është turp të luash.

Eva: Dhe pastaj do rrish do merresh me gjithë ata idiotë. As dua t'i duroj më! Talljet e tyre janë të papranushme! "Këta fëmijë i ka braktisur babai", "Babai i tyre është një pijanec", "Ej çuna, shihni, po kalojnë katër muskultjerët, eja t'i bëjmë me rradhë të gjithë", "lëri, lëri të piqen dhe pak mollët se pastaj shijojnë më shumë" do thotë një tjetër. Jam lodhur së dëgjuari këto tallje. Jam lodhur së paturi frikë…

Driloni: Tani nuk do të lodhesh më.

Eva: E vërtetë.

Dëshira: Nuk është e vërtetë. Unë jam lodhur së qëndruari kështu.

Driloni: Ky ishte fati ynë.

Eva: E vërtetë.

Eduarti: A bëjmë një makinë dheu?

Eva: Ed, mjaft se s'të duroj dot më. Ti po më çmend më keq.

Dëshira: Pse nuk shkojmë të kërkojmë ndihmë?

Driloni: Ke luajtur mendsh? Kush do na ndihmojë ne?

Dëshira: Duhet të pyesim se ndoshta gjejmë ndonjë zgjidhje.

Eva: Por ne...

Driloni: Jemi kukulla! Kush na i vë veshin ne?

Dëshira: Po ne flasim. A e mban mënd atë ditë kur ai xhaxhi donte t'i bënte keq mamit?

Eva: Babi doje të thoje?

Dëshira: Nuk e di, di se rrinte këtu gjithë ditën dhe kur

nëna vinte gjithmonë do ta bënte të qante. Ajo, sa herë do të na drejtohej, do të na filste butë, sikur asgjë s'ndodhte.

Eduarti: Kush është babi?

Dëshira: Ohu! Unë e mbaj mënd gjithmonë hijen e tij. Më tmerronte. Pale kur më këpuste ndonjë shpullë.

Eva: Heshtni! Po afrohet nëna.

(Fëmijët heshtin. Nënë Shpresa përgatit tavolinën.)

Nënë Shpresa: Drilon, ti je më i madhi, ti do të kujdesesh për të gjithë.

Driloni: Mirë mami!

Nena: Mos harroni të fikni dritën kur të mbaroni së ngrëni e së bëri detyrat, të kursejmë njëçikë, mirë?

Driloni: Mirë mami.

Nena: Unë po shkoj në punë. Të gjitha i keni gati. Po patët ndonjë nevojë lajmëroni xhaxhi Duartin, mirë?

Driloni: Mirë mami.

Nënë Shpresa: Bobo, ku e kam harruar atë dreq të kuq buzësh? Ata s'më qasin po të mos kem luk të mirë. Burrokracira. Ç'të bësh. (Sheh përreth) Ah, e gjeta! Shpirtrat e mi, po iki, aman, bëjuni të mirë e të mbarë. Nënë Shpresa tek ju i ka gjithë shpresat.

Fëmijët: Mirë mami.

Fëmijët heshtin. Nëna largohet nga skena.

Driloni: Shttttt! Të presim sa të largohet dhe të na i bejë me dorë.

(*Nëna arrin nga dritarja. Hija e dorës së saj shfaqet.*)

Fëmijët: Mirupafshim nënë!

(Pauz)

Driloni: Si do ia themi të vërtetën?

Eva: Asaj as i besohet se çka ka ndodhur është e vërtetë.

Dëshira: Unë nuk dua ta dijë.

Eduarti: A do bëjmë makinë dheu?

Driloni: Po sikur të shkojmë tek ai xhaxhi?

Eva: E sigurt se do na ndihmojë?

Dëshira: Unë e kam frikë atë.

Driloni: Unë dua të bëhem si Iron Man.

Eduarti: Ç'është Iron Man?

Driloni: Një njeri i hekurt.

Dëshira: Kukull? Unë vdes për kukulla.

Driloni: Edhe kukull mund të quhet, por ai ka një veshje hermetike dhe i mbron fëmijët nga çdo e keqe.

Eva: Unë mbaj mënd përrallën e Spider Burri dhe atë të Batman. Nuk e kam dëgjuar ndonjëherë Iron Man.

Driloni: E kam parë tek televizori i xhaxhi Duartit kur po shkoja t'i kërkoja pak kripë. Nëna më dërgoi. Nuk kishte më në shtëpi. Duke pritur të merrja kripën xhaxhi Duarti më shpjegoi se ai njeri që po shihja i përhumbur në film ishte Iron Man, njeriu që bënte të mira.

Eva: Ai është film o Drilon.

Driloni: E di, por kur je kukull çdo gjë të duket ndryshe, më e besueshme.

Dëshira: Unë mbaj mënd kur nëna gjithmonë thoshte se Zoti do na dojë më shumë kur të vuajmë.

Driloni: Zoti s'ekziston!

Eva: Ku e di ti. Ndoshta është një sprovë.

Dëshira: Unë kam ende shpresë.

Driloni: Sa do të dëshiroja të ndodhte kështu si thoni ju. Por ne tashmë s'vlejmë më për gjë.

Eva: Të jemi realistë.

Driloni: As me ëndrra.

Eva: Të shpresojmë atëherë se diçka do ndodhë.

Driloni: Do ikin dritat dhe pak. Historia do përsëritet. Kam frikë!

Dëshira: Unë nuk e dua errësirën.

Eduarti: A do më tregoni një përrallë?

Eva: Sikur të mundeshim të ishim shpirtra…

Driloni: Do mund të fluturonim në hapësirë.

Dëshira: Do shëtisja të gjitha yjet.

Eduarti: Kur do ikin dritat?

Eva: Do mund të behesha një valë deti.

Driloni: Do doja të bëhesha zë.

Dëshira: Do doja të isha një bletë.

Eduarti: Do doja të kisha shumë lodra

Eva: Ed, po të jesh shpirt s'mund të kesh lodra, veç të shndërrohesh në një gjë tjetër.

Eduarti: Ç'është shpirti?

Eva: Ohu!

Driloni: Shpirti është çka mbetet nga trupi.

Eduarti: Po unë i shoh duart e mia.

Driloni: Kjo do të thotë se trupi ska ikur ende.

Eduarti: A do dhe shumë?

Driloni: Do dhe pak..

Eva: Hahahaha!

Driloni I ben shenje Evës të hështë.

Eva: Po sikur ta provojmë? Unë kam lexuar diku se shpirti mund dhe të rilindë.

Driloni: Unë mbaj mend filmin "Shpirti" kur ai xhaxhi e puth atë tetën dhe ikën në qiell.

Eva: Shumë e bukur për të qënë e vërtetë.

Driloni: Po sikur të jetë e vërtetë?

Eva: Po nëna?

Driloni: Saktë. S'kemi s'i e lemë vetëm.

Eva: Noshta prandaj dhe nuk bëhemi shpirtra sepse diçka na mban ende në tokë.

Driloni: Ndoshta. Çdo gjë duket kaq ireale sa dhe ajo çka na rrethon dhe mund ta shohim.

Eva: Ndonjëherë me dukesh si babagjysh.

Dëshira: A do bëhesh babagjyshi i vitit të ri? Do më sjellësh mua lodra?

Driloni: Ju të dy më çmendët. Ne kemi halle më të mëdha e ju veç lodra kërkoni. Mësoni në mësime dhe kaq. Askush s'ju kërkon më shumë.

Dëshira: Po ne jemi kukulla…

Eva: Ne do i themi nënës se gjithmonë shkojmë shumë mirë në mësime. KAQ!

Eduarti: Unë s'kam shkuar ende në shkollë. Ç'është shkolla? Kur do shkoj dhe unë aty?

Driloni: Harroje. Ne tani jemi kukulla.

Eduarti: Po kukullat nuk shkojnë në shkollë?

Driloni: Jo, nuk shkojnë.

Eduarti: Dua të pikturoj. Nëna ime ka qejf kur pikturoj.

Driloni: Provoje në mundsh!

Eduarti: S'e lëviz dot dorën.

Dëshira: Më është mpirë qafa. Dua të ma fërkojë nëna

Driloni: Është në punë. Shttttttt! Dikush po vjen.

(*Fëmijët heshtin*)

Driloni: Iku. Do jetë xhaxhi Duarti. Ai gjithmonë vjen dhe na kontrollon. Edhe atë ditë, këtu ishte por,..

Eva: Kështu ishte e shkruar-

Driloni: Harroje shkrimin. Askush nuk shkruan vepra më. Madje as qiellore. Kuptoje!

Eva ul kokën me dëshpërim.

Driloni: Hajde, flini tani. Dhe pak dhe vjen nëna. Ajo do jetë e lodhur. Do të na shpërndajë mëngjesin dhe do të shkojë prapë te puna tjetër.

Eva: Nuk e kuptoj pse lodhet. Nuk e kuptoj pse nuk e kupton këtë çka ne të gjithë e kemi kuptuar…

Driloni: Ç'ti bësh?!

Eva: A provojmë vetëm për një herë të bëhemi shpirtra? Pastaj kthehemi prapë këtu, në vendin tonë.

Driloni: E pamundur. Si?

Eva: Le të shprehim nga një dëshirë.

Dëshira: Dua kukull.

Eduarti: Dua nje makinë

Eva: Ahhhh ju të dy… Po më çmendni!

Driloni: Shprehe, provoje, ku i dihet?

(Eva pëshpërit në dhëmbë. Një shkreptimë vjen nga lart. Fëmijët trëmben.)

Eva: A s'të thashë?

Driloni: Ev, ishte shpreptimë. Do bjerë shi!

Eva: Jo, ishte fuqia ime, shihe dhe njëherë.

(Eva pëshpërit në dhëmbë. Një shkreptimë tjetër vjen nga lart. Fëmijët trëmben.)

Eva: A s'të thashë?

Driloni: Jo o Ev jo, do bjerë shi!

Zhurma e shiut pikon mbi cati

Eva: Bobo, tani do lagemi-

Dëshira: sa inat e kam të ftohtin.

Driloni: Ç'na bërë. Ec e duro të ftohtin tani.

Eduarti: Po ne jemi kukulla. Kështu më keni thënë.

Eva: Agrrrrr! Më hoqët trurin!

Eduarti, Dëshira, Driloni: Po ne jemi kukulla, Ev!

(Fëmijët heshtin. Hapa të tjera dëgjohen nga jashtë.)

Driloni: Po ikin dritat. Erdhi ora. Të ndezim qiririn.

Eva, Dëshira dhe Eduarti: Po ne jemi Kukulla, Drilon!

Driloni: Nëna po vjen. Ajo është e lodhur. Shiheni se si i numërohen shpullat në fytyrë.

Eva: E paskan rrahur prapë.

Driloni: Fletoret e tua i ka në dorë, shihe!

Eva: Po ikin dritat Drilon.

Driloni: E shoh. Po fiken.

Dritat fillojnë të fiken dalëngadalë mbi kokat e fëmijëve. Nëna hyn në dhomë.

Nëna: I paska zënë gjumi. E lumja unë. Të paktën ju kam juve. Apo mendoj se ju kam? Oh Zot! Nuk çohem dot nga ëndrra. Më ndihmo të gjej pak forcë.

(*Ajo le në tavolinë fletoret dhe një shishe qumësht)*

Nëna: Këtë qumështin ma dha xhaxhi Shpëtimi për ju.

(ajo sheh nga duart e mavjosura)

Nëna: Dhe një shkop që të vija sa më shpejt tek ju.

(Pauz)

Lokali sot ishte plot. Këndova. Mendjen e kisha këtu. 8 herë e kam telefonuar xhaxhi Duartin por vetëm njëherë e dëgjoi zilen e telefonit, ose bënte sikur s'e dëgjonte. Njerëzit ishin si milingona. Çdonjëri prej tyre me një shkop magjik. Sot kam bërë disa para. Do paguajmë qiranë e ksaj shtëpie. Dritat. Do u ble dhe çanta të reja. Dhe nga një lodër të bukur. Nesër do të shkoj në treg pas punë dhe do t'ju pyes me rradhë se çkeni dëshirë të blini. Ahhhhhhhhhhhhhhhh!

(Pauz)

Ishte dhe babi juaj. Ai me pa me përçmim. Unë e gëlltita shikimin e tij. Vazhdova të këndoja. Gjinkalla më shoqëroi

gjithë mbrëmjen.

Sikur të mundja t'ju shihja të buzëqeshur. Ndonjeherë me duket sikur ju kam çuar në jetë para kohe. (Sheh nga duart). Kam punuar si kafshë dhe prapë…

(*ajo sheh lart)*

Nëna: Sikur të mos ishte e vërtetë. Më dhuro dhe një ditë me ta. Dhe një… Ose zgjidhe jetën time përfundimisht nga ky kafaz. U lodha…

(*Ajo shtrihet në dysheme. E zë gjumi. Një shkreptimë bie nga lart. Dritat në skenë fiken).*

MËKATI I HESHTJES

(*MONODRAMË)*

Personazh:

Një vajzë

Një e çmëndur gjendet mbi krevat me duar të lidhura më një bluzë të bardhë, që zgjatohet pas shpine. Në vënd të orës, një sy kallçuku. Ajo lëkundet lehtas mbi krevat dhe këndon.

Nina nana, nina o, që të flesh gjumë o!

Nina nana vajzë o, që të shohësh ëndrra plot!

Ëndrraaaaa! Hahaahaah! Kapakë që psherëtijnë vuajtjen e një bërthame apokaliptike, një vrimë e zezë që veç thith dritën, hahahahahaha!

Ajo është nudo dhe kalëron mbi valët që përpëlitin shpresat! Hahahahah!

Ejjjj vajzë, jam unë, ktheje kokën. Më shih në sytë e mi. Janë pasqyra e përpëlitjeve të tua agonike. I ndjen? I sheh? I prek me duart e tua delikate të gjitha këto? Duart! (sheh nga krahët e lidhura) Duart e mia të rreshkura nga prekjet e transparencës! Kujt i duhet vallë ajo? Ato janë të lidhura nyje për të mos u hapur kurrë më! Kurrë më!

(pauz)

Unë eca me dhimbjen e palosur në qerpikë. Ishte një ditë e bukur. Dielli nuk kishte aguar ende por unë ndihesha aq mirë,

e mbështjellë si një kulaç me brymën e mëngjesit. Ai ishte aty. Oh shikimi i tij i ëmbël si i zgjonte dëshirat e mia të trazuara. Unë e vrava atë shikim. E vrava heshtjen e tij të përgjakur me apoteoza mondane. Po po. Asgjë s'mbeti më prej tij. Ai sy! E hoqa prej tij dhe e vara në mur.

(Afrohet pas syrit të kallçukut)

Më ndjen? Më sheh? Ulu poshtë! Më shih! Dua të të kalëroj! Si një amazonë do të të zhvezh nga miti yt i përgjakur. Nga miti yt i krijimit… E sheh si përgjërohem për ty? Je hyu im! Lutjet e mia janë të tuat. Sytë e mia janë të tuat. Buzët e mia plot afsh nuk I takojnë askujt tjetër! Askujt! Të premtoj!

(Pauz)

Atë ditë ti do të takoje zonjushën X. Unë u bëra si e çmendur. Kisha një jetë që e kërkoja paqen me ty. Një dyluftim në emër të hiçit. Të asgjësë! Po! Të kisha shpallur paqe kohë më parë. Nuk doja t'ia dija se me kë do të dilje. Nuk doja të dija kë dashuroje. Para jetës dhe kuletës e di se je i dobët. Arrije të shtije në dorë gjithçka që s'të takonte. Unë! - *(Pauz.)* Unë u bëra shkaku që ti të mos shihje asnjë ditë të bardhë. Isha armikja jote, të kujtohet? Xhepat e mija ishin gjithmonë bosh. Nuk mundeshin të të nginjin.

(Pauz)

Natën e parë të takimit tonë ti ishe ende një çunak. Hahahah! Kur e kujtoj se si i prekje gishtat e mia të holla më vjen për të vjellë. Ti dridheshe! (Sheh nga syri) Dridheshe dhe përpëliteshe dhe unë gëzoja me kënaqësinë tënde si të isha një bebe që mëkohet me qumësht jete.

(Pauz)

Por sapo shkele mbi lulen time të jetës, burimin që mëkon përjetësisht egon tënde, më dhe shuplakat më të fuqishme që mund të ekzistojnë. Dënime që kurrë më parë s'i kisha pas menduar. Nuk munda të luaja kurrë një rol siç ti ke dashur gjithmonë prej një femre. Kam pas besuar tek sinqeriteti si të isha pjellë e MAAT. E di. Jam budallaqeeeee! Pse kot më kanë lidhur? Hë pra ma thuaj, kot?!

(Pauz)

Dëgjo. A të kujtohet atë ditë tek kodrat e liqenit kur ti dhe ëmbëlsia jote e rradhës donit të vishnit afshin tuaj me muzgun e mbrëmjes? A të kujtohet që një skifter erdhi dhe i nxori sytë asaj? E kam ende foton e atij syri në raftin e librave. E kam fshehur tek "Bekimet e ditës". Ishte syu më makabër që kisha parë dhe më i bukur njëkohësisht. E kam zhbiruar thellë. Ai sy nuk të donte aspak por bëri të mundur që ti ta doje marrëzisht.

(Pauz)

Po atë ditë? Atë ditë kur ti u diplomove? Zot si më gëlonte zemra për ty. Dhe ti pa më puthur ende u takove me Y. E puthe. E përqafove më marrëzinë e një të marri. Ajo rendte pas teje. I adhuronte aventurat e tua, kurse unë rrija në hije. Të kujtohet? Në duar përkedhelja gjithmonë trishtimin tim. Ti asnjëherë s'ma pate dhuruar atë ëmbëlsi qoftë dhe në takimin tonë të parë. Më pas mora vesh se Y kishte përfunduar në autopsi. I kam bërë dhe një foto atje dhe e kam ruajtur tek "margaritari i rradhës". Ishte sy i ëmbël. Aty s'kisha dorë unë. Të betohem! Ishte fati që donte të ta hiqte qafe shpirtin tënd binjak.

I shkreti ti. Ngele duke kërkuar gjithë kohës shpirtin tënd binjak. Por tani mos u lodh. Të kam gjetur. Të kam përfundimisht timin. Ti je i imi!

(lutet)

Syri im që më sheh nga lart
u shenjtëroftë shpirti yt poshtë
ardhtë mbretëria jote e përjetshme
me çmendurinë tënde të rradhës

Hahahahahhaah! O zot sa qejf të kam kur merr pamje serioze. Si më shikon. Gjithë nerva! A thua se jam një kriminele zemrash? Apo s'të pëlqen që të konsideroj si hy? Po ty nuk të bëhet shumë vonë se si të shoh unë. Ti do veç mitin tënd. MITIN. Atë s'munda ta vras kurrë! Kurrë. Madje as ta zotëroj! Iluminati yt vjen drejt meje dhe më përpëlit mua, nimfën më mjerane që mban kjo galaktikë. Qëndrimi yt i sertë më ngazëllen ndonjëherë. Ti je ky. Armiku dhe miku im. Ti më qarkon rreth zverkut tim shpatën tënde të urrejtes. Hesht! I poshtër! Mëkatar që nginjesh duke shqyer unin e të tjereve dhe e vesh më pas me tëndin mit.

A e sheh? Sa herë merr këtë pamje, në këmbë, më varen gjarpërinj. Kokat e tyre me gjuhën e gjatë kërkojnë të përpijnë vetëdijen time. E di! Ti kurrë s'do të mundesh të ma heqësh atë. Unë jam robinë. Ti, një mit! Mit kafshues i ëndrrave të mia! Gjakatar. Oh me ty, me ty do të hyja në gjak që ditën e parë që të kam njohur.

MOS! (Sheh nga syri) Mos më mbyt! S'të vjen keq sa herë

më ke bërë të vdes në duart e tua? Je i lirë. Gëzoje lirinë që vetë e ke krijuar. Një nocion pa kuptim, apo jo? Mirë, unë po i gëzohem syrit. Unë syrit i gëzohem. Ta dish!

Ta kam thenë që ditën e parë që të kam parë se kurrë s'e vlerësoj një njeri me tepër se sa vlerësoj sytë e tij. Prej tyre arrij të shoh dhe se çfarë karakteri u mbizotëron në shpirt. Ti ishe aq i ëmbël. Aq i bukur. Aq i mirë. Sytë e mi u verbuan teksa donin të të bindnin të më ktheje në kohë ç'më pate marë! Ëndrrën. Qëllimin e jetës time… Vrasës!!!

Po po, e di, je aty dhe më sheh çdo lëvizje këtu, në këtë mbështjellë imbecile. Por unë nuk do të të tregoj asgjë! Asgjë nga ato që të kam fshehur në kaq kohë. Ti kujtove se unë, robina jote, nuk do të kisha më sy të shihja, nuk do të kisha më gojë të të flisja. Ah ti, ti… I kryqëzuar dhe i mashtruar! Ja, ky je ti. Miti im i derdhjes së iluzioneve në një epruvetë shkatërruese.

(Pauz)

E mban mënd se si të erdha atë ditë dhe të lava këmbët me lotët e mia? Ti qeshje. The: Grua, çohu dhe më kujto! Unë të kujtova. Madje jo vetem aq por të ndiqja pas kudo që shkoje. Unë isha e gjitha: e vërteta dhe e pamohueshmja fshehtësi e jote. OH!

Në barkun tim u mboll pafajësia në guaskën e mëkatit! E kupton? Atë e vranë! Ti ishe fajtor! TI!

Oh nuk ka se si të të kujtohet kur mbi gjëmbat e hordhiqeve të tua, unë shkulja gjembat e dashurisë për ty. Armiku im i shtrenjtë. Ti më copëtoje trup e shpirt. Unë luftoja me sa mundja jo të të hiqja qafe! Aspak. E doja dhimbjen tënde. Më

miklonte. I doja dhe lotët e mi që i mbillje me dhimbje.

E sheh? Të kam dashur. Dashuria është dhimbja që të bën të shohësh botën me sytë e një të marri.

(Sheh nga syri)

Të kujtohet kur më prenë dammarët? Ishe ti, sigurisht ishe ti, doje të hakmerreshe. Më thanë se kisha vdekur. E pranova ashtu siç pranon një besimtar naforen e ditës. Prisja të udhëtoja mbi një rreze të bardhë dhe një aureoleë të më vihej në kokë. Por para meje dole ti, fytyra jote e akullt që thoje, kthehu! Nuk je për këtë punë ti. Asnjëherë s'i besove aftësitë e mia. Isha gjithmonë një "dështim". Po, por një dështim i bukur aman, që gjithmonë të intrigonte ta dëgjoje deri në fund e më pas, i jepje një shuplakë të egër.

Nuk kam më fuqi. Fola shumë. Duart më janë mpirë. S'i mbaj dot më kështu. Dua të të perkëdhel. Të të puth. Të të dashuroj. Kam nevojë për ty. Bëjmë paqe për sot? Si thua? Mirë! Kurrë mos pranofsh!

(*lëviz në dhomë*)

Dua të jem e lirë! E lirë! E lirë!

Të dal prej këtu! – Më ndihmo!

Dua të shoh perëndimin e diellit.

(Afrohet nga dritarja)

Pse nuk më ekzekutojnë? Pastaj s'mbaj mënd për çfarë më kanë mbyllur këtu! Unë nuk bëra asgjë! Ti e di mirë! Unë vetëm

bërtita. Thërrita ndihmën e parë që kurrë nuk erdhi në kohë. Por ti e kishe sajuar ashtu. Unë u tregova çdo gjë fije për pe dhe ti prapë nuk reagove të më miratoje. Ah ti, ti…

(Pauz)

Të dashuroj dhe të urrej! Unë, idiotja jote, pranoj në sytë e mureve me veshë që të dua pafund.

(Pauz e shkurtër)

Pastaj dhe nëse të them se të urrej, ti e di, të dashuroj pafund. Jam një sajesë e pështirë për qënien tënde aq sa dhe e dëshirueshme. Fataliteti i përplasjes së kohrave! Ti më quaje mikja e zemrës, unë isha armikja jote. Paqja jonë kishte përfunduar në…. më doli nga mendja kur... Ah po, me traktatin e fundit që u firmos para gjykatësit të paqes. Gjykatës i thonë, sepse paqja jote, predikohej çdo ditë nga vetë buzët e tua, në të cilat unë, hyjnizohem dhe sot e kësaj dite.

Shiko (*tregon me gisht*) gjethe dafine po shtrohen mbi tapetin e ëndrrës tonë. Jam unë. Më sheh? Ti je në anën tjetër të rrugës. Do dalësh të më presësh apo jo? Do të më heqësh mantelin nga supet dhe kur të takohesh me aromën e vajzërisë do të më dëshirosh sërisht. Unë do të bëhem perëndesha jote! Hahahahahaha

Uaaaaa! Shih shih! Një demon! Këmbët e mia po ngrijnë.. Gjethet e dafinës po thahen. Rruga po pëson çarje. Vullkanet e mbushin dhe e ndajnë më shumë largësinë tonë. OHHHH! Si s'gëzoi njëherë njeriu i shkretë. As me ëndrrën…

(Pauz)

Po më mirë kështu. A nuk të kujtohet sa të lumtur ishim dy ditët e para të njohjes tonë? Si na rrihte zemra të dyve. Ti mbaje shtrënguar dorën time. Unë, dashurinë tënde. Ti the diçka nëpër dhëmbë dhe që ateherë filloi shturrja jonë. Unë të pyeta çfarë the? Ti më the, asgjë! Një copë akulli filloi të ngrinte çdo ditë në ndienjat e tona. Unë kuptova se ti s'më doje. Ti kuptove se të urreja.

E më pas? (*Sheh nga syri*) Më pas më the se kishe nënshkruar traktatin e shenjtë me atin tënd. Unë do të bëhesha gruaja jote, motra jote, nëna jote, gjithçka që e mban emrin femër! Ah ç'djallëzi! MITI yt që më çmënd. Si mundshe ta bëje të tillë dikë që të urrente e të donte njëkohësisht? Si mundej vallë?

(Pauz)

Mirë, mirë. E di. Sot asgjë s'merr vlerën që duhet. Fjalët thuhen kuturu. Pa nënkuptime. Lidhur me këtë ti je I PAFAJSHËM, ndërsa unë ëndërruesja e përjetshme. E mban mënd se si t'i kridhja kaçurelat me dorë? Gjëmbaçet me mirë.

Oh, dua të fle tani! Më ler të qetë…

(lëkundet dhe këndon)

Nina nana vajzën o, që ta marrë gjumi o
Nina nana vajzë fli, që ky sy të t'dojë veç ty…

AGRRRRRRRRRR! I poshtër! Ti vendos në gojën time fjalët që nuk duhet t'i them. Boll. Mjaft. Mjaft thashë!!!

(Pauz)

Mirë, mirë. Të dashuroj… Po pra, të dashuroj.. Mos u bej i marrë tani. Por nuk më del inati kur të kam parë me Z. Si e doje atë mua kurrë s'me ke dashur. Foton e syve të saj e gjen tek rafti "Mbijetesë". Ti u ngjalle. Dhe është e çuditshme se ti ngjallesh aq shumë kur dikush ta mëkon egon tënde. Ti, që kurrë nuk ekziston në ditën time, sa herë behet fjalë për X, Y, Z ngjallesh dhe behesh misioni i mendimit tim. Po tani? Me kë X, Y, Z je? AGRRRRR

Ate ditë, të betohem, vetëm kisha fjetur. Nuk kisha menduar për ty. Natën erdhën policët dhe më rrëmbyen. Ata me beretë e kam fjalën. Unë s'bëra asgjë. Nuk ofshava. Nuk pata as kohë t'i pyesja se pse. Më pas më bëne mijëra pyetje. Morën gjurmët e gishtërinjve të mi. Përgjigjet e mia nuk u shkonin për shtat. Ishin mirëinformuar thanë.

(Pauz)

Sado të kam urryer për veset e tua, kurrë s'kam bërë gjë ndaj teje. Ndaj teje, KURRË. Ata u shkrinë së qeshuri se për ty bëhesha çdo kafshë. Metamorfizohesha në çdo lloj qënie, vetëm e vetëm për të mos lejuar të kishe tjetër, veç meje. Dashuri debileje thuaj më mirë. E pranoj. Të kam dashur. Ndoshta dhe të urrej. Por sa shoh syrin tënd këtu, të varur, direkt më vjen dëshira të të puth, të të përqafoj, të bej dashuri me ty.

I POSHTËR. Në shtrat do thërrasësh gjithmonë X, Y, Z. Do ofshash për to. AGRRR..-

Më ler të fle tani! Më ler të thashë!

(Shtrihet. Mbyll qepallat.)

Dhe kur ëndrra të vijë në sytë e tu, atëherë më mallko.

Dhe kur engjejt të të vijnë pranë, atëherë dije se je djall!

AGRRRR! Si s'më le njëherë të fle rehat? Pastaj thonë se jam çmendur!

(Pauz. Çohet nga krevati.)

Do të më mbash mëri ende? Unë di të fal shpejt! Nuk harroj, por fal, thashë!

(Bie prapë për të fjetur)

Dhe kur mes flakësh të shohësh si digjesh, do te jesh një POMPEI I rilindur…

AGRRRRRRR

Dhe sa kohë do të më mbash kështu? Ne këtë lloj burgu? Ke vendosur të më izolosh gjithë jetën tënde? I pashpirt!

Mbi duart e mia një trëndafil më përgjak
sa herë të thurr ëndrra, ai m'i kthen në varr
burgosur më mbajnë, pa asnjë shkak,
unë vrasjen e tij, s'e kryeva aspak..

Ti e di, ti e di, ti e diiiiiii! Ti vdes të më akuzosh për një kriminele o mbreti im Makbeth. Nuk isha unë që u mora me ty, as me hijen tënde! Shpirti tu prehte në paqe por unë,… unë kurrsesi s'e lava kamën time me gjakun tënd! KURRË!!!

Si? *(çohet dhe sheh nga syri)* Ti më përndjek mua si kriminelen më të pashpirt të njerëzimit? Unë mund të jem një OFELI?! A e di? Unë nuk kam qënë e përdalë. Pavarësisht se si ti namin ma ke nxjerrë. Dashuria për ty më marrosi, më more

gjithçka, por kurrsesi nuk kam qënë dhe s'jam kriminele.

Si si? Unë jam një Helenë që i vë flakën Trojës? Unë? Trojën e dogje TIIII!

Më ler tani. Loja jote me personazhe nuk më shkon për shtat. Dua të fle. Të fle pra!!! S'e sheh sa jam dobësuar? Që kur humba gjithçkanë time u ktheva në asgjënë e gjithçkasë. U bëra pre e saj, e kupton? *(Çohet)*

UNË NUK E DOGJA TROJËN!

Të betohem, ajo ishte e djegur kur këmba ime arriti atje. Ajo u përvëlua nga një hu. Një kalë që shihte me mëri fustanin e natës. Shihe. Rruga është e rrashuar. Pemet janë bërë hi. Shtëpi s'ka më, veç gërmadha….hahahahahahahhaha

E sheh? Nuk të gënjej. Unë nuk gënjej kurrë! Këtë kam pritur dhe prej teje. Por ti, vetëm të më mashtrosh di, duke më veshur epitete që mua më çojnë gjakun peshë. Ti masturbon më pas me ngërdheshjen time dhe unë nuk e mbaj dot më ritmin e arsyes. Ti më çmend! Ti më çmëndddd! O perëndia im, ti më çmënd?!!!!!!!

(Çohet në këmbë.)

Dua të vdesssss! E kuptove? Dua të vdes dhe kaq.

Shiko! Pika e ujit që bie nga çatia. Sigurisht ka kohë që rrjedh kështu. Askush s'kujdeset për mua, idioten tënde. Bëje det! Bëje det thashë. Në mos mundsh një oqean. Të hidhem e të mbytem aty. Të jetoj dhe të ushqej peshqit e Sednas. Hahahahaaha. Të paktën do të vlej për ushqim. Ndërsa për ty, oh ty kurrë nuk mundet të të nginj as me ndienja, as me trupin tim të mishtë, as

me shpirtin tim të qelibartë..

Si si? I poshtër! Trupi im është i pastër! Shihe. Dalloi damarët. Vijat e jetës sa të drejta janë. Thonë se kush i ka ashtu damarët kurrë s'devijon në jetë. A e sheh? Ti i kishe gjithmonë të fryra vijat e jetës dhe shumë të ngatërruara. Unë t'i kam parë ato. E mban mënd si të thosha gjithmonë? IDIOT! IDIOT PARANORMAL.

Hahahahahahh. Hajde këtu o kafkë e kristaltë. Leshoi timberët e tu dhe me çliro. Të ndiej. *(lëkundet në ajër)* Të ndiej si më prek, si futesh në brendësinë time të shkulësh "shpirtin tim të keq". Atë të egërsuarin them… Beju i mirë. Dhe pak, dhe pak. Mos më fut duart idiot! Si s'mund të rrish një ditë pa më tunduar me ato duar të felliqura qe ke?

(Vërtitet nëpër dhomë).

Sikur unë të kisha duart e mia të lira tani, nuk do rrija si mumje e fashuar në sarkofag. AGRRRR

(Fillon të lëvizë në mënyrë të çorientuar në dhomë. Ndalet tek syri.)

Sy! Zbrit. *(sheh rreth e rrotull).* Nuk është askush këtu. Mos ki frikë. Më zgidh fashat. Hajde tani. Mos u bej i keq (*duart e saj çlirohen*)

Në dy kodrat e errëta do të bjerë zjarr i madh. Shihe! Duhet të bjerë alarmi. Bëj që të bjerë alarmi. Të lutem! Ata do digjen të gjallë. Jo lëri! Le të digjen. Ahahahahaahah! Ti je djalli që vetëm mbretërinë tënde do! Pasuroje me shpirtra të pafajshëm. Bëji mëkatarë! Haji të gjithë me një frymë. Më dëgjon?

Eja këtu. Shtrihu me mua. Unë jam najada jote, të kujtohet? Kështu më quaje. Jam e brishtë si gjethe dafine. E egër si gonxhe trëndafili. E njomë, si vesa e mëngjesit.

Më perkëdhel. Dua të më bësh të ndiej qiellin e tetë. Te shtatin e kam ndier kur më pallove për herë të fundit. Të kujtohet? Mbrekullia jote lindi dhe vdiq në një çast të vetëm. Ti s'di asgjë. Ti s'e di se çdo ditë është hiçi yt që më mban gjallë. Ti, inekzistenca ime, ajo që unë dua dhe ëndërroj. Hajde tani më zhvish. (Ajo heq këmishën.) Nuk do të më puthësh? IDIOT!(fillon të mbërtheje këmishën. Ndalet. Kërcen nga shtrati.)

Shttttttttt! Dëgjo! Zhurmë hapash po vijnë në drejtimin tonë! Po na përgjojnë Sy! Eja me mua. Duhet të fshihemi. Ata do të na kapin dhe do të na quajnë bashkepunëtorë. Duhet të fshijmë gjurmët. Ja ku është pema. Pema jote. Do të të var aty mes gjethesh. Unë do të fshihem pas trungut. Mirë? Ata do të vijnë tani. Ja u hap dera. Shttttttttt.

Dreq. Më zbuluan. Te thashë mos pipëti. Ti s'mund të rrish pa derdhur lotë. Quravec! Lotët bëjnë plluq plluq mbi tokë IDIOT.Erdhi. Ai me maskë. Shihe si do të më tërheqë tani zvarrë nëpër dhomë. (*ajo shtrihet në dysheme dhe hiqet zvarrë.)* Dua t'i largohem. Më ndihmo! Sy! O Hy! Gjithmonë të dua në këto momente. Sy! Çohu dhe bjeri me thikë pas shpine. Ke dritën e jetës, harrove?

(nga jashtë vjen një shkrepëtimë)

Të thashë?! I miri im. E sheh? Kur do të bëhesh bashkëpunëtor je më i miri. Veçse ke një të keqe. Ti gjithmonë më spiunon. Me ty, nuk fshihem dot askund, kudo që të shkoj. SYYY!

Mos bërtit. Shttttttttt! X po vjen drejt nesh. E sheh? Sy! Pusho të thashë! Ajo ka një sy të hequr. Do të më buzëqeshë me atë gojën e saj të shqyer. Iiiiiiiii. Nuk gjen dot paqe me mua, e sheh? Ajo po më përshendet. Zëre se më pyet për ty tani. Ja e pe, më pyeti. C'ti them? Me X, shkrepeti sa të duash, ajo vetëm zhurmën ndjen. Hahahahah! Shife, shife. Mos. Ajo po vjen drejt meje. Do të më mbysë. Vrijeeeeee!

(Pauz. Ajo vë duart në fyt dhe fillon të kollitet)

Shtriga. Për pak desh më mori frymën. Po tani? Ç'ta bëj kufomën e saj? Ajo do të zërë krimba. Do mbajë një erë të qelbur. Do të na kuterbojë dhe do te na i ndërsejë ushtritë krimbore. Çohu! Bëj diçka. Mos e lër këtu. Ata do të turren drejt meje pastaj. Një turmë e madhe që do të të zërë sytë dhe ty. Sepse ti je syri im. Hahahahhaha! Si dridhesh! Akoma përpëlitesh nga zonjusha X? Akoma drithërohesh për të? Mirë, mirë! Ti e di që më pëlqen të luaj me ty. Mos qaj. Lotët më trazojnë gjithmonë. Le që ti qan për të dy bashkë…(pouse)

Eja tani këtu. Boll bëre naze si nuse e re. Ti më ndez të gjithën.

Boll idiot!

Boll qave.

Zhduku pra.

Mos të të shof më me sy.

(Ulet në tokë e mërzitur).

Ik të thashe.

Mos më prek!

Shikooo! Hera është nisur drejt nesh. E ndien se si na turret

me të gjithë shpejtësinë e saj! Çfarë bryme e akullt! Sa ftohtëëë! Ajo po më fut në botën e nëndheshme. Këtu ka veç klithje. Shihe si varen ato krimba në gojen e Y tënd. Sa e bukur duket, idioti im i shtrenjtë. E sheh? Hahahahaha! Kështu do të përfundojnë të gjitha dashuritë e tua të fëlliqura. Në ETERNITETIN e krimbave! Hahahahahaha!

(Pauz)

I thuaj Herës se nuk më kërcet hiç për të. Le të më lejë dhe pak kohë të zbavitem në teatrin e Eternitetit tënd special. Shife shife shifeeeeeeee X. Si përpëlitet e ngrirë nga ftohtësia dhe pa duart e tua rrotull belit të saj. Shiko si të shikon idioti im i ëmbël! Me dëshpërimin e veshur në syrin e saj të pahequr, se të hequrin e di ti ku e kemi arkivuar. Hahahahha.

(Pauz)

Të të puth pak. Më shtrëngo për beli dhe më puth. Iiiiiiiiii ka frikë të më puthë. Po mos ki frikë ti. Ajo s'vjen dot. Jam unë këtu! Djalli yt mbrojtës. Më fal, ëngjëlli doja të thoja. Gjëra që ndodhin gjithsesi.

C'është kjo dorë që më prek nga pas. Mos më thuaj se po luan me mua tani! (kthen kokën) Iiiiiiiiiii! Qenka Y-ni yt i shpifur. Shife! Si ia paskan bërë barkun si centrifuge lavatriçeje. Mos o Zot. S'mund ta shoh dot si i varen zorrët. Shife! Tani ajo do të vijë dhe do të të mbytë ty me ato zorrë. Si? Do më mbysë mua? Jo jo! Ç'punë ka me mua ajo! S'e vrava unë! Unë vetëm foto di të bëj! Jam fotografiste (fotografe) e përkryer! Ajo nuk vjen dot, kot e ke. S'e sheh se si e mbajnë të lidhur rrënjët e pemës që gjelbëron mbi trupin e saj, lart? Në tokë ishte ushqim i gjetheve, këtu ushqim i rrënjëve. Hahahaha! I rëndonte dheut

me pak fjalë!

(Pauz)

M'a shpife me këtë të qarë si një fëmijë i sapodalë nga ai bark! (I përqesh qarjen). Ëëëëë!

Mjaft tani. Ngele duke u ankuar! Hajde bëjmë dashuri dhe njeherë si për herë të fundit. Në sytë e atyre që s'shohin le të bëhemi shembulli i eternitetit të pamohueshmërisë! Unë jam e jotja deri në perjetësi! Si Hera ndaj tim zoti. E kuptove?

Agrrrrrrrrrrrrr m'a hëngre shpirtin me këtë pasiguri që ke. Ato kanë vdekur! Nuk çohen më prej nga kanë vajtur! Unë dhe ti jemi frymë të shenjta të lidhura në përjetësi. Si? Ti je vetëm një sy?! Punë e madhe fort. Dhe i tillë të jesh. Ke simbolin tënd, gjithsesi. Mua me duhet të respektoj si ke qënë dhe je. Unë nuk dua të të ndryshoj ty. Mjafton të më duash mua. S'ka rendësi mosha, fiziku, forma që ke. Mjafton qe unë të ndihem mirë dhe ngrohtë në ftohtësinë tënde si sy! AGRRRR! Gjej dhe unë me kë flas!

(Pauz e shkurtër)

Mos bërtit! Mos bërtit dhe mos shkrepëti këtu, idiot! Apo do që ajo që po prêt lart të ma bëjë trupin statujë për sarkofag? Shttttttttt

(Shkon në anën tjetër të dhomës)

Shiko, një kullë! Eja pas meje. Aty lart ka dritë! Eja! (Dëgjohen klithje të lehta dhe psherëtima nga muret) O Zot! Të gjitha këto kufomat e syve të tu janë? Sytë e tu blu! Vrastarë! Deti im i përhumbjes dhe i dlirësisë. Çfarë po thoja? Ah po! Ore zuzar!

Po ti të gjitha këto i ke mëkuar teksa unë të prisja? Prandaj s'vije natën, kur unë të dëshiroja aq shumë?! Më duhet ta shoh më ndryshe dhomën tënde të eternitetit dashuror. Dale t'i numëroj pak. Si, si? Ç'më duhen? Kot, sa për kureshtje. Atëherë, 10 tek muri përballë, 15 tek ana e majtë e syrit të majtë, 20 tek ana e djathtë e syrit të djathtë, 5 ende në dysheme, si duket sapo kanë ardhur dhe po bëjnë adetet. Hmmm. Jo keq për një dhomë kaq të vogël. Ec pas meje, le të ngjitemi më lart.

Po keto të shkallëve ti i ke patur apo i ka ndonjë sy tjetër? Ptuuuu race e keqe. Po tani i bie që idiotja në këtë mes të jem unë?! Ah ti,…ti! Ti do plumbin në bebëz të syrit thuaj, por skam si të të vras!!! Me një thikë?! Ua paske marrë mirë dorën vrasjeve! Kriminel i lindur paske qënë. Ah! Me fal! Ti vetem sheh vrasjet???!!! E kush i vret? Ma thuaj…Heshtje! Normal, s'kam si të pres të flasësh për krimet e tua!

Lëre fare. Përtoj t'i numëroj dhe këto të shkallës. Edhe ato të tavanit. Pa shiko! Një dritë. Aty duhet të dalim. Eja. (bën sikur ngjit shkallë) M'u morr fryma! S'kam më fuqi! Të betohem. Më mbaj në krah si një dashnor i përvëluar! Si si? Mezi mban veten tënde? Egoist! Narcist! Ti merriton shpullën syve! Si si? Mos guxoj të ngre zërin? Ore idiot! E kupton se jam bërë gati të të hidhem në fyt me gjithë këto prova që po I shoh me sytë e tua dhe të miat bashkë! Po thuaj shyqyr që s'të mbaj dot mëri se të ishte ndryshe e shihje pastaj.

Ja e humba fare tani. Nuk di nga të shkoj. Drita ishte këtej. Nga humbi. Drita! E pe? Pse s'flet? Ti ishe këtu me mua dhe tani nuk e mban mënd ? Pse e fsheh dritën SY? Pse nuk më le ta shoh? Po bëhet errësirë e madhe. Më mbaj pas vetes. Kam filluar të ftohem. E ndien dhe ti? Po, dhe ti ke filluar të ngrish. Hajde sy! Të kërkojmë dritën. Nga iku? Më thuaj nga të marr,

majtas apo djathtas (këmbët e saj nuk lëvizin)

Duhet të ketë një lumë dreqi ta hajë. Styxi pra. Si, nuk të kujton gjë ky emër? Pse tallesh me mua?! A thua se unë nuk e di se ti i di të gjitha? A thua se unë nuk e di se ti nuk do që të tregosh ASGJË! Nga çfarë ke frikë? Apo nga e vërteta që ruan këtu brenda prej kohësh? Hmmm. Gjithmonë të them se duhet ta shoh në një tjetër këndveshtrim errësirën që më ke ofruar. Se duhet ta gjej vetë të vërtetën. Ajo duhet të jetë e ngurosur këtu. Më jep një lopatë! Si? Nuk mund të më ofrosh as edhe një lopatë?! AGRRRRR si s'je për një gjë të vlefshme dreqi e mori! Nuk ma rrëfen as ku është lumi. Nuk më jep as puthje. Ka gjë më të keqe se kaq? S'ka! Dhe prape pa ty s'bëj dot! Mirë, mire!

(ulet ne dysheme dhe fillon të gërrmojë dyshemenë me dorë)

E sheh?! Po gërmoj me thonj. Kjo do të thotë se jam bërë nje arkeologe. Tek ne titujt vetëvendosen. Por në dallim prej të tjerëve po ta lë ty të më dekorosh. Mirë mire, se bëj shaka. Mos u mërzit. Jaaaa e gjeta. E sheh? "Kush gërmon gjen?. Unë e gjeta atë, e gjeta! (e mbështjell në dorë) Ti fshihe sa të duash, por harron se hija e saj, copëzat e saj, të vërtetat si u them unë ndryshe, mbillen në çdo truall. Çdo truall ka një mit krijimi, ai që unë dua të nxjerr nga ty sepse ti më çmënd, më heq trurin, më kalb me lashtësinë tënde! Kuptove?

(Çohet) Ku iku. E kisha në dorë. Ishte thesari më i madh që kam gjetur në jetën time. Një hiç. E di. Ti je një hiç syri im. Je një hiç që mbledh në veten tënde mitin e asgjësë dhe të gjithçkasë, më shpalos në syrin tënd të rizgjimit dhe më torturon! Dhe unë prapë ty të dashuroj, por kurre s'të bej dot që dhe ti te me duash mua! Pse? Pse? Pse???

Gjarpri! E sheh? Iiiiiiiiiiiiiiiii ai po kafshon vetveten. Gjarpër mos! Rri këtu me mua dhe me këtë sy matuf. Uaaaaaaaaa shife! Ai ka formën tënde tani, formën e pafajësisë! JOooo! Mos e merr syrin tim. Gjarpër! Joooo! (bie poshtë pa ndienja)

(Pauz)

Ku jam?

Sy?!

(Sheh nga muri.)

Oh syri im i dashur! Paskam qënë në ëndërr. Mendova se re në një gropë thithëse dhe të humba përgjithmonë. Zot, sa të dua. Të të puth pak? Vetëm pak. Të lutem. Eja, pranë meje. Pooo! O DIO MIO! Po më me xhentilesë. Si makineri më dukesh ndonjëherë! Sa ëmbël kur trazon kurmin tim me bulëzat e tua të gishtave. I adhuroj ledhatimet e tua! Mos më pyet kot se pse! Fundja, femër jam, pse mos më pëlqejnë? Ti di të bësh dashuri si në kohët nazike! Pash zotin! Mos m'u afro më! Ma shpife!

(Pauz)

U mërzite?

Sy?!

Pse po qan?

Sy?

C'po ndodh me ty?

Sy?

M'u pergjigj!

(Pauz)

Po pse nuk flet? Unë të dua! Sy! Ti sikur ke bërë armëpushim

me gjuhën time! Ke kohë që nuk flet. Nuk han. Nuk më thua më asgjë. Rri gjithmonë i mërzitur, shpesh herë sikur kërkon të rrebelohesh, të hidhesh me thonj nga të gjithë dhe t'i mbytësh, madje dhe mua.

(Pauz)

Asgjë nuk është siç duhet, e di, por ma thuaj dreqin ku të kapem për të kërkuar atë që ti kërkon të gjej? Ka raste bëhesh i mirë. Unë bëj gjithçka mundem të të marr me të mirë por më kot. Ti më urren! Më ke urryer gjithmonë! Gjithmonë, gjithmonë,… sepse kam qënë më e mira!

Pa më thuaj pak pse rri me mua? Pse nuk del nga unë dhe jeta ime? A nuk e sheh se sa sy të tjerë ke mbledhur pas vetes? A nuk e sheh se sa shumë të deformojnë? Ndoshta jam gabim, por çelësi është KËTU! Duhet ta gjej. Unë e kisha pak më parë. Në ëndërr, sigurisht. Kur hap sytë, gjithçka gjej, zhduket! AGRRRRRRRRR

Ah sikur një ditë të mundem ta gjej atë thesar, do tua tregoj dhe këtyre idiotëve këtu, vetëm atëherë kanë për të më besuar se unë s'i kam gënjyer, se s'jam një e çmëndur, se kam të drejtën të shoh më thellë. Thënë drejt, ndoshta jam pak e çmendur, por me saktë do shkonte e marrosur pas teje o syri im i mirë. Kurrë s'më kuptuan. KURRË!

(Nxjerr nga gjoksi një letër)

Të gjitha mund të m'i rrëmbejnë vetëm këtë jo! Këtë kurrë s'kanë për të ma rrëmbyer! Është çertifikata ime! Të gjitha m'i kanë bërë copë e çikë, ose të paktën unë s'mund t'i gjej më. Kurse këtë jo! Hahahahaahaha! Këtë s'mund të ma ndërrojnë kurrë dhe pse aty,… shttttttt afroju, s'duhet ta dëgjojnë këtë,

(me zë të ulët) aty mund të shkruajnë çdo gjë. Një ditë do të vdes, punë e madhe, trupi im do të muroset dhe do të vijë dita që dhe kjo letër do të dale. Ti do të rrëfesh të vërtetën apo jo syri im? E pra! Sa e qetë ndihem kur ti je prane meje. Më duket sikur je engjëlli im mbrojtës. Më mban plot shpresë iluzioni se ti do të dish të thuash një ditë të vërtetën.

Mos është kjo arsyeja që unë jam këtu sy? Ua ke treguar sekretet e mia ti? Ata më dinë për të çmendur, më kanë denoncuar si një vrasëse të shëmtuar, por të betohem, unë vetëm fotot e tyre kam, fotot e atyre që të vardiseshin ty pa pushim, sigurisht, e që s'mund ta mohoj se i urreja për vdekje, por nuk ua kam uruar kurrë fundin. Asnjërës! Të betohem për gjënë më të shtrenjtë që kam, për syrin tim! Për ty!

Shtttttt! Po dëgjohen hapa! Mos fol. Mos shkrepëti! Këtu po vjen dikush. E ndiej. Ndiej hapat e tij të çmendura. Oh zot çfarë po ndodh? Ç'është kjo kuisje në rrugë? Kush ka vdekur? Kush? Sy? Më thuaj! Unë nuk vrava njeri! Të betohem! Këtë rradhë kam qënë me ty. Në ëndërr…. Nuk di ç'ndodhi por unë s'kam bërë asgjë!!!

Shtttttt! Mbaje frymën, e ne mos e mbajtç, bëj sikur të paktën. Kush rreh kaq shumë ti apo zemra ime? Dreq! Sa u tremba. Qenka një mace me këmbë të thyer. Pis pis pis. U tremb! Kaq shtrigë u dukem të gjithëve unë sa dhe kur dua t'i ndihmoj do të më kthejnë shpinën? Pikë e zezë!

(Shtrihet në dysheme)

Zemra ime je ti! Shpirti im je ti! Fryma ime je ti! Të dëshiroj kur vjen kështu pas meje! Dashuria s'është mëkat shpirti im! E di, mos qaj, të gjithë gabojmë. Unë nuk mërzitem me ty. Unë

di të të fal. Të kam falur! Kështu të fal çdo natë dhe në mëngjes ripërsëritet sërisht e djeshmja.

Mos ndoshta kam humbur ritmin e kohës? Më thuaj ku jemi? Ne ç'shekull? Mua të gjitha ditët më duken të njejta. Asnjë nuk është ndryshe nga të tjerat. Te gjitha njëlloj. Vetëm se ndonjëherë, mezi marr frymë. Ndonjëherë mezi qëndroj në këmbë. Ndonjëherë më rrahin, por është e njëjta ditë. Jam e bindur. Kur e shkulën filizin tim, të padalë ende prej meje, ashtu siç po e rrisja me dashurinë e një nënë, ti e di, kam vuajtur mjaft. Nuk e harroja dot. Nuk mund t'ia harroja dot buzëqeshjen që do të kishte, qarjen që do të më zgjonte, kënaqësinë që do mëe dhuronte. Po sytë e tij? A janë vallë tek ty? Mirë, mire! Më fal, do përpiqem ta harroj, kështu më thonë dhe doctorët! Nuk duhet të kujtoj asnjë gjë të trishtë!

Sy! Nuk më mbajnë më këmbët. Jam e lodhur. Shpirti im u prehte në paqe një ditë me çfarë heqën këtu. Por, e di? Ndonjëherë mendoj se s'ka kuptim as paqja. Njeriu duhet të jetojë si unë që ta dijë vlerën e fjalëve që i përdor aq solemnisht në takimet serioze. Serioze them unë se ato janë për të qarë hallin. Hahahahha!

(Pauz)

Po më këput gjumi. Mos më ler të ëndërroj. Ëndrrat janë të frikshme.

Shttttttttt! Sërisht dëgjoj hapa. Ato po shtohen syri im. Ato po vijnë drejt nesh. (Çohet në këmbë) Më lidh. Më lidh. Nuk i dihet! Mund të jenë ata! Ata s'mund ta durojnë lirinë time, ti e di. (Duart e saj lidhen) Sy! Mos ik! Rri me mua! Ja, ndieva derën të hapet. Sy. Nuk janë ata. Janë hijet! Zot, mos i ler të më

prekin. Të përgjërohem. I urrej!

(Pauz)

Duhet të mos mendoj më për gjëra të tilla. Ndoshta unë u klith vetë klithjeve…

(ulet tek krevati dhe fillon të përkundet)

Nina nana nina o, që ta zërë gjumi o!
Nina nana vajzë fli, që të rritesh shpejt moj bijë!

Hahahhahah! Të rritem?! Pse jo të vdes? Të vdes e të shpetoj njëherë e mirë nga kjo jetë e shpifur dhe e pështirë? Ah! Harrova. Syri im do që të shoh çdo gjë. Te mirën dhe të keqen! Apo jo, sy? (duke parë syrin në mur)

Kur do të agojë? Është kaq errësirë këtu. Nuk dua të kem mysafire veç hijet. Kur do të vijë agimi, syri im? Mos bëj gafë të lëshosh shkrepëtima që të marr vesh se ka ardhur! Jo! Lëre të vijë vetë. Ngadalë, ngadalë… Do të vijë vetë me këmbet e tij të vogla infatile..hahahahahah

Sy! Të betohem! Sikur të mos ishe këtu me mua do të kisha vdekur me kohë. Ti në njëfarë mënyre më ruan.

(Pauz)

Oh ç'bëjnë ata? Pse nuk vijnë?! Ishin këtu. Unë ua dëgjova hapat. Më është bërë si gangrene ardhja e tyre në të njëjtën orë, në të njëjtën ditë. Kritikat e pamasa për ecurinë e shëndetit tim, a thua se unë jam shkaktarja që e mbyll veten këtu apo ata që më sollën? Thuama sy. A jam unë fajtorja?

Dikush po vjen. Janë hapa femre. S'mund ta shoh dot kush

është. Është kaq errësirë këtu.

Kush je?

Pergjigju!

Askush sdi te flase ne gjuhen time?

Unë ju ndjej kur vini drejt meje, madje dhe kur më prekni, dhe kur më gërryeni.

(Pauz)

Doktori është idiot total. Ka syze të trasha sa ndonjëherë duket sikur ka dy lupa fëmijësh, relativisht të mëdha, e të lidhura me ankerplast. Hahaha. Kur afrohet me atë hundën e tij të shtrembët dhe kur më lëshon frymën në gojë gjatë visitës m'i sjell zorrët lart. Por ç'e do. Ai thotë se jam unë ajo që e shkaktoj këtë gjëndje, se po të dua unë mund ta frenoj veten nga të gervishturat që gjen në trup, nga çarjet e lëkurës që ndonjëherë i duhet të rrijë mbi 2 orë të më mjekojë, e ndonjëherë bën sikur më mjekon si për të plotesuar orarin e punës.

Mos i trego kujt për ëndrrën, sy! Askush s'duhet ta dijë se ç'bëjmë ne të dy, mirë? Ti do të më jesh gjithmonë besnik dhe do të më ruash deri në fund, apo jo? POO e di! E di.

(Pauz.)

Mos më kap për fyti, Sy! Ti sapo më premtove se do të ishe besnik dhe do të më mbroje nga çdo e keqe. S'marr dot frymë. Lëshomë idiot. I kam duart e lidhura harrove? Sy! Jo, s'qenke ti, qenkan nje tufë duarsh që kërkojnë të më mbytin. Mezi I shoh! Mos janë HIJE?! O zot sa shumë paska. Ato po shtohen gjithmonë e më tepër. Sy! Më ndihmo! Tregoju një perrallë, Syyyyyy! Mos më braktis tani. Ohhhhhhhhh trupi im! Ato po

më gërryejnë me thonj. Unë jam e lidhur sy! Me ndihmo! Mos i lër të më bëjnë keq. Syyyyyy!

Kush dreqin janë këto duar?! Hiqmuniiiiiiiiiii! Mos më prekni lekurën. MOSSSS! Unë s'kam bërë asgjë të keqe. Si? X, Y, Z? Nuk ka mundësi. S'ka mundësi. Sy? Ti i ke kundërvënë? Ato duan të më shkulin syrin tim! Syyyyy! Duan të ta ngjitin në bebëzën tënde, së bashku me miliona e miliona të tjerë! Ohhhhhhhh mos i ler të lutemmm! M'i zhduk! Syyyyyyyyy!

(bie në krevat pa ndienja)

FUND

REQUIEM PËR NJË ËNDËRR

Personazhe:

MIKELI – Emigrant në Itali që kthehet për të jetuar në Shqipëri.

ELIRA – E dashuruar me Mikelin.

NAJADA - Kliente e rregullt e lokalit Blue Star

PETRITI – Pronari i lokalit

Kamarieri

Një i moshuar që shet lule

Një fëmijë që shet paketa

Një balerinë.- simbolizon Shqipërinë. Ajo futet në skenë sa herë që flitet për të.

Akti I

Nëntor 2008. Bar kafe 'Blue Star'.

(Mikeli duke ecur, për një moment, ndalet!

Një zile telefoni bie…!

Fut dorën në xhep. Kërkon… Dora humbet në xhep! Ndërron dorën dhe sheh nga xhepi tjetër… E rrotullon brenda tij dhe nxjerr një aparat! E sheh... Shtanget pak! Mendohet… ta hapë apo jo?!

Tring-tring… Zilja vazhdon të bjerë.

Vendos ta hapë!)

MIKELI: Aloo (*Një përgjigje me përçmim*) Po, unë jam! (*Buzëqesh..*) Ç'kemi? Si je? *(Rrotullon sytë i lodhur. Sheh lart. Largon pak telefonin nga veshi. Dëgjon blla blla blla në ajër... bën një gjest me dorë t'i largojë.)* – Blla blla blla *(Pëshpërin duke përqeshur zërin që dëgjon në ajër. Vë telefonin në vesh*).

Zemër, ti e di! Unë.. po *(Merr çehre serioze)* PO! *(Irritohet*) Ti e di më mirë se unë... *(Largon telefonin në ajër. Hesht. Dëgjon. Psherëtin blla blla blla pa zë vetëm duke treguar gjestet me dorë. Vë telefonin në vesh*).

Kuptoj! (*Duke shikuar orën*) Më duhet të shkoj... (*Heq telefonin nga veshi. E sheh me inat. E vë prapë në vesh*).

Jam shumë i zënë! (*Përpiqet të krijojë zhurma me këmbë.*) Kam shumë punë thashë.... Mirë.. mirë. Ok, hajt se shihemi! (*E fut me të shpejtë telefonin në xhep. Rënkon. Shfryn. Sheh se ndodhet para derës së një lokali. Hyn brenda. Kamarieri afrohet të marrë porosinë.)*

KAMARIERI: Mirëmbrëma!

MIKELI: Mirëmbrëma! Jeni i ri, këtu?

KAMARIERI: Pak a shumë! Çfarë dëshironi të pini? (***MIKELI*** *Hesht! Shikon orën. Fërshëllen nëpër dhëmbë! Sheh sa i gjatë është kamarieri dhe ul sërish sytë në tavolinë*)

KAMARIERI: Zotëri, çfarë dëshironit të pinit thatë?!

MIKELI: Ku më pe mua të flas?!

KAMARIERI: Doja t'ju rikujtoja se jam këtu për t'ju sjellë porosinë, zotëri!

MIKELI: Po ti as për këtë s'je, po hë. Apo, e ke gjetur me miqësi këtë punë?

KAMARIERI: Jo zotëri! (*Pauzë.*) Jam këtu për t'ju shërbyer juve, Zotëri!...

MIKELI: E po që je për atë gjë e di, por ça po bën, a e di?

KAMARIERI: Po pres porosinë tuaj.

MIKELI: Mirë. Më bëj një gotë me "lotë Neroni". *(Pauzë.)*

MIKELI: Hë! Nuk e di?

KAMARIERI: Zotëri, menuja jonë thotë:..

MIKELI: Lëre menunë mënjanë. Bëhu pak artist. Kur të vjen ndonjë femër e bukur këtu, si i thua ti, s'dua të të jap të pish? Po pse ore, dhe në pije do bëni diferencime ju? Turp t'ju vijë!

KAMARIERI: Zotëri.. (*Pauzë e shkurtër*) unë po pres porosinë tuaj! Nuk e di për çfarë diferencimi flisni, por për ta thënë sa më shkurt: Çfarë pijeje me apo pa alkool dëshironi të pini?!

MIKELI: Një kafe shqeto, loku, se ma hoqe petllën!

KAMARIERI: Vetëm kaq?

(Heshtje. Hyn Najada e veshur me një mini të zi, të çarë anash, këmishë mëndafshi, të ngushtë pas trupit, shoqëruar me një ecje delikate; këpucët me taka pak më të mëdha se këmba e saj, e herë- herë gjatë ecjes, krijojnë boshllëk mes këmbës dhe tokës dhe e pengojnë në ecje, në njërën dorë mban një çantë me një palë çarçafë të rinj.)

NAJADA: Si s'i rregulluan një herë këta trotuarët xhanëm!

MIKELI: (duke iu drejtuar kamarierit) Ah, mos harroj! Më bëj një Albratos, të lutem?

KAMARIERI: Patjetër!

Të dy vështrojnë njëri-tjetrin. Mikeli i bën me shenjë vajzën. Kamarieri zgërdhihet dhe drejtohet nga banaku. Vajza e sheh me indiferencë. Mikeli rri në vend dhe i hedh një përshëndetje

duke i buzëqeshur. Najda saluton me sy. Hap çantën, nxjerr një kuti të vogël, e hap, shihet në pasqyrë. E mbyll, e fut në çantë. Hap celularin, kërkon një numër, klikon mbi të, vendos aparatin e celularit në vesh.

NAJADA: Alo, po, po, këtu jam! Po te pres. Po... siç e lamë. Do vish ti? Po, mirë. Po të pres. Mirë, mos u vono! (*Mbyll telefonin dhe e lë mbi tavolinë. Vendos çantën poshtë tavolinës. Kamarieri vjen të marrë porosinë...)*

KAMARIERI: Mirëdita!

NAJADA: ...dita (*Përgjigjet me gjysmë zëri*)

KAMARIERI: Ç'dëshironi të pini?

NAJADA: Një kapuçino.

KAMARIERI: Me apo pa shkumë? Shllak doja të thoja...

NAJADA: Pa shllak, të lutem.

KAMARIERI: Patjetër!

(*Shkëmbime buzëqeshjesh sa të përzemërta, aq dhe të padëshirueshme.*)

(*Mikeli bën sikur sheh orën. Hedh sytë vërdallë. Vazhdon t'i japë konfidencë vështrimesh vajzës. Ajo bën sikur nuk sheh. Merr pasqyrën, kontrollon tualetin, përplas buzët dhe sheh rrotull me bisht të syrit...*

Mikelin s'po e zë vendi. Zhyt dorën në xhep, kërkon, e gjen, jep një nënqeshje, e merr në duar, përpëlit sytë në ekran, e fut telefonin në xhep dhe hesht sërisht. Rreh me mollëzat e gishtave tavolinën.)

MIKELI: Ju vjen keq t'ju pyes për një gjë?

NAJADA: Aspak!

MIKELI: Kam ditë që ju shoh të vini këtu dhe me sa duket, jeni një kliente e rregullt në këtë lokal. A mund t'ju ofroj një

pije? Shoh që po rrini vetëm.

NAJADA: Po pres dikë...

MIKELI: (*Duke mos ia vënë veshin*) Për mua të qenit i vetmuar do të thotë të jesh si nën narkozë! Në atë gjendje, fillimisht ndjen çaste të bukura, të këndshme e do të mund të meditosh apo ëndërrosh sikur jeton në një botë krejt tjetër *(çohet në këmbë, mbledh duart pas gjoksit)* e më pas, sheh shpirtin tënd të mjegulluar në një filxhan bosh! Pije – të thotë! Ti e gjerb, e rrëkëllen dhe shpirti yt i vetmuar s'mund të shkëputet më prej tij. *(Ulet në karrige.)*

NAJADA: Uh! Ç'fantazi ?!

MIKELI: Sigurisht, pasi ky është realiteti, zonjusha...?

NAJADA: Najada. Shkurt më thërrasin Nada.

MIKELI: Gëzohem që u njohëm. Unë quhem Mikel. *(Najada saluton me kokë.)*

MIKELI: Më lejoni të ulem këtu pranë jush? *(Najada pohon sërish me krye.)*

MIKELI: Po hë, ç'thotë Jeta?

NAJADA: Kush? Ah, Jeta. Jeta mirë. Shtyhet. Jo keq.

MIKELI: (*Me hipokrizi*): Një gonxhe si ju, duhet të njomë petalet me vesë çdo mëngjes, kurse një kërcelli gjëmbor trëndafili, si unë, do t'i mjaftonte dhe një ujitje e vakët, qoftë dhe me ujë kanali. Eh! Iku dhe rinia ime. Dikur thurja vargje, recitoja sonetet e Shekspirit mbi ata bunkerët e vegjël, që sot nuk janë tjetër veçse disa tualete publike, *(me ironi)* që të kënaqin me aromën e tyre të rafinuar. Dikur u këndoja vajzave ca serenata pe Korçe (*zgërdhihet*) që ç'të të them (*qesh*). Por fitorja më e madhe për këtë akt fisnik do të ishte, pa dyshim, një legen uji ardhur nga lart, i cili plluq, do të të bënte si një pulë të lagur. Shyqyr Zotit që ujin e kemi me orar thuaj. Mendojnë për

ne. Jooo, mendojnë sinqerisht. Madje u lumtë atyre që s'e kanë hequr nga mendja këtë taktikë se ndryshe, do më vinte turp ta ekspozoja dordolecin rrugëve çdo natë.

(*Najada qesh dhe skuqet.)*

NAJADA: Si bëni ju, sikur sapo keni dalë në pension?

MIKELI: Në pension jo, por në asistencë vullnetare, po. Nuk punoj, shkurt muhabeti. Sapo jam kthyer nga Italia. Mendoj të rri kështu për një kohë të gjatë. Ndjehem më mirë. Sa herë bie fjala për punë, bëj çmos ta shtyj sa më shumë që të mundem. Por ja që ndonjë miku nuk ia kthej dot, kështu që në ato momente më mirë mos të më flasësh se... (pauzë) Jeta është e shkurtër. Duhet gëzuar apo jo?

(*Najada tund kokën.)*

MIKELI: Megjithatë, nuk është dhe aq keq kështu! Fundja, pse të punosh kur mund të rrish?!

NAJADA: Ke të drejtë, por jo të gjithë mundet ta përballojnë jetesën pa punë. Për mua do të mjaftonte një punë çfarëdo, tashmë, pak rëndësi ka se çfarë!

MIKELI: Ah, jo! Ka punë dhe punë! Ka punë dhe punë! Personalisht, u bë më shumë se një muaj që jam kthyer, por ende nuk kam vendosur të rri përfundimisht apo të iki sërish në Itali. Po të rri, mbase do të hap ndonjë biznes timin. Nuk do të mund të punoja për dikë tjetër, marrë parasysh rrethanat e këtushme!

Ende nuk e di se çfarë do të bëj.

(Në skenë hyn një balerinë, me fytyrën gjysmë të lyer me të zi dhe gjysmë të lyer me të bardhë. Me krahët e saj bën gjeste që tregojnë kontradiktën. E majta kundër të djathtës dhe

anasjelltas. Ajo vazhdon të qëndrojë në skenë për pak dhe më pas largohet)

Nuk më ka hipur dëshira për t'u kthyer. Është hera e parë pas kushedi sa kohësh që po më pëlqen të rri në këtë vend. Madje ta shijoj këtë qëndrim. Emigrimi në Itali më mësoi shumë gjëra, përfshi këtu edhe punë nga më të ndryshmet. Puna është se, sa më i durueshëm të jesh, aq më shpejt mëson dhe i përshtatesh ambientit ku jeton. Unë isha i ri. E kapa veten mirë, por një ditë më erdhi shpirti në majë të hundës dhe u ktheva. Nuk më rrihej më. Dukej sikur një kujtim i dikurshëm kishte arritur të mbillte farën e vet në kraharor e të digjte, të zhuriste, të malloste, të përpinte qetësinë time. Emigrimi veçse shkatërron jetët e njerëzve! Këtu të paktën, frymon lirisht, dhe pse kjo mund të duket si delir!

NAJADA: Domethënë nuk punoni?

MIKELI: Nuk më pëlqen të bie në përsëritje. Më shumë i papunë sesa i punësuar.

(Najada sheh rrobat e tij firmato dhe ëmbëlson buzëqeshjen.)

NAJADA: Në dallim nga ju, unë përpiqem të studioj dhe të punoj njëkohësisht!

MIKELI: Keqardhjet e mia, zonjushë e nderuar! *(Najada qesh.)*

MIKELI: Edhe macet që kanë nga 7 shpirtra rrinë dhe ngrohen ndonjëherë në diell, mos të flasim pastaj për adetet e tjera...

NAJADA: Nuk do ta imagjinoja dot veten ndryshe... Pastaj, këtu pak mundësi ke për të përballuar jetesën. Asistenca është e vogël dhe s'mjafton as për nevojat primare, le më për ato sekondare apo për të realizuar ëndrrat tona rinore! Me pak

fjalë, këtu po nuk punove, mbarove!

MIKELI: Hajde hajde... Qenke specie nëzhdukje me pak fjalë... *(Najada e sheh shtrembër.)*

MIKELI: Për mirë e thashë...

(*Najada ul kokën. Pllakos një heshtje e shkurtër.)*

NAJADA: Këtu, shumica e njerëzve ankohet se nuk gjen dot punë, kurse një pjesë e mirë, përgjithësisht të rinjsh, e shohin punën me meskinitet… Unë duhet ta konsideroj veten me fat që e kam gjetur një…

MIKELI: E drejtë! (*Pauzë.*) Çfarë pUnë bëni?

(Najada hesht. Sheh rrugën përtej xhamit. Buzëqesh.)

NAJADA: Mjafton që është punë dhe që nuk i bie në qafë nënës sime për shpenzimet e mia.

MIKELI: Kjo është gjë e mirë!

(Kamarieri sjell pijet…)

Mikeli do ta bëjë gëzuar. Merr gotën dhe e përplas lehtë pas kapuçinos.)

MIKELI: Gëzuar!

NAJADA: Gëzuar!!!

(Pas xhamave të lokalit është një vajzë, e hollë, çehrevrarë, veshur në të zeza. Ajo mban në kokë një vello të zezë dhe kalon para xhamave duke vështruar përmes vellos brenda lokalit. Duket si një hije që vëzhgon nga larg. Me duar përpiqet të shprehë lëmshin që i është mbështjellë në kraharor. Ndërsa Elira, një studente shqiptare, që padashur përplaset me të, hyn në lokal.)

ELIRA: (*Me ironi*) Uaaaa!!! Uaaaa!!! Uaaaaaaa, Mikeli!!! Po ti këtu? Çfarë surprize!!!

(Najada sheh Elirën dhe i buzëqesh me zor. Mikeli vëren hijen që i shëmbëllen me dikë që njeh. E sheh, por nuk arrin dot ta

ndërmendë kush është. Në të njëjtën kohë sheh Elirën e cila është në një segment drejtues me vajzën e panjohur. Mikeli sheh herë njërën e herë tjetrën dhe ngrin. Elira sheh nga të dy me kërshëri dhe xhelozi!)

ELIRA: *(Duke iu drejtuar Mikelit me ironi*) Kam gjithë ditën që i bie telefonit tënd e më dilte i zënë, me kë po flisje?! (*Pauzë.*)

MIKELI: Mira?! Mezi po prisja të vije! *(Del me vrap tek dera e lokalit por nuk gjen njeri. Elira është ulur në tavolinë. Mikeli afrohet drejt tavolinës së tyre, por qëndron në këmbë si i ngrirë dhe vazhdon të shohë jashtë. Askush nuk është më.)*

ELIRA: Mira?

MIKELI: *(I shokuar dhe pa i dhënë rëndësi Elirës)* Rina, se desh e ngatërrova.

ELIRA: Rina?

MIKELI: Ja, prapë u ngatërrova, Rudina doja të thoja!

ELIRA: Rudina?

(*Elira hap sytë. Fytyra e saj ndërron ngjyrën sikur të ketë filtra shumëngjyrësh nën lëkurë.)*

ELIRA Hmmm...

MIKELI: *(Ftillohet se ku është dhe se çfarë po bën dhe përpiqet të mos humbasë drejtimin e bisedës)* Hmmm...

ELIRA: Po bën shaka?

MIKELI: Je shumë e ëmbël, e di?

ELIRA Po bën shaka?!

MIKELI: Veçanërisht kur merr këtë pamje..

ELIRA: Po bën shaka?!

MIKELI: Po hë, si bën dhe ti! Pse, në gjendjen civile kam lindur unë?

ELIRA: Pra, nuk po bën shaka!!!

(Elira hidhërohet...)

MIKELI: (*Me ironi*) Mënyra më e mirë në këtë rast është të rrufitësh me të shpejtë pak alkool. Më pas mendja kthjellohet. Humnerat që kërkojnë të të përpijnë zhduken, hëna të duket diell, errësira dritë..

ELIRA: Hë!!! Hëna!!! ...

IKELI: (*Me hipokrizi*) Hëna bëhet diell, dielli zemër, zogjtë cicërojnë veç në kokën tënde. Klithmat të duken si simfonia e Bethovenit. Shpirti yt bëhet kalorës besnik i intrigave. ..

ELIRA: (*E hipnotizuar*): Ik se ma more mendjen!

(*Mikeli zgërdhihet… Najada qesh… Elira e gjuan lehtë në shpatull… Pason një heshtje e shkurtër! Bien kambanat e kishës… Mikeli çohet me seriozitet në këmbë, bën kryqin, ulet. Ato qeshin…)*

NAJADA: Qenkeni i krishterë?

MIKELI:: Pak nga të dyja. Edhe i krishterë, edhe musliburri. Nëna musliburrie, babai i krishterë. Asnjëri s'i ndjek ritet fetare. Lavdi Zotit!!

ELIRA: Të besosh është mirë!

MIKELI: Budallallëqe! Feja është opium! Opium fatal!

NAJADA: (*Duke qeshur*): Për ty të gjitha qenkan opium!

ELIRA: Unë mendoj se virus fatal është dashuria!

MIKELI: Por është e bukur ama!

NAJADA: Për mua dashuri do të thotë dhimbje!

MIKELI: Dashuri nuk do të thotë dhimbje. Mbase nuk ke gjetur njeriun e duhur. Po të kishe njohur ndonjë si puna ime, do ta shihje dhe ferrën trëndafil. Ky është arti i të dashuruarit. Qan dhe qesh në të njëjtën kohë!

ELIRA: Po pse duhet të qash kur mund të qeshësh?!

MIKELI: Ligjet e jetës nuk mund të thyhen, e dashur. Dashuria t'i verbon sytë dhe nuk të lë të shohësh se ke të bësh me një mulli ere donkishotesk, apo se ke të bësh me një betejë të vërtetë. Në dashuri je e verbër, në tradhti syshqiponjë! (*Mikeli zgërdhihet.)*

NAJADA: Në dashuri je e verbër, në tradhti syshqiponjë?!

MIKELI: Saktësisht kështu!

ELIRA: Të lundrosh në ujërat e Niagarës…

MIKELI: Të notosh në sipërfaqe, gjithmonë…

ELIRA: Kur s'di not...

MIKELI: Mbytesh!

ELIRA: Të notosh kur s'di not...

MIKELI: Vdes!

ELIRA: E gjallë mes të vdekurve…

MIKELI: Ec…!

ELIRA: Dhe bota është vetëm....

MIKELI: Njëngjyrëshe!

ELIRA: Bota ka ngjyrë…

MIKELI: Të kuqe!

ELIRA: Ecën në fushë...

MIKELI: Me gjëmba!

ELIRA: Gjëmbi..

MIKELI: Çjerr!

ELIRA: Gjëmbi duket petal…

MIKELI: I trishtë!

ELIRA: I braktisur!

MIKELI: I pambrojtur!

ELIRA: Foshnjëror!

MIKELI: I adhuruar!

NAJADA: Eh…!

ELIRA: Po hëna?

MIKELI: Hëna është Diell!

ELIRA: Klithmë!

MIKELI: Dëshmitare!

ELIRA: Vrastare!

MIKELI: Lajkatare!

ELIRA: Gënjeshtare!

MIKELI: Hëna bekon shtratet!

ELIRA: Është hajdute!

MIKELI: Hëna është qetësi!

ELIRA: (*Gati duke klithur*) Hëna është mashtrim!!!

(*pauze*)

(Mikeli çohet në këmbë. Sheh përtej xhamit nga qielli. Fokusohet. Bën ta prekë, por zmbrapset.)

MIKELI:

Kaltërsi qiellore
Vrerin e natës heq
Ditës dritë i jep!

ELIRA:

Dikur ëndërroja
të kisha dy krahë
si bletë të fluturoja
e të thithja veç nektar!

NAJADA: Jeta ime ..!

MIKELI: Jeta jote..?

NAJADA: Jeta ime, Pishtar shkretëtirash!

MIKELI: Saharash!

NAJADA:

Jeta ime? -

Pishtar shkretëtire;

ëndrrat

në një djep

i fsheh,

i mbledh grumbull

e nën flakët e tua

i djeg...!

MIKELI: Ahhh! Ju femrat…

NAJADA: Ne femrat!

MIKELI: Të trishta!

NAJADA: Të ëmbla!

MIKELI: Hyjnore!

NAJADA: Të dlira!

MIKELI: Idealiste!

NAJADA: Empirike..!

MIKELI: Ju femrat, engjëjt e shpresës, bërthama e tokës, mashtrimi i jetës!

ELIRA: Maskilist!

MIKELI: Ah, jo e dashur, jo. Monedha ka dy fytyra. Një kokë që drejton, një shpinë që peshon. E gjithë dilema qëndron në misterin e lidhjes së kokës dhe shpinës. Femra është vula e

mashkullit. Mashkulli, drejtuesi i saj.

ELIRA: Haa!

MIKELI: Mos u bëj ironike!

NAJADA: Tani po e qave!

MIKELI: Është e shkruar, e dashur!

ELIRA: Jo more!

MIKELI: Po e dashur, po!

ELIRA: Femra dhe mashkulli janë pjatat e të njëjtës peshoreje.

MIKELI: Civilizimi të ka verbuar, e dashur!

NAJADA: Civilizimi ka evoluar, i dashur!

MIKELI: Është shkatërruar, e dashur!

ELIRA: Është deformuar nga ju, i dashur!

MIKELI: Dakord, por s'është logjike!

ELIRA: Diktator!

MIKELI: Për mirë, e dashur!

ELIRA: Për keq, i dashur!

MIKELI: Përpiqu të shohësh anën pozitive. Çdo e mirë ka një të keqe. Çdo e keqe ka një të mirë. E mira e shoqëron të keqen. E keqja pa të mirën, s'ka si rri. Brenda të zezës sheh dritën ashtu siç sheh të mirën brenda të keqes... - Mos e harro këtë!

ELIRA: Haaaaaa!

MIKELI: (*Me hipokrizi*) Imagjinoje veten pas plazhit, kur ngjyra bronx mbërthen lëkurën tënde të brishtë. Ti ndodhesh në një dhomë të errët. Lëkura jote shndrin nën rrezet e hënës dhe kurmi yt shpërhapet mbi çarçaf. Kurmi yt fikson. Asgjëson frymëmarrjet. Mpin!

ELIRA: Kjo është gjë e mirë!

MIKELI: Gjithçka është e mirë nëse e sheh pozitivisht!

ELIRA: Je i keq!

(*Najada qesh.)*

NAJADA: S'thonë kot, ku ka trëndafil, ka dhe gjëmba.

MIKELI: Ku ka dashuri…

ELIRA: Ka dhe xhelozi!

MIKELI: Ku ka urrejtje…

ELIRA: Ka dhe miqësi!

MIKELI: Ku ka mirëqenie…

ELIRA: Ka dhe varfëri!

MIKELI: Bota është e rrumbullakët, por ka dy fytyra njëkohësisht: Njërën që e drejton nga dielli e tjetrën nga hëna.

ELIRA: Hë! Hëna…?!

MIKELI: Hëna, zemër, hëna! Por edhe Dielli! Ashtu si dhe njeriu, që është përçuesi i ngrohtësisë dhe ftohtësisë; mirësisë dhe ligësisë; jetës dhe zhbërjes; drejtësisë dhe krimit; dashurisë dhe tradhtisë; të kaluarës dhe të ardhmes; injorancës dhe dijes; virtytit dhe antivlerës, të mirës dhe të keqes. Jemi antiteza e tezave. I dimë se ç'janë, por i kundërshtojmë. *(Pauzë.)* Jemi antivlerat e vlerave. E dimë se duhen, por nuk i ruajmë. Jemi dualistë, që pa dy faqet e kundërta, kurrë nuk do të mund të gjenim qetësinë e Tokës. Po po! Qetësinë dualiste të tokës. Indiferencën e qenësisë. Vetë toka transmeton diplomacinë e dyfytyrshmërisë. Ajo rrotullohet edhe e plagosur. Rrotullohet krejt indiferente: njëherë nga Dielli; njëherë nga Hëna. Pa shiko, shiko lart Diellin! A nuk të duket mëkat ta braktisësh ngrohtësinë e tij për të pritur ftohtësinë e Hënës? Sigurisht që jo, sepse për të ke nevojë…

(Pauzë.) Kamarier. Me sill edhe një gotë tjetër, të lutem! *(Kamarieri pohon me krye.)*

(Pauzë.)

MIKELI: (*Me ironi*) E mirë, boll filozofuat tani!

ELIRA: Shih kush flet!

(*Mikeli zgërdhihet.)*

ELIRA: Sikur të ishe pak më ndryshe, do të ishte më ndryshe!

MIKELI: Çfare pive ti?

ELIRA: Ujë.

MIKELI: Të bëka dëm!

ELIRA: Pse?

MIKELI: Sikur të ishe më ndryshe do ishte më ndryshe!?

ELIRA: Po të vërtetën thashë! –

MIKELI: E vërteta jote sigurisht!

ELIRA: Hmm…

MIKELI: Hmmm.. E vërteta është ajo që beson ti se është e tillë, sepse ajo është relative. Ti e kërkon dhe beson se e gjen, por më vonë gjen diçka tjetër dhe e pranon si më të vërtetë, sepse është më bindëse se ajo e vërtetë që ti ke pas besuar si të vërtetë.

ELIRA: Më bëre lëmsh.

MIKELI: Kur ke qenë fill ti?

(Elira e shpullon në sup.)

(Najada qesh.)

NAJADA: Jeni shumë çift i këndshëm!

MIKELI: Nuk jemi ...

(Najada me vete: Lavdi Zotit!)

ELIRA: Faleminder... *(Sheh nga Mikeli. Hesht!)*

(Pauzë.)

(*Najada çohet në këmbë me delikatesë*)

NAJADA: Më falni pak (*Drejtohet nga tualeti*)

ELIRA: E sheh?

MIKELI: Merre më qetë ...

ELIRA: Kulmi!

MIKELI: Po ti digju njëherë, pastaj lësho tym! O po kjo! Kërcen pupthi si të jetë kangur i dashuruar.

ELIRA: (*Duke lotuar*): Ç'është kjo?

MIKELI: Kafshë është. Ç'është thotë?!

ELIRA: Edhe kafshë më bëre, hë?

MIKELI: O femër e eburricipuar!

ELIRA: Lëri ironitë se…

MIKELI: O femër e zgjuar, merre më qetë!

(*Elira e sheh në sy.*)

MIKELI: Po përse qan? I ke bërë lotët si rubinet çezme me telekoburridë. Sa dëgjon diçka, fap e hap dhe i lëshon.

ELIRA: Ti e di që unë për ty...

MIKELI: (*Me ironi*) ...s'do lije oqean dhe det pa tharë!...

LIRA: Ashtu hë?

MIKELI: Ashtu posi.

(Pauzë.)

MIKELI: Pastaj, po të kishe gjë për të bërë, e kishe bërë. Apo jo? *(Pauzë.)*

ELIRA: Çfarë do ti të bëj?! Çfarë nuk e kam bërë? Ma thuaj!

MIKELI: Elira! Jeta nuk është një top që ta hedhësh nga të duash e prapë të ruajë të njëjtat forma! Ajo kërkon lirinë e vet! Do kohën e vet që të piqet! (*Elira bëhet gati të flasë.)*

(Mikeli i vendos gishtin në gojë për të pushuar.)

MIKELI: Kjo vlen njëlloj edhe për mua. Unë nuk jam gati për këtë. Mua më pëlqen të jem i lirë, të shijoj vetëm momentin. Planet e mia më të gjata i kalojnë a s'i kalojnë pesë minuta. Më duket se nuk ta kam fshehur ndonjëherë këtë dëshirë, apo jo?

ELIRA: Por…

MIKELI: Më lër të mbaroj. Ti nuk je në gjendje të krijosh familje. Je ende një fëmijë nëntëmbëdhjetëvjeçar, që ka shumë ëndrra dhe dëshira për jetën e unë nuk dua të jem shkaku i vrasjes së tyre! Dua të jem realist dhe asgjë më shumë. Nuk po të premtoj asgjë. Do të ishte gjëja e fundit që do të dëshiroja.

ELIRA: Por unë…

MIKELI: (*Me hipokrizi*) Ti ke nevojë vetëm për një gjë, të arrish lartësinë e yjeve, të fluturosh në lirinë tënde, t'ia thithësh aromën dhe të ndjesh shijen e ëmbël të jetës; të jesh si një gonxhe që vesën e do vetëm në mëngjes dhe lashtën në mbrëmje. Më pas, të valëvitesh në flladin e ndjenjave dhe të kuptosh se sa e bukur është jeta, sa bukur është të jesh e lirë. Ti e ke këtë liri. Pse kërkon ta humbasësh? Këtë ende nuk e di!

ELIRA: I poshtër!

MIKELI: I dashur, e dashur. Të dua të mirën. Pse t'ia kthesh patkojtë diellit kur...

(Kamarieri sjell pijen e Mikelit.)

MIKELI: …kur shumë bukur mund të pish një Albratos rehat rehat.

(*Elira e sheh me inat. E merr gotën me nerv dhe e rrëkëllen me fund. Kollitet. I drejtohet kamarierit.)*

ELIRA: Edhe një të lutem!

(*Kamarieri pohon me krye.)*

MIKELI: Ja, kështu ka lezet. Femër moderne, jo llafe.

ELIRA: Të kam inat!

MIKELI: Është shenjë e mirë!

ELIRA: Të urrej!

MIKELI: Akoma më e mirë!

ELIRA: Për ty çdo gjë është xhevahir!

MIKELI: Sepse varet nga ua jep këndvështrimin gjërave. Unë shoh anën e mirë të tyre, jo si ty, fatalitetin!

ELIRA: Unë dua të jem realiste dhe jo ëndërrimtare!

MIKELI: Sepse je ëndërrimtare dhe kërkon të hedhësh themele të forta për kështjellën tënde.

ELIRA: Unë nuk ëndërroj kot!

MIKELI: Jo çdo gjë është e parashikueshme, e dashur. Jo çdo gjë. Madje asgjë!

ELIRA: Fatalist!

MIKELI: Optimist!

ELIRA: Ç'rëndësi ka? Je fatalist!

MIKELI: Çdo gjë e parëndësishme është po aq e rëndësishme sa dhe e rëndësishmja!

ELIRA: Boll me lojëra, se më ënjte! (*Mikeli e sheh në fytyrë Elirën)*

MIKELI: Të dhemb gjë?

ELIRA: Jo!

MIKELI: Epo ke ënjtje iluzive...

ELIRA: Dëgjo Mikel, lëri lojërat me mua se nuk të ecën. More vesh apo jo?

MIKELI: Ftohu pak!

(*Elira çohet në këmbë.)*

MIKELI: Ulu!

(*Elira bën të ulet, por çohet menjëherë. Vjen Najada dhe sheh*

me mospërfillje një plak që ndodhet tek hyrja e lokalit me një tufë trëndafilash të kuq në dorë. Ulet gjithë delikatesë dhe shpërfillje dhe buzëqesh nga të panjohurit.- Plaku afrohet drejt tyre-. Elira e sheh në sy. Rrudhat e tij i bëjnë përshtypje dhe mezi gëlltitet. Mikeli nuk e ka mendjen te ai. Herë pas herë, sheh rrugën dhe e fikson aty vështrimin ndonjëherë.)

PLAKU: Dëshironi lule zotëri, zonjusha?

MIKELI: Urdhëro?

PLAKU: Lule, zotëri. A dëshironi një lule këtu në tavolinë?

MIKELI: Na lër rehat o xhaje se nuk kemi ngenë e luleve!

PLAKU: Po këto nuk janë vetëm lule, more djalosh!

(Mikeli sheh nga plaku. Përqendrohet në vështrimin e tij. Shkëmbejnë mesazhin e syve. Mikeli ul kokën. Skuqet. Vazhdon të shohë nga rruga. Trembet. Mezi gëlltitet. Elira, tepër kurioze, sheh nga buqeta plot vëmendje.)

ELIRA: Mua si lule më duken.

(Mikeli sheh nga Elira me ironi.)

PLAKU: Më shumë se to. Lulja është rilindje! Jetë e falur rishtas! Delikate! E brishtë! E njomë! E bukur! Këta janë disa trëndafila të kuq, në pamje të parë, por pa shiko pak më thellë, çfarë vëren?!

ELIRA: Pistilin!

(Mikeli e sheh sërish me ironi dhe inat.)

MIKELI: Sa e cekët që je ndonjëherë…

PLAKU: Më thellë vajzë, më thellë. Përpiqu të lexosh shpirtin e saj! Përpiqu ta kuptosh vuajtjen, dashurinë e vrarë, pasionin që ende e mban gjallë! Ajo do të vyshket një ditë! Ndërsa ne njerëzit do të vazhdojmë sërish t'i vrasim, braktisim, prishim e shkatërrojmë, sepse ne vetëm këtë dimë të bëjmë më mirë!

MIKELI: Kjo është e vërtetë, por një femër e ka vështirë të shohë shembëlltyrën e vet!

(Elira fillon të ndjehet keq. Mbledh duart drejt kraharorit dhe ndjen një shtrëngim.)

PLAKU: Kurora e kësaj luleje është diell që ngroh çdo shpirt që e kupton. Po kur ajo të vyshket? Çfarë do të mbetet në dorën tënde? Kujtimi i një çasti të ngrohtë që të fali? Apo petalet e thara, të pajeta? Ne duam vetëm hidhësinë e jetës! Vetëm fundin. Ne nuk duam të kujtojmë çastet e bukura! Madje përkundrazi, sapo ajo fillon të thahet, e hedhim në tokë pa pikë mëshire, a thua se ky ishte misioni i saj në jetë?!

MIKELI: Më duket se kemi bërë të njëjtën shkollë ne të dy, xhaje!

PLAKU: Po çfarë shkolle thua, ore bir? Mua më ka kapur brezi ku gjithsej gjithsej bëheshin vetëm 5 klasë! A ka mësues më të mirë se natyra?! Jeta?! Dashuria e humbur?! Lumturia e vrarë?! A ka mësues më të mirë se humbja? Vetmia? Trishtimi? Do të arrini një ditë moshën time dhe do ta kuptoni ç'do të thonë këto fjalë!

ELIRA: Nuk i kam kushtuar ndonjëherë rëndësi një luleje, veçse kur isha fëmijë.

PLAKU: Ah, vetëm fëmijët ua dinë vlerën atyre.

ELIRA: E pse ua dinë vlerën? A nuk janë fëmijët ata që i këpusin? Kur isha e vogël, bëja shpesh buqeta me lule dhe ia çoja dikujt, ku sipas të tjerëve ishte një engjëll imi mbrojtës, ndërsa për mua një shtëpizë ku shpeshherë luaja me pllakat e varreve përreth, duke ngritur muret e një kështjelle e duke e zbukuruar me lulet që mblidhja. Aty madje kishte dhe disa kanaçe gazozash, ose disa shishe plastike që i përdornin për të ujitur. Në anën e majtë të kësaj shtëpize ishte një burim, e unë shkoja e mbushja ujë të freskët. Ç'kënaqësi ndjeja kur freskoja

fytyrën! Më pas rendja në atë fushë, ku më dukej sikur të isha princesha e humbur e ku ushtarët e mi nguroseshin, shtoheshin, e ku unë nuk e dija se ku fshihej meduza ime. Ku ishte vallë Perseu që do të më çlironte prej saj? Qaja hallin me foton, panoramën e vetme të asaj shtëpize, që për çudinë time, nuk fliste kurrë, veçse dëgjonte e ndonjëherë edhe më buzëqështë... unë e shihja... e ndjeja... hyja brenda botës së saj... Ndërsa më vonë kuptova se shtëpiza ime ishte një varr ku prehej trupi i një nëne që kurrë nuk arriti ta shihte frytin e vet.

PLAKU: E trishtë!

MIKELI: *(I prekur)* M'i jepni mua këto lule, zotëri!

(Mikeli ua ndan përgjysmë vajzave.)

PLAKU: Një ditë do të pendohesh për atë që ke braktisur në jetë, djalosh! Ky është mesazhi që këto lule po të japin tani!

(Mikeli sheh me habi nga plaku teksa largohet. Shkon tek dera. Sheh rrugën. Nuk ka asnjë lëvizje. Sigurohet. Afrohet nga vajzat dhe ulet në tavolinë.)

MIKELI: Me sa shoh, të dyjave ju pëlqejnë lulet.

(Najada shkëput një trëndafil nga buqeta dhe fillon të shkulë petalet. Të njëjtën gjë bën dhe Elira.)

NAJADA: Më kujtohet një lojë që luanim me lulet kur ishim të vogla: Më do, s'më do…

(Veçan) Ka lek? S'ka lek! Kjo është çështja!

ELIRA: Më do.. s'më do.. më do.. s'më do.. s'më do!

(Sheh nga Mikeli.)

Mikeli: Sepse kështu të është tiposur!

ELIRA: Nuk më është tiposur kështu, por faktet flasin vetë!

MIKELI: Faktet? Si mund të mendosh se ka fakte diku ku nuk ka filluar të zhvillohet një ngjarje?

ELIRA: Për ty, aty s'do të ketë kurrë ngjarje. Ngjarja jote hyn dhe del ashtu siç bëhet lutja në një kishë. Aq për ty është e

mjaftueshme. Por mos harro, Mikel! Një ditë do të pendohesh për lutjet që ke bërë... *(Duke parë orën)* Oh, më duhet të largohem! Do të kaloj këtej më vonë, sigurisht!

MIKELI: Ti e di!

ELIRA: Mirupafshim, Mikel. *(Sheh me inat nga Najada)*

MIKELI: Mirupafshim!

(Pauzë.) Sa të pëlqekan lulet!

NAJADA: *(Duke vazhduar të shkulë petalet dhe në numërimet e fundit me kërshëri)* Po, tashmë janë bërë si llotaria "Gërvisht dhe fito"

MIKELI: Dhe po e tha lulja se dikush të do, i ka vdekur nëna atij muhabeti, hë?

(Najada qesh)

(Në derë hyn Petriti. Saluton Mikelin. Sheh Najadën. Bën sikur s'e njeh. Hyn brenda në banak. Najada e sheh dhe shtang pak.)

(Në xhamat e lokalit shfaqet sërish e panjohura me veshjen e saj të zezë. Teksa largohet, Mikeli e pikas dhe shkon tek hyrja e lokalit për të parë. Asgjë. I frikësuar, ulet tek tavolina dhe sheh nga Petriti i cili s'e ka mendjen.)

MIKELI: Ja ku erdhi dhe bosi i lokalit. E njeh?

NAJADA: Nuk besoj!

MIKELI: Mirë, se me të flas më vonë! Ke dëshirë të dalim për një shëtitje? Më duket sikur këtu u mbarua ajri. *(Pauzë.)* Nuk vonohemi!

(Najada tund kokën)

MIKELI: Petrit, po dukem më vonë dhe flasim shtruar për atë që kemi lënë përgjysmë.

(Petriti tund kokën dhe vazhdon të bëjë llogaritë pas banakut.)

(Bie perdja)

Akti II

Mikeli ndodhet në lokal duke shfletuar një gazetë. Sheh orën. Psherëtin. Kamarieri po pastron banakun. Mikeli i bën me shenjë që të afrohet. Kamarieri i shkon tek tavolina. Sheh rreth e rrotull që nuk ka njeri dhe i afrohet me druajtje. Mikeli e sheh dhe krekoset.

MIKELI: Ku është pronari?

(Kamarieri ngre supet.)

MIKELI: Nuk e ditke, hë?

KAMARIERI: Ncuq.

MIKELI: Si 'Ncuq'?

KAMARIERI: Ncuq, s'di gjë!

MIKELI: Ka njeri tjetër në lokal?

KAMARIERI: Vetëm unë dhe ti.

MIKELI: Afrohu këtu. *(Pauzë.)* Më afër. *(Pauzë.)* Më afër. *(Irritohet)* Më afër thashë!!!

(Kamarieri afrohet me frikë. Vë veshin ç'do t'i thotë Mikeli me kureshtje dhe drojë.)

MIKELI: S'të ka lënë ndonjë porosi?

KAMARIERI: Ncuq. As më ka thënë, as më ka lënë gjë.

MIKELI: Kushedi si do ta ketë punën!

(Kamarieri ngre supet.)

(Elira shfaqet në derë. Kamarieri largohet me hap të sigurt. Mikeli ngrin. Buzëqesh me zor. Elira afrohet. Mikeli i bën me shenjë të ulet. Elira afrohet me ngadalë. Mikeli e fton sërish. Elira ulet. Ngrihet sërish në këmbë. Ulet përsëri.)

ELIRA: E pe?

MIKELI: Çfarë?

(Mikeli ngrin.)

ELIRA: Më preu rrugën.

(Sheh nga rruga.)

ELIRA: Edhe këtë kisha burrigut!

MIKELI: Ç'ka ndodhur? Pse je e shqetësuar?

ELIRA: Ishte aty. E zezë. E zezë.

MIKELI: Ku?

(Mikeli trembet. Çohet në këmbë. Shkon tek dera e lokalit dhe sheh rrugën.)

MIKELI: S'ka gjë! Çfarë ishte?

ELIRA: Një mace.

(Mikeli e sheh me ironi.)

ELIRA: Një mace e zezë… po më zhbironte me verdhësinë e syve të saj. Më pas mjaulliti dhe iku me të shpejtë nga ana tjetër e rrugës. Nuk e kuptoj, donte të më kërcënonte apo paralajmëronte?! Desha të këlthas... por nuk nxora zë... vetëm një ulërimë trishtimi përbrenda meje sikur këlthiste "Ters! Ters! Ters!" Macja e zezë është tersllëk! Zot i madh! Edhe këtë kisha burrigut!

MIKELI: Mirë, mirë... qetësohu. Mjaft me këto bestytni!

ELIRA: Si? Do të thuash se nuk i beson?!

MIKELI: Jo, Elira!

ELIRA: Gjyshja më ka thënë se një mace e zezë i preu rrugën nënës sime teksa shkonte në maternitet për të më lindur!

MIKELI: Elira, bestytnia është një paragjykim i verbër!

ELIRA: *(Pa ia vënë veshin)* Duhej të kisha ndërruar rrugën! *(Pauzë.)* S'më pritej sa të të shihja!

MIKELI: Prapë e le mësimin ti?

(Elira pohon me krye.)

MIKELI: Po pse?

ELIRA: Si thua ti, pse?!

(Mikeli ngre kryet.)

ELIRA: Mendon se kam faj?!

MIKELI: Do të ishte gjëja e fundit që do të mendoja! Kush ka faj në këtë jetë?! Faji është endacaku i ditës dhe i natës... Hyn e del nga çdo portë, e sërish, pa shtëpi e pa strehë ngel!

(Elira e sheh me dhembshuri.)

ELIRA: Mikel! *(Pauzë.)* O Mikel!

MIKELI: Unë jam!

ELIRA: *(Me ironi)* Vërtet?

MIKELI: *(Me ironi)* Po.

ELIRA: Nuk e kuptoj çfarë kënaqësie ndjen kur tallesh me mua dhe me ndjenjat e mia... *(Pauzë.)*

MIKELI: Nuk jam tallur! –

ELIRA: *(Pa ia vënë veshin)* Dua ta provojmë njëherë *(Pauzë.)* Pse nuk ma jep këtë mundësi? N.q.s ti vërtet do që unë të jem e lumtur më bëj atëherë të tillë! (*me zë të ulët*) *Ti duhet të jetë imi! Nuk mund të jesh I askujt tjetër. Unë të dua! Më dëgjon?! Më dëgjon? (me zë) Më dëgjon?!*

MIKELI (*Në siklet*): Të dëgjoj *(Pauzë e shkurtër)* ...të dëgjoj... *(Pauzë. Mendohet*) Por ti e di që… --

ELIRA: Mikel...

(Prapa xhamave të lokalit Mikeli pikas të panjohurën me vello të zezë dhe ngrin.)

MIKELI: Mira! –

ELIRA: *(Me inat)* Elira...

MIKELI: *(I shpërqendruar)* Blerina...

ELIRA: *(duke bërtitur)* ELIRAAA!

MIKELI: Më plase! *(Pauzë.)* Ja, më doli nga mendja se ç'doja të thoja! *(Kruan kokën)*

ELIRA: Elira!...

MIKELI: *(I tmerruar)* Elira pra Elira... *(Pauzë.)* Ah, po! *(Merr frymë thellë)* Doja të të thoja se unë të kuptoj shumë mirë pavarësisht bindjes që ti ke për mua. Ajo që unë dua nga ty është që dhe ti të më kuptosh... *(i shpërqendruar*) Unë jam mësuar në një ambient krejt ndryshe, jam ndjerë dhe do të ndjehem I LIRË deri në çastin e fundit që mushkëritë e mia të mbushen me frymë. Unë nuk mund të lidhem me zinxhirë dhe as mund të ndryshoj, e këtë do të doja ta dëshiroje dhe ti! Të kalosh një natë të këndshme, erotike, plot afsh dhe pasion nuk do të thotë dashuri, e dashur. Unë nuk ka-

ELIRA: Nuk do të thotë dashuri?!

MIKELI: Jo, të paktën për mua jo!

ELIRA: Domethënë... kanë qënë gënjeshtra të gjitha ç'më ke thënë?

MIKELI: Po jo, moj Rina, -

ELIRA: *(E nervozuar)* ELIRA!

MIKELI: Po... Elira! *(Pauzë.)* Nuk ishin gënjeshtra... Tek e fundit, çka është gënjeshtra dhe çka e vërteta? Gënjeshtra mund të jetë e vërtetë dhe e vërteta një gënjeshtër. Gjithmonë varet nga këndvështrimi që e shikon, çdo gjë!

ELIRA: Ç'do të thuash?|

MIKELI: Dua të them se ajo çfarë unë kam thënë gjithmonë ndaj teje ka qenë gjithçka që UNI im ka dëshiruar dhe ka ndjerë. Më kupton?

ELIRA: Jo!

MIKELI: Dua të them se unë i kam thyer të gjitha tabutë dhe klishetë e moralitetit e për mua janë të papranueshme kornizat që gjej këtu.

ELIRA: Jam konfuze!

MIKELI: Elira, unë nuk jam thjesht një njeri i veshur me

tisin e modernitetit! –

ELIRA: Nuk të ndjek dot...

MIKELI: Unë jam ai... ai të cilin ti nuk do ta kuptosh kurrë, sepse ne të dy ndodhemi në anët e kundërta të një humnere, brigjet e të cilës nuk do t'i lidhë kurrë një urë! Më kupton tani, e dashur?

ELIRA: *(Ironike)* E kuptova! Domethënë, të jesh modern, I TËRI, do të thotë të jesh imoral! Mos do të thotë kjo se, sa më shumë që përqafojmë civilizimin, aq më shumë do duhet të humbasim nga vlerat tona të lashta? Hmm. Kjo nuk ka për të ndodhur kurrë! ...

MIKELI: Por kjo ndodh... *(i bindur)* tashmë ka ndodhur!

ELIRA: Por është rruga e gabuar, i dashur!

MIKELI: Po nuk gabove, nuk mëson, e dashur!

ELIRA: Atëherë pse nuk më lejon të gaboj me ty? *(Pauzë.)* Në fund të fundit, nuk besoj se ti ke për të humbur gjë! Të paktën e provojmë! Nuk e ndjen se ka ardhur koha t'u thuash lamtumirë aventurave? Unë të dua! Ndjej për ty! Jam gati ta sakrifikoj gjithçka! Më quaj të marrë! Madje mund të më shtosh çdo etiketë që mendon se më shkon!

MIKELI: *(I mallëngjyer)* Ti kujton se ka mashkull në botë që nuk do të dëshironte, të dëgjonte, të paktën për një ditë të vetme të jetës së tij, këto fjalë? Dëgjo Mira…

ELIRA: ELIRA!

MIKELI: *(I shpërqendruar)* Po, Elira! *(Mendohet)* Dashuria ka kohë që ka dhënë shpirt tek unë. Madje jam i bindur se e njëjta gjë ndodh tek të gjithë. Ajo është përmbytur me kohë në trupat e rivalëve të saj. Nuk kam më fuqi të luftoj. Pse nuk arrin ta kuptosh dot këtë, e dashur?! Nuk ka më Romeo modern! *(Pauzë.)* Unë për ty e kam. *(Dridhet)*

Po ta shpreh më thjesht. *(Pauzë. Vazhdon të jetë i*

shpërqendruar)

Toka e ka ndryshuar me kohë rrotullimin e saj. Kataklizma ia rrëmbeu timonin dhe e ka shpërqendruar të gjithën! Madje jo vetëm kaq, por çdo piskamë kuitëse që Toka i drejton, ajo e merr dhe ia flak në ajër, aty, lart, ndër re... *(duke treguar me gisht përtej xhamit të lokalit)* pa pyetur e menduar se sa do t'i rëndojë kur t'i bashkëngjitet sërish si pelerinë dhimbjes së anijes Tokë, se sa do të kuisë lëngimi i saj… Ajo thjesht do ta qarkullojë. Asgjë nuk humbet në këtë botë, veçse zëvendësohet… Është ligji i energjisë! Ligji i ekzistencës!

ELIRA: O MIKEL! Interesi im vritet për diçka që nuk ka të bëjë me ty. E kupton kaq gjë?

MIKELI: Atë po të shpjegoj. Arsyen se pse ajo që ti dëshiron s'mund të funksionojë!

(Elira fillon të qajë…)

Ti je vajzë e mirë! Ke familje të mirë! Pse do që ta shkatërrosh? Ti nuk e meriton një njeri si unë! Më beso! Është e pamundur! Tashmë është tepër vonë për të ndryshuar jetën time!

ELIRA: Ku e di ti se kush jam unë? A nuk më ke thënë se ndonjëherë pamja gënjen? Ku më njohe ti mua për të bërë analizë mbi mua, dhe aq më tepër, të familjes time?

MIKELI: Të të lexosh ty, është si të vendosësh një letër kalk mbi një vizatim dhe t'ia hijezosh siluetën!

ELIRA: Atëherë, kur unë qenkam kaq e thjeshtë për ty dhe kaq e mirë sa përshkruan, pse nuk do të ma dhurosh këtë kënaqësi?

MIKELI: Ti kujton se në jetën time nuk e kam provuar edhe këtë gjë? Por jam i pafuqishëm, më beso! Nuk dua të kem mallkimet e një gruaje pas vetes vetëm e vetëm sepse ajo është nëna e fëmijës tim! Ajo duhej të meritonte gjithçka, por unë, me tipin që kam, do t'ia shuaja të gjitha ëndrrat. Ç'do të fitonte

ajo prej meje më pas? Vetmi? Frikë? Nostalgji? Nëse iluzionet dhe ëndrrat shuhen, dashuria merr fund! Ky është fataliteti i ndjenjave të njëanshme ashtu siç i ke ti tani për mua *(ndryshon zërin duke shprehur sa dhembshuri, aq edhe pendesë)* Unë nuk është se s'të dua ty, por unë i dua të gjitha me të njëjtën forcë, veçse në forma të ndryshme! Nuk do të isha kurrë i gjithi i yti, ashtu siç ti dëshiron! Unë nuk dua që ti të vuash për mua, e kupton?

ELIRA: Po ti e kupton se më je kthyer në obsesion?

MIKELI: E di! Këtë kam patur frikë gjithmonë. Jam përpjekur të të mbaj larg, por ti je posesive, ti kërkon që të më zotërosh e të më nënshtrosh. Mos kujto se nuk jam ndjerë dikur dhe unë si ty! Kush është ai që nuk e ka ndjerë veten të dashuruar qoftë dhe për një herë në jetën e tij? *(Sheh nga rruga. Dridhet)* E keqja është se sa më shumë të largoj, ti më keq sillesh! Bën çmos të afrohesh. Bën çmos të më bindësh. Bën çmos të më mbushësh mendjen!!!

ELIRA: Ti kujton se unë të sillem si dikush që nuk jam?

MIKELI: Jo!..

ELIRA: *(Duke qarë)* Ndihem e rrënuar. Nuk kam më fuqi. Besomë! Kam luftuar shumë me veten, por ajo ecën gjithmonë kundra meje. Çfarë ka lindur tek unë është më e fortë se çdo gjë që unë kam mundur të fitoj në jetë... Ti më rilinde! Më solle dëshirën për të rijetuar ëndrrat, ashtu si dikur, kur isha fëmijë...

MIKELI: Dakord, por ky nuk mund të jetë veçse një flirt idealist –

ELIRA: Gëzoj si fëmijë sa herë që mbrëmja kapërthen thonjtë në çarçafët e mi. Ledhatoj nënkresën duke shpresuar që një ditë ti do të mund të ndryshosh, të më dëshirosh, të më duash e të ndash me mua çdo gjë. Por ti sheh çarçafët e të

tjerave, kënaq epshet dhe tekat e tyre, i nginj me lekë e më pas kujton se lumturia jote i ka kapur të gjitha skajet. Por më thuaj, a munden vallë paratë të blejnë sinqeritetin dhe ndjenjat e tyre? *(Pauzë.)* Çdo natë ia bëj vetes këtë pyetje... *(Pauzë.)* Ti nuk je kurrë i imi. Ti po më shkatërron. Po më rrënon. Ti po luan me mua…

MIKELI: Jo, Elira, jo! Ti vetëm nuk më kupton sado që unë të të shpjegoj.

ELIRA: Sepse s'mundem të të kuptoj. Është e papranueshme për mua dhe logjikën time një karakter si i yti. Ti i lë varur të gjitha dhe je i gatshëm të përmbushësh tekat e të gjithave njëherësh. E ke menduar ndonjëherë veten të pafuqishëm?

MIKELI: Ti e di që mua nuk më bëjnë përshtypje këto gjëra!

ELIRA: Shumë e çuditshme !

MIKELI: S'ka rëndësi!

ELIRA: Çdo gjë e parëndësishme është po aq e rëndësishme sa e rëndësishmja, apo jo? Si ka mundësi që s'paska rëndësi tani, që po flet me mua?Apo mos vallë u shburrigesh qëllimisht pyetjeve të mia duke u kapur vetëm në atë që ty të intereson?

MIKELI: Të gjithë kështu bëjnë. *(Pauzë.)* Ajo që mua më çudit me ty, është se asnjëherë nuk të kam keqpërdorur. Asnjëherë s'të jam hequr ndryshe nga ky që jam. Asnjëherë s'të kam fshehur gjë. Asnjëherë s'të kam kërkuar të bëje diçka për mua, madje, as të më doje!

ELIRA: Ç'fatalitet të të duash ty! Më thuaj pra, si mund të të largoj nga jeta ime?

MIKELI: Duke mos menduar më për mua!

ELIRA : Ahh, sikur të mundja! *(E rrënuar)*

MIKELI: Pikërisht këtu qëndron problemi!

ELIRA: *(Pa ia vënë veshin)* Sa më shumë të shaj, aq më

shumë të ndjej; sa më shumë të kam inat, aq më shumë të dëshiroj; sa më shumë të zhgënjehem, aq më shumë të kërkoj… Çfarë dreqin po ndodh as unë nuk e kuptoj?! O Zot sa dua të të urrej!!!…

MIKELI: Të më urresh? Ajo arrin të shkatërrojë edhe një kolos, ndërsa ti do ta injektosh në trupin tënd të brishtë?!

ELIRA: Po. Dua të të urrej! Ti po më shkatërron. Ky është një fatalitet i trishtë! I mërzitshëm. I kobshëm. Nuk kam më fuqi. Nuk kam më nerva të merrem me asgjë. *(Pauzë.)*

Do të doja të isha një strehë për ty, por -

MIKELI: *(I frikësuar, por dhe i mallëngjyer)* Mirë, Elirë! Do e provojmë! Vetëm qetësohu! Unë nuk dua të vuash për mua!

(Elira vë buzën në gaz. Mikeli i fshin lotët me gishtat e mëdhenj. E përqafon.

Në derë shfaqet pronari i lokalit, Petriti. Mikeli sheh vështrimin e sertë të syve të tij. Përpiqet të marrë mesazhin e tyre. Depërton shikimin drejt syve të tij. Njëherë sheh të majtin, njëherë të djathtin. Petriti i bën me shenjë që të shkojë pas banakut. Mikeli tund kokën. I drejtohet Elirës...)

MIKELI: Ah, më duhet të largohem, pasi kam pak punë.

ELIRA: Sa herë do më ndodhë diçka e bukur, duhet të zhbëhet në moment!

MIKELI: Kjo është mëse normale! Mos harro të marrësh anën pozitive të gjërave! *(Me të qeshur)* Njëqind herë ta kam thënë!

(Elira e shpullon në sup. Çohet, e puth në ballë dhe drejtohet drejt daljes.)

MIKELI: Edhe mos e braktis më mësimin, se do të jetë vonë kur të pendohesh!

(Elira nënqësh dhe ikën. Mikeli shkon nga banaku, i bën shenje kamarierit, porosit një Albratos tjetër dhe ulet në tavolinën e tij.

Petriti afrohet.)

MIKELI: Ku humbe? Kam gjithë ditën që të pres këtu!

PETRITI: Isha për qitje pra.

MIKELI: Për qitje bufash, ë?!

PETRITI: Po pra...

MIKELI: Si doli rezultati?

PETRITI: Keq! Shumë keq! Situatë e keqe është. Nuk e di si do t'ia bëj!

MIKELI: Duhet marrë risku përsipër.

PETRITI: Tallu ti, tallu. E pse nuk vjen të bashkosh riskun tënd me mua?

MIKELI: Po ti e di arsyen pse! Pastaj, ti vetë doje që ta bëje. Unë jo më kot ndenja jashtë loje. E dija se si shkonin këto punë. Kam vënë mend nga to. Më mirë ato që ke t'i kesh për vete se sa të kesh kokën në trastë gjithë kohës si ty!

PETRITI: Eh, ke të drejtë! Edhe mua më ka ardhur shpirti në majë të hundës! Do të shoh ç'do të bëj ndonjë gjë nga politika. Të paktën ajo dihet që është zanati i të paaftit! Të premtoj që kjo do të jetë hera e fundit!

MIKELI: Ti premton ndaj meje, ashtu si premtoj unë ndaj tyre...

PETRITI: Kujt?

MIKELI: Femrave! ...

PETRITI: Ç'të bëj, Mikel?! Kështu është këtu. Po nuk more përsipër punë të tilla, paraja s'të vjen kurrë. Çfarë kujton ti, se ky lokal ka fitime? Me këto çmime? Po të mos kisha bërë këto punë të vogla e me leverdi, sot jo lokal që s'do të kisha, por do isha aty, në ndonjë cep rruge duke kërkuar lëmoshë.

MIKELI: Çdo gjë ka fitim nëse e shfrytëzon ashtu si duhet, sado e vështirë të jetë !

PETRITI: *(Duke parë orën)* Ika tani, nuk kam më kohë. Do flasim kur të kthehem në darkë!

MIKELI: Bukur! *(Pauzë.)* Shpresa vdes e fundit! *(Pauzë.)* Kurajo! *(Me zë të ulët)* Këto punë kështu e duan, ndryshe ngelesh me gisht në gojë gjithë jetën!

PETRITI: Po atë kam frikë dhe unë, pse ç'kujtove ti? *(Çohet nga tavolina dhe drejtohet me të shpejtë nga dera)*

(Në derë shfaqet Najada. Petriti risheh orën. Trembet. Merr një shprehje të vrenjtur në fytyrë, përshëndet Mikelin me kokë dhe largohet me të shpejtë. Rrugës përplaset me Najadën.)

NAJADA: Avash ore zotëri!

PETRITI: Ehu, e keni në terezi juve! –

NAJADA: *(Me ironi)* Më falni mua pra, që ju preva rrugën!

PETRITI: *(I nervozuar*) Ohu, e paske në terezi ti!

(Najada e sheh me qesëndi. Hedh sytë përreth. Sheh Mikelin dhe shkon ulet në tavolinën e tij.)

NAJADA: Huh, a nuk ishte ky miku yt? Ai që më prezantove pak më parë?

MIKELI: *(Duke nënqeshur)* Po.

(Najada sheh me inat nga dera.)

MIKELI: Mos ia vër re. Ishte me nxitim. Kishte punë dhe e prisnin.

NAJADA: Të besoj!...

(Mikeli e sheh me admirim. Najada flirton në vështrimin e tij.)

MIKELI: U çmërzite?

(Najada pohon me krye.)

MIKELI: Ndonjëherë njerëzit nuk mendojnë se sa i lëndojnë të tjerët.

NAJADA: Nuk mund të them se ishte lëndim, sesa ofendim. Duket sikur çdo gjë ecën mbrapsht në këtë vend. A s'të duket kështu dhe ty?

(Balerina shfaqet në skenë duke bërë lëvizjet e saj)

MIKELI: Ndonjëherë po, ndonjëherë mendoj se kështu kemi dashur të jemi, ose sepse kështu jemi mësuar të jemi!

NAJADA: Ç'do të thuash?

MIKELI: Se shoqëria nuk është si individi, që t'i pranojë gjërat lehtë… sidomos këtu, ku mbizotëron një mentalitet i vjetër, anakronik, i ashpër dhe i ngujuar në muzgun e vet!

NAJADA: Sa bukur që flet! Ah, sikur të gjithë të kishin botëkuptimet e tua –

MIKELI: Nuk e di nëse do të ishte më mirë apo më keq! Çdo shoqëri ka anët e mira, ashtu si dhe të ligat. Ajo që vlen për mua është të përcaktohet cila do të ishte e mira dhe cila jo, çfarë ka nevojë të futet brenda dhe anasjelltas, por duke analizuar shumë faktorë, mbi të gjitha mentalitetin mbizotërues!

Gabimi ynë ishte se, sapo na zgjidhën zinxhirët, ia morëm vrapit nëpër botë pa patur as më të voglën ide se si ishte jeta aty. Si do të mund të përballonim gjithë vështirësitë?!

(Balerina bën shenja vaji)

Menduam se bota do të na priste krahëhapur!

(Pauzë.)

Ajo që mua më vret është burriia jonë për të rrëmbyer gjithçka TË HUAJ pa pyetur për asnjë pasojë që lind prej saj! Ne duam ta sundojmë botën, edhe pse nuk jemi të sigurt se jemi duke e sunduar dhe vetveten!

(Najada tund kokën.)

MIKELI: *(I menduar)* Më pëlqejnë ndryshimet që janë bërë, por janë ndryshime të shtirura, sepse në thelb, asgjë nuk ka

ndryshuar! Më kupton?

(Najada pohon me krye...)

MIKELI: U bëmë të babëzitur, zemër, të babëzitur. Pasuria na errësoi sytë. Shitëm gjithçka për ta fituar, gjithçka, madje dhe shpirtin, e sot nuk dimë se si t'u shburrigemi gabimeve tona... –

NAJADA: Të kuptoj!

MIKELI: Për ta thënë sa më shkurt, jemi ata që vazhdojmë t'i qeshemi tragjedisë sonë!

NAJADA: E ç'duhet të bëjmë, Mikel? Si mendon?!

MIKELI: Hiç! Rrimë këtu, e shtiremi sikur gjithçka shkon fjollë...

NAJADA: *(Nënqesh)*: Sa vëzhgues i hollë që je!

(Pauzë.)

MIKELI: Të bën jeta zemër. *(Pauzë.)* Më trego diçka për veten...

NAJADA: Për shembull?!

MIKELI: *(Duke qeshur)* Për shembull, se sa më do ti mua!

NAJADA: *(Me nënqeshje)* Ouuu!

MIKELI: *(Duke u tallur)* Si ouu? Femrat aty në Itali linin kokën për mua!

NAJADA: Vërtet?

MIKELI: Normale. Pse të mos e linin? I bukur po, simpatik po, seksi po, i ëmbël me to po, me lekë po... Ç'do të dëshironte një femër më shumë se kaq? Një 'shenjt' me këmbë të drejta, ende i ri, ende idiot – sipas Niçes kjo!

NAJADA: *(Qesh)* Me sa duket, i ke të gjitha.

MIKELI: Askush nuk i ka të gjitha! Askush!

NAJADA: Po pate paranë, çdo gjë është e lehtë!

MIKELI: Paraja nuk është gjithçka!

NAJADA: Nuk e di! Varet se si e sheh jetën! Varet se si ajo të merr! Familja ime do ta kishte të pamundur sikur unë të mos punoja. Babai mori rrugën e mërgimit, por që prej atëherë nuk e kam parë më kurrë! Nuk e di nëse është gjallë apo i vdekur. Nëna është më shumë e sëmurë, se sa e shëruar. Asistenca e shtetit nuk mjaftonte për të. Mos pyesni më pas për mungesat...

MIKELI: *(Me keqardhje)* Të kuptoj.

NAJADA: Nuk e di pse, por sot paskam dëshirë të flas!

MIKELI: Edhe unë çuditërisht kam dëshirë të dëgjoj. Ndonjëherë, kur dëgjojmë për vuajtjet e të tjerëve, bëhemi më të fortë në vetvete dhe më optimistë!

(Najada nënqesh)

NAJADA: Dashuria ime e parë mban emrin zhgënjim, e dyta, trishtim; e treta vetmi, e katërta një kryq të madh të shënuar para kohe duke ditur rrjedhën e të parave! Besimi im ka vdekur me kohë! E delikatesa? Nuk e di nëse është e varur diku tek unë! Kam ndryshuar! Nuk jam më ajo vajza e brishtë, që bëhej keq kur shihte dikë të vuante! Qëkur kapitalizmi shkeli në këtë tokë, njerëzit mësuan se ç'ishte festa e karnavaleve!

(Balerina bënë veprime që shprehin kondradiksionin)

Që atëherë nuk sheh tjetër veçse disa maska që ecin rrugëve me pardesynë e drejtësisë! Bota u bë vrastare! Ose të paktën, kështu më duket mua! Edhe sa do të vazhdojë kështu?

(Balerina largohet nga skena)

MIKELI: Të kuptoj!

NAJADA: As vetë nuk e di se pse po t'i them ty të gjitha këto! Mbase sepse ti mundesh të më kuptosh! Ose mbase sepse ti më bën të ndjehem mirë!

MIKELI: Ç'rëndësi ka?

NAJADA: Ke të drejtë! Por ti je shumë i mirë me mua! Unë kam frikë...

MIKELI: Frikë përse?

NAJADA: Frikë nga ndjenja! Frikë se mos gropos sërish vetveten si njëherë e një kohe! Dua të iki që këtu, Mikel! Është një botë shumë e keqe! Dua të iki diku, ku të paktën të kem mundësinë të jetoj jetën time si të dua, pa thashethemet, pa intriga, pa marrëzira e hipokrizi! Jam lodhur duke u përplasur sa andej-këtej!

MIKELI: *(Mendueshëm.)* Kërkoj ndjesë nëse indirekt të kam lënduar.

NAJADA: Përkundrazi, më bëri mirë të mendoj më tepër për veten time! E vlerësoj!

MIKELI: Më vjen mirë.

(Najada nënqesh.)

MIKELI: Po afrohet hëna – bukuroshja e heshtur.

(Najada sheh nga qielli.)

NAJADA: Recituesja e ëndrrave...

MIKELI: Dashnorja e Erosit.

NAJADA: Jo, Psika ishte e tillë!

MIKELI: Psika është mitologjikisht, Hëna realisht. *(Pauzë.)* Hëna, një ditë duke flirtuar me të, pa dijeninë e Psikes, i vodhi çelësat e pasionit... –

NAJADA: Hahaha...

MIKELI: Por duke qenë se Dielli do të xhelozohej dhe do ta dënonte për tradhti, ajo preferon që ai të largohet pak dhe kur të mos ta ketë mendjen, të flirtojë me Erosin në distancë. Ke dëgjuar për dashurinë platonike?

NAJADA: Po...

MIKELI: *(Pa ia vënë veshin)* Një ditë, Platoni e vuri re se ç'pisllëqe bënin ata të dy, një në Tokë e një në ajër, dhe e firmosi këtë lloj të ri pasioni si dashuri platonike.

(Najada qesh.)

NAJADA: O Zot i madh! *(Pauzë.)* Po ti me kë po flirton që po ia nxjerr këto sekrete?

MIKELI: Me Psikën.

(Najada qesh.)

MIKELI: Ja, shiko ç'bëre? E trembe zemrën time!

(Najada qesh.)

(Mikeli qesh.)

NAJADA: Në dashuri je e verbër, në tradhti syshqiponjë!

MIKELI: Ti në cilën anë bën pjesë?

(Najada e gjuan në sup.)

NAJADA: Nuk e di. As që dua ta di! Jam egoiste në këto raste! Mjafton që unë të ndjehem mirë, pak rëndësi ka për të tjerët! Megjithëse, të them të drejtën, më vjen pak keq për atë vajzën, Elira sikur quhej, apo jo?

MIKELI: Po, Elira! Hmmm... Elira, pavarësisht se hiqet si femër mondane, në të vërtetë është e kundërta e saj. Ajo ëndërron për një familje, gjë që unë nuk mund t'ia jap, sepse ajo dhe unë jemi si Horusi me Setin (*dita me natën*). Me një fjalë ka të gjitha anët pozitive që tek unë janë negative dhe anasjelltas. Do thuash ti se dy magnete me pole të kundërta tërhiqen? Vë bast se tek njerëzit ndodh e kundërta.

(Najada qesh.)

NAJADA: Ajo mbase dyshon tek unë! Mbase i dukej sikur ia mora të dashurin! A s'të dukej dhe ty kështu deshifrimi i

buzëqeshjeve të saj të shtirura?

MIKELI: Ahh! Mos harro.. *(me zë të ulët)* Në dashuri je e verbër.. ti sapo e the!

NAJADA: Po, saktë. *(duke u shtirur)* Hmmm ... Ndjehem në faj..

MIKELI: Eh... pasioni nuk të pyet! Ai jeton dhe me dashurinë, edhe me tradhtinë. Është relativ, i ndryshueshëm, i ëmbël dhe i ashpër!

NAJADA: Pasioni është thesar.

MIKELI: Hmmm

Është këmba e zbathur,

që rërën e njomur shkel,

e dallgën fton që ta rrëmbejë...

(Najada mban veshin me dorë. Dëgjon fëshfëritjet e gjetheve të pemëve. Mikeli i afrohet. Hyn Elira. (Ata puthen) Elira nervozohet. Ata nuk e vënë re.)

NAJADA: Është ëndërr a realitet?

MIKELI: Realitet... *(zgërdhihet)*

(Elira sheh me inat. Ata vazhdojnë të mos e vënë re)

(Mikeli bëhet gati t'i dhurojë Najadës një tjetër puthje dhe shtang kur pas xhamave risheh hijen e së panjohurës. Njëkohësisht dhe Elirën e rishfaqur në derë. Nuk di ç'të bëjë. Një lëmsh i mblidhet në grykë e mezi gëlltitet. Najada kthen kokën dhe e sheh e frikësuar. Të dy duken të tmerruar!)

(Elira sheh Najadën dhe Mikelin që qëndrojnë të heshtur dhe të përqafuar. Heshtja e tyre e acaron.)

ELIRA: *(Duke bërtitur)* A mundet ndonjëri prej jush të

shfaqë mirësinë e tij katran, e të më thotë se çfarë po ndodh?

MIKELI: Asgjë e jashtëzakonshme!

ELIRA: *(E habitur)* Asgjë?!

MIKELI: Ti e di që unë...

ELIRA: Më premtove!

MIKELI: Edhe ti...!

ELIRA: Unë?

MIKELI: Po... ti! A nuk më the se doje ta provoje?

ELIRA: Po të thashë, por –

MIKELI: Atëherë? Unë ky jam! E ti këtë e di! Çfarë dreqin kërkon që rri me një mashkull si unë?

ELIRA: Nuk ishte faji yt. ËSHTË FAJI I SAJ!

MIKELI: Askush nuk ka faj, e dashur!

ELIRA: Hë?!

MIKELI: Pasioni është pasion, e dashur, asgjë më shumë. Dëshirë e shfrenuar për të gëzuar një copëz çast...

ELIRA: Dëshirë e shfrenuar për të lënduar në çdo çast...

MIKELI: Varet nga këndvështrimi që e sheh.

ELIRA: *(Me qesëndi)* Ah po, ke të drejtë! Duhet ta shoh me sy eksitues faktin që i dashuri puth një femër tjetër në sytë e mi... madje jo vetëm kaq, por duhet t'i them dhe faleminderit. Ose akoma dhe më bukur, asaj femre duhet t'i them 'Hajde, e dashur dhe fli me ne'.

MIKELI: S'do ishte keq.

ELIRA: *(Me inat)* O Zot i madh!

MIKELI: S'e ke provuar ndonjëherë sa bukur është, prandaj flet kështu.

ELIRA: *(Me ironi)* E ke provuar ti për të gjithë.

MIKELI: Po të më jepej sërish rasti, s'do thoja jo.

ELIRA: Hajde civilizim, hajde!

MIKELI: Janë obligime jete, e dashur!

ELIRA: Obligime të bukura paske!

(Kthehet me sillë nga Najada)

E ti? *(Najada fshihet pas shpinës së Mikelit.)*

Elira kërkon ta gjuajë. Mikeli e mbron me duar. Najada nxjerr pak kokën. Elira e mat mirë dhe bën ta godasë, por shpulla i bie Mikelit në faqe.)

ELIRA: Nuk e kisha për ty! Lëshoje!

(Najada bën të shfaqë kokën, Elira matet, shpulla bie mbi faqen tjetër të Mikelit.)

ELIRA: Lëshoje të thashë!

MIKELI: Nëse të bën të ndihesh më mirë duke shpullisur të tjerët, atëherë më godit mua!

ELIRA: Largohu të thashë!

MIKELI: Jo!

ELIRA: Përse ma bëre këtë, Mikel? Përse? *(I gjuan me shpullë nga faqja e parë)*

MIKELI: Sepse nuk varet nga unë!

ELIRA: Po nga kush? *(I gjuan me shpullë nga faqja tjetër)*

MIKELI: Ah, ju femrat..! Më mahnisni!

(Prapë shpullë!)

ELIRA: Gënjeshtar!

MIKELI: Më beso! S'po të gënjej! *(Pauzë.)*

(Elira matet ta gjuajë. Fokusohet në sytë e tij. Trembet. E ul pëllëmbën drejt tokës)

ELIRA: Kjo nuk të shfajëson as ty dhe as atë, Mikel! *(Pauzë.)*

Më thuaj, kush vallë ishte shkaktar? Kush vallë më gënjeu? Kush m'i tha ato fjalë?

NAJADA: Hëna!

ELIRA: Mashtruesja!

(Pauzë.)

MIKELI: Nuk ke pse qorton kë nuk ka as gojë!

ELIRA: Kush hesht, për mua, mbart krime mortorë...

MIKELI: E ç'të duhet ty? Ç'të interesojnë?

ELIRA: Duhet një fajtor, ndryshe s'kam si rroj!

MIKELI: Fajtori jam unë, a të qetëson?

ELIRA: Qetëson egon time, por kjo më mundon...

MIKELI: Çfarë mundem të bëj që mos të të mundoj?

ELIRA: Më puth, më jep shpresë, më premto! ME DASHURO!...

(Mikeli e puth)

NAJADA: Ti e puthe atë?

(Mikeli e puth Najadën)

ELIRA: Zot i madh! Kjo s'durohet!

(Mikeli bën ta puthë, Elira e gjuan me shpullë.)

MIKELI: Nuk bëhet me dhunë, Elira!

ELIRA: I pashpirt!

NAJADA: Më puth Mikel, më puth!

ELIRA: Bushtër!

NAJADA: Të duash nuk është mëkat! *(me epsh i drejtohet Mikelit*) Mikel –

(Mikeli e puth.)

ELIRA: Hipokrit! I pacipë! I pamoral!

(Mikeli bën ta puthë, ajo e gjuan me shpullë.)

NAJADA: Mikel –

(Mikeli kthehet, e puth.)

ELIRA: Ç'mund të pres prej teje? Të njoha mirë kush je!

(Mikeli s'ia vë veshin, vazhdon të puthë Najadën.

Elira nevrikoset. E kap për krahu Najadën. Muzika (Wolfgang Amadeus Mozart Summer Ouverture - Requiem For A Dream) në sfond. Ato të dyja zihen me gjeste. Mikeli rri spektator.)

Akti III

(Mikeli i dehur rri ulur në banak duke pirë një shishe birrë. Kamarieri bën sehir. Mikeli ka pamje të trishtuar. Kamarieri e sheh i habitur. Mikeli sheh orën. Kamarieri sheh Mikelin.)

MIKELI: Epo, mjaft më pe!

(Kamarieri vazhdon ta shohë. Bie zilja.

Mikeli fut dorën në xhepin e xhaketës. Kontrollon. Nuk gjen gjë. Fut dorën nga xhepi tjetër i xhaketës. Kontrollon. Nuk gjen gjë. Çohet. Fut dorën në xhepin e pantallonave. Kontrollon. Nuk gjen gjë. Fut dorën në xhepin tjetër të pantallonave. Kontrollon. Nuk gjen gjë. Sheh vërdallë. Kamarieri sheh banakun. Mikeli sheh kamarierin. Zilja pushon së rëni. Mikeli sheh banakun. Gjen me sy telefonin. E sheh. Zilja bie sërish. E merr në dorë. E sheh. Bën të shtypë Yes, nuk e shtyp dot. I thotë kamarierit ta shtypë dhe e vë në vesh.)

MIKELI: E dashur. Si je? (*Pëshpërin*) Unë... hiç. (*Heshtje*) Kam patur shumë shumë punë sot (*shkund jakën e këmishës*). Mezi mora frymë vetëm tani (*heq telefonin nga veshi. I bën një shenjë pakënaqësie kamarierit. Vë telefonin në vesh*). Si, si? Jo jo, nuk të thashë për sot! Mos vallë e harrove? Nuk e mbaj mend

unë? Si, si? Dëshiron të dish rezultatin e betejës? (*habitet*) Nuk kam qenë në luftë. Lufta ka mbaruar këtu e para se të shihja unë dritën e diellit. Ah, po! Jo, jo! (*largon telefonin nga veshi. Bën sikur kap mizat. I bie me shpullë banakut. Vë telefonin në vesh)*. Po pse bëhesh naive kur s'je?! *(Pauzë.)* Si? Jo, s'e di. Hë, hë, ma thuaj. (*Pauzë.*) Ta marr vetë me mend? Hahaha (*largon telefonin nga veshi. Sheh kamarierin gjithë trishtim. Vë telefonin në vesh*). Nuk e di. *(Pauzë.)* Ke të drejtë! Të paparashikueshme fare jeni! Do interesohem nëse do të mund të gjej një degë 'Parashikimi i gjendjes shpirtërore femërore për ditën e sotme'. Të pëlqen, hë?! *(Pauzë.)* Oh, ok, baby! Më prit se edhe mund të vij! Si si? Jam rrufjan? Hahahahahaha.

Fik telefonin. E vë në banak.

Sheh kamarierin gjithë trishtim. Kamarieri sheh i lodhur Mikelin. Bie zilja.

Mikeli sheh kamarierin. Humbet tek shikimi i tij. Kamarieri i bën me shenjë telefonin. Mikeli pohon me krye. Merr telefonin. E sheh. E vendos në banak. Kamarieri i bën me shenjë ta hapë. Mikeli tund kokën në shenjë mospranimi. Kamarieri i shtyp Yes dhe ia vendos në vesh.

MIKELI: E dashur. Si je? *(heq telefonin nga veshi. Sheh kamarierin me trishtim. Kamarieri ngre kryet*) Po, po. Jam shumë i lodhur. Ah! Nuk besoj se do vij. Po erdha, do të të marr në telefon. *(Heq telefonin nga veshi. Bën blla blla në ajër. Vendos telefonin në vesh*) Po jam i lodhur, moj zemër. Ç'ke ti, takohemi nesër. Si? Në të njëjtin vend? Mirë. Hajde pra, se flasim nesër. Natën zemër. *(E fik telefonin me të shpejtë)*

MIKELI: Ç'paskan qenë! –

(Bën të ngrejë shishen e birrës. Bie telefoni. Lë birrën në vend. Sheh kamarierin. Kamarieri rrudh kryet. Mikeli mohon me kokë. Kamarieri pohon me krye. Mikeli rrudh buzët. Kamarieri merr telefonin në dorë. E sheh. Shtyp Yes dhe ia vendos në vesh Mikelit.

Mikeli e merr në dorën e vet telefonin.)

MIKELI: E dashur. Si je? *(Heq telefonin nga veshi. E kap me të dyja duart. E shkund në ajër. E vendos prapë në vesh*) Po. Kam pak punë. *(E heq nga veshi. Sheh kamarierin. Kamarieri rrudh vetullat. E vendos prapë në vesh*) Po kam punë o njeri. *(Pauzë.)* E pse bërtet? *(Pauzë.)* Po. Sigurisht e dashur. Unë nuk të kam gënjyer asnjëherë. Ti e di këtë. Je jeta ime! *(Heq telefonin nga veshi. E shkund në ajër me nervozizëm. E vendos në vesh*) Zemër. *(Heq telefonin. Shkund në ajër. Sheh kamarierin. Kamarieri zgërdhihet. Mikeli inatoset. Vë telefonin në vesh*) Zemër, do dëgjosh apo të të dëgjoj? *(Pauzë.)* Mirë, po të dëgjoj! Fol... *(I bie me mollëzat e gishtërinjve banakut. Fillon të nervozohet.)* Mbarove? Mirë... *(E sheh me inat celularin. E vendos në vesh sërish)* Mirë, mirë, se do flasim. *(Me ton nervoz*) Hajde se shihemi nesër!

(E mbyll telefonin. Sheh nga kamarieri. Kamarieri fillon të qeshë. Mikeli fillon të zgërdhihet për inerci.)

MIKELI: Po ti, non stop punoke sot?

KAMARIERI: Po pres pronarin të zbresë që t'i jap xhiron e ditës.

MIKELI: Ah! Po!... Pritje pritje pa kufi.. pritje pritje pa mbarim.. Kur do përfundojnë pritjet? *(Pauzë.)* Meqë ra fjala, lart është ai? Si nuk e vura re kur hyri?

(Kamarieri mbledh supet. Bie zilja e telefonit. Mikeli shtang. Kamarieri s'e bën të gjatë. I vë telefonin në vesh. Mikeli hutohet. Nervozohet. Nuk kthen përgjigje. Hesht. Acarohet! Dëgjon receptorin. Shtang. Habitet. Nuk gjen dot zë t'i përgjigjet. Mbledh veten. Përqendrohet! E fik fare telefonin.)

MIKELI: Si nuk pyesin fare per privatësi, xhanëm?!

KAMARIERI: Eh...

MIKELI: Po ç'u kam bërë, o vlla?

KAMARIERI: (*Me ironi*): Hiç.

MIKELI: *(Pa ia vënë veshin*) : I dua, me shpirt, por jo kështu! Ka kufi çdo gjë! Më ke parë t'i jem lutur ndonjërës? Jo?! E pra! Vetë e kërkojnë! Pastaj bëjnë si hijena në telefon.

(Kamarieri pohon me kokë.)

MIKELI: E di si bëhem ndonjëherë apo jo? Më vjen të zhdukem një orë e më parë që këtu. Ja, kështu më vjen!

KAMARIERI: Të besoj! Me atë skenë që pashë sot...

MIKELI: Ajo s'është asgjë. Ka edhe më keq...

KAMARIERI: Vërtet?

MIKELI: Sigurish, po nejse.. Kalon shpejt. Sapo qetësohen, marrin prapë në telefon...Ndonjëherë qajnë, ndonjëherë qeshin; ndonjëherë as ne nuk e kuptojmë çfarë bluan mendja e tyre. Janë një labirint i vërtetë. Po hyre brenda tyre, jo vetëm që nuk do të gjesh më derë nga të dalësh, po do të mbetesh ndonjëherë edhe i gjakosur, ose do përplasesh me ndonjë skelet si puna jote (zgërdhihet), ose ose, do të mendosh se ke kohë që ia ke kthyer patkonjtë diellit. Do të duash të ecësh, por nuk do mundesh, do duash të klithësh e s'do nxjerrësh zë. Çdo gjë që sheh aty është një parajsë e ferr të lidhur ngushtë me nyjet e bukurisë dhe hijeshisë. Kjo është arsyeja që më pëlqen të jem vetëm një kalimtar i rastit, t'i salutoj ato mrekulli, e të largohem një orë e më parë në rrugën time...

(Mikeli sheh telefonin. Dridhet. Kamarieri e sheh dhe zgërdhihet.)

MIKELI: Qesh qesh, por as ti nuk bën përjashtim në këtë rast. Më sill një gotë ujë të lutem, se as birra s'po më bën derburri sot!

KAMARIERI: Patjetër!

(Mikeli kruan kokën. Vendos mollëzat e gishtave në tëmtha dhe i shtrëngon. Mbyll sytë. Ekuilibron veten. Ndihet i çlodhur. Heq duart nga tëmthat. Kamarieri i shërben një gotë ujë.)

MIKELI: Faleminderit. E di që e teproj ndonjëherë me pijen dhe ... *(Pauzë)* femrat, por kurrë nuk e kaloj limitin e limitit të limitit njerëzor. Më pëlqen kufiri. Ç'nostalgji! Gjithmonë të ecësh në një vijë të drejtë, të lëmuar, shpëtimtare! Në një vijë ku janë caktuar limitet e ëndrrës dhe realitetit, të jetës e vdekjes, të tokës dhe qiellit. Është vija që tregon shkathtësinë e një njeriu, suksesin e tij, realizimin e çdo ëndrre. Vija që të bën të burriovrosh gabimet e tua dhe të mos biesh kurrë në depresion.

(Në skenë shfaqet balerina)

KAMARIERI: Dëshironi gjë tjetër?

MIKELI: (*Pa ia vënë veshin*) Më kujtohet si tani, kur u largova për herë të parë në Itali, me gomonen e një vlonjati. Kohë të arta. Nuk kthehen më. Sa bukur dukej deti natën. Të dukej sikur nga momenti në moment do të të përpinin dallgët e do të të çonin brenda, në zemrën e detit. Por, me sa duket, janë të rrallë ata që e kanë atë fat!

KAMARIERI: E pse fat?

MIKELI: Të jetosh në zemrën e detit është fat i rrallë! Trupi yt nuk dekompozohet kurrë pa dalë në sipërfaqe. Ai ruan freskinë deri në momentin kur peshkaqenët fillojnë ta shqyejnë. Ç'kënaqësi!

Kamarieri: Kënaqësi?

MIKELI: Sigurisht! Të ndryshosh kahun e anijes "JETË" është arritje e madhe!

KAMARIERI: Hmmm...

MIKELI: Të dalësh kundër të vjetrës është hapi i parë drejt modernizmit!

KAMARIERI: Ouuu!

MIKELI: Të përqafosh imoralitetin do të thotë të thyesh kufijtë e morales...

KAMARIERI: Edhe?

MIKELI: E kufijtë e moralitetit vjetërojnë...

KAMARIERI: Ëhë...

MIKELI: Ata duhet të burgosen...

(Kamarieri duke dashur të flasë)

MIKELI: Të zhduken e të balsamosen nëpër mauzole.

(Kamarieri matet të flasë)

MIKELI: Vlefshmëria e të cilave qëndron vetëm për të krijuar imazhin e evoluimit të njerëzve në kohë. Për asgjë tjetër. ASGJË!

Kamarieri: Zotëri!...

MIKELI: *(Pa ia vënë veshin*): Po kur njeriu jeton bashkë me të vjetrën, çfarë do të bëjë? Do të bëhet një mumje e gjallë që do të ecë rrugëve të një qyteti të vdekur. Moderniteti...

(Mikeli hesht. Gëlltitet. Merr frymë thellë)

Moderniteti ka etapat e veta. Duhet të ketë forcë të shkelë mbi tabutë që kanë forcuar rrënjët e tyre në njerëzim. Këto të gjitha duken absurde për momentin, ashtu siç mund të duken absurde më vonë ato që sot duken krejt normale. Është pikërisht KOHA ajo që i jep apo i heq shijen gjithçkaje. Është ecja me ritmin e saj; kur ti ecën ngadalë, ndihesh i qetë, por një ditë kupton se nuk ke bërë asgjë, e do të ndjesh brejtjen e ndërgjegjes nga duart e zhgënjimit. Kur ti ecën shpejt, ndihesh i lodhur, i shfrytëzuar, i pakënaqur kurrë me atë çka bën. *(Pauzë.)* Kur do të ketë pak paqe? Gjithmonë e pyes veten. Përgjigjja ndjek rrugën e retorikës. Gjithçka i nënshtrohet asaj.

(Kamarieri tund kokën.)

MIKELI: Ndonjëherë më vjen të qesh me predikimet që bëjnë njerëzit. Paqe, dashuri, harmoni e prosperitet! – thonë të

gjithë. Por sa mund të arrihen të gjitha këto? Ç'fatalitet jetësor! Asnjëra nuk arrihet, asnjëra nuk gëzohet, secila është hyjnore, por jo tokësore! *(Pauzë.)* Nuk e kuptoj pse njerëzit urojnë gjithmonë të arrish të paarritshmen!!!

KAMARIERI: Sepse të duan e duan të të shohin mirë.

MIKELI: Sepse janë të lodhur e duan të mendojnë se ato ende ekzistojnë! Janë skelete që ndjekin një proces të koburriduar ashtu siç mund të bëjë një robot mbi tokë. I ke vënë re si ecin rrugës? Të përhumbur! Të harruar! Të mallkuar!

(Një fëmijë shfaqet në derë me steka cigaresh për të shitur. Kamarieri përpiqet ta largojë.)

MIKELI: Mos e largo! Afrohu...

(Fëmija afrohet.)

MIKELI: Është vonë.

(Fëmija mbledh supet.)

MIKELI: Gjithë ditën këtë gjë bën?

(Fëmija pohon me krye.)

MIKELI: Po prindërit, ku janë?

FËMIJA: S'e di.

MKELI: Si s'e di? Je jetim?

FËMIJA: Jo.

MIKELI: Po çfarë...?

FËMIJA: Nëna shet aty, tek ajo tezga, babai…!

MIKELI: Babai?

(Fëmija hesht.)

MIKELI: Nuk e ke?

FËMIJA: Po, e kam. Babai do të vijë më vonë në shtëpi.

MIKELI: I dehur?

(Fëmija hesht.)

MIKELI: A punon babai?

(Fëmija hesht.)

MIKELI: Dhe ju gjithë ditën shisni rrugëve?

(Fëmija pohon me krye dhe kokën e ulur poshtë.)

MIKELI: Mirë mirë, merri këto të holla.

(Nga brenda dëgjohen zhurma. Najada del me vrull përjashta. Fëmija trembet! Merr të hollat dhe largohet.)

NAJADA: Unë një jetë kam!

PETRITI: Bushtër!

(Najada sheh Mikelin. Shtanget. Këmbët i dridhen. Rrobat vende-vende i ka të grisura. Syrin të enjtur. Përpiqet ta fshehë me flokë. Ulet në karrigen më të afërt që gjen.

Mikeli ngrihet nga tavolina. Sheh Petritin në sy. Petriti shfaq shenja shpërfilljeje.)

PETRITI: E ç'më sheh ashtu! Sikur ç'është! Dava kurve...

MIKELI: Ç'ngjau?

(Askush nuk flet. Mikeli i afrohet Najadës. I sheh syrin. Rrobat. Shtang.)

MIKELI: Kamarier, më sill një kompresë me akull. *(Kthehet nga Petriti)* Petrit?! Edhe këtë e paske bërë?

PETRITI: Ika unë tani, s'kam kohë! Kam punë për të mbaruar!

MIKELI: Nuk do të ikësh askund! Matu mirë para se të hedhësh hapin!

(Petriti ul kokën. Kërkon të thotë diçka, por fjala i mbetet në fyt. Mikeli drejtohet nga Najada.)

MIKELI: Të dhemb?

(Najada tund kokën.)

MIKELI: Pse ma ke fshehur këtë gjë? Pse nuk ke biseduar me mua?

NAJADA: Doja ta mbyllja në heshtje dhe pse e dija se do ta kisha të vështirë! Petriti ka qenë dashuria ime e parë, por më pas gjithçka -

PETRITI: E para thua ti!

NAJADA: *(E irrituar)* Po, e para! Si mundet vallë të mohosh ti që shkele pastërtinë time? Si mundet vallë ta mohosh ti, që në vend të më mbaje afër më mësove rrugën, një mënyrë të mirë për të bërë lekë ti, për t'u marrë mendjen horrave të tu, një mënyrë e mirë për të izoluar gojën e varfërisë time! Ti më përdore, por jo vetëm kaq, ke luajtur me mua në mënyrën më të shpifur!

PETRITI: Vetëm ti që s'duhet të kesh gojë të ankohesh! S'ke turp! Sigurova çdo gjë për jetën tënde, përfshi këtu edhe shpenzimet për nënën tënde të sëmurë, e ti më thuash se të paskam përdorur! I përdoruri këtu jam unë!

NAJADA: Turp? Turp duhet të kem, sepse të lashë ty të dorovitje trupin tim kësaj kafejene sa herë të të tekej ty! Turp? Po, është turp, sepse duhej të kisha refuzuar qysh në momentin e parë, por ti nuk më le shans, ti ma imponove! Apo e harrove dhe këtë?

PETRITI: Dëshira jote për të fituar lekë ishte më e madhe. Apo i harrove lutjet dhe të qarat e tua kur kishe nevojë për lekë? Apo e harrove momentin kur doje të hidhje dobiçin tënd në ferr? I harrove këto?

NAJADA: Petrit, nuk jam më ajo vajza e vogël që të bindej për çdo gjë që ti thoje, sepse ti për të ishe si një idhull... ishe një njeri që ajo i dedikonte falenderime kur e përdorte! Unë do të iki, do të largohem një orë e më parë që këtej, madje do të iki diku ku ti s'do të mundesh dot më të më gjesh!

(Petriti matet ta gjuajë sërish, por ndërhyn Mikeli. Ia kap dorën dhe e sheh në kokërr të syrit. Petriti shburriget.)

PETRITI: Herë tjetër në punët e mia mos ndërhy!

MIKELI: I forti e gjuan të dobëtin me mençuri, jo me dhunë Petrit!

PETRITI: Gruaja pa dajak bëhet si burri në mejhan!

MIKELI: Rri tani. Qetësohu, e boll më shite mend mua! Qëkur qenke bërë kaq i fortë ti? Apo kur vjen puna me femrat jemi gjithmonë plot energji?

(Petriti hesht. Najada ulet në një tavolinë. Kamarieri ka në dorë tundësen e frapesë. Brenda ka hedhur disa copa akulli dhe e shkund para fytyrës së Najadës. Merr peshqirin dhe hedh copat e akullit. Najada e sheh e çuditur. Kamarieri bën gati kompresën dhe ia vendos në sy.)

KAMARIERI: Mund t'ju shërbej me diçka tjetër, zonjushë?

NAJADA: Jo, falemnderit. Edhe kjo është tepër!

MIKELI: Deri këtu arrin të shkojë "krenaria" jote, Petrit?

PETRITI: Do më lësh rehat ti? Ik shiko hallin tënd, me këto gjëra merrem unë! S'e kuptoj pse po më hidhesh në fyt sikur çfarë kam bërë!

MIKELI: Sikur çfarë ke bërë?

PETRITI: Nejse!

(Mikeli e sheh gjithë inat. Ulet në tavolinë me Najadën.)

MIKELI: A je më mirë?

NAJADA: Do të isha sikur të isha sa më larg prej këtu!

MIKELI: Kjo dita e sotme më ters se e djeshmja. *(Balerina shfaqet në skenë duke bërë triket e saj; dora e majte kontradikton te djathten, dora e djathte kontradikton te majten dhe me pas largohet.)* Sa më shumë qëndroj këtu, aq më shumë më mbushet mendja të largohem përgjithmonë. Kur jam larg, më merr malli, dua të kthehem. Kur jam këtu, gjithçka fillon të zbehet, të venitet, të humbasë qoftë dhe dëshira për të jetuar. Ç'dreqin po ndodh me këtë vend?

NAJADA: Nuk të kërkova kot të largoheshim. Unë do të iki. Në mos sot, nesër do e gjej një mundësi. Ndërsa ti bëj si të duash...

MIKELI: Isha mirë para pak ditësh, gjithçka ecte normal, por këto ditë po bëhen të padurueshme. Këtu edhe sikur të duash të rrish, detyrohesh të largohesh. Por këto gjëra ajo Mira ime nuk i kupton.

NAJADA: Elira!

MIKELI: Ah! Po! As vetë s'e di pse nuk më fiksohet asnjëherë emri i saj! Çudi!

(Najada nënqesh për herë të parë pas gjithësa ndodhi.)

MIKELI: Nuk e kam parë fare këtë mbasdite. Asaj s'i rrihej pa ardhur.

(Mikeli çohet nga vendi. Shkon drejt dritareve për të parë nga rruga. Sigurohet që s'është askush dhe ulet në tavolinë.)

MIKELI: Kam frikë mos ka bërë ndonjë paudhësi! Asaj i është kthyer në obsesion qëndrimi me mua!

NAJADA: Çdo femër do ta dëshironte!

MIKELI: Dakord, por ajo e di se si jam unë! Ajo më pëlqen shumë, por unë nuk jam i qëndrueshëm. Unë e njoh veten time dhe nuk dua ta lëndoj! Por do ti që sot më la pas kësaj dritareje gjithë ditën si çilimi?

NAJADA: Besoj se të pëlqen natyra e saj, tepër e vendosur kur vjen puna në lidhje me ndjenjat.

MIKELI: E cili mashkull nuk do ta dëshironte një femër të butë e të ndjeshme si ajo?

NAJADA: Atëherë, pse nuk lidhesh me të, fejohu, martohu, bëj fëmijë dhe gëzo jetën si të gjithë.

MIKELI: Premtimi është premtim!

NAJADA: Për çfarë e ke fjalën?

MIKELI: Epo, kam dashur dhe unë dikur një vajzë, që ende më ka mbetur fiksim. Ngjante shumë me Elirën e sa herë dua

t'i shqiptoj emrin, më del automatikisht nga goja emri i saj. Edhe të dua mos ta kujtoj, vjen natyrshëm tek unë. Nuk dua të përsëritet i njëjti gabim! Më beso!

NAJADA: Ke dëshirë të flasësh për të? Ç'ndodhi? Pse u ndatë?

MIKELI: Sepse nuk e përballoi dot pritjen. Ishim larg njëri-tjetrit. Unë punoja gjithë ditën. Ajo mendonte gjithë natën. Në fund, u lodh së menduari dhe me një dorë ilaçesh i dha fund jetës... *(Pauzë.)* Nuk dua që Elira të pësojë të njëjtin fund. *(Pauzë.)* Jam në ankth.

NAJADA: Shkoji në shtëpi ose merre në telefon! Bëj diçka!

MIKELI: Nuk ma ka hapur telefonin gjithë mbasditen! As mesazheve të mia s'u është përgjigjur.

NAJADA: Ndihem në faj! Po të mos isha unë dhe burriia ime e çuditshme, do të ishit bashkë. Megjithëse, unë ende ndjej për ty dhe nuk po tallesha aspak pak më parë. Por pas kësaj që ndodhi, nuk do të mund të ndjehem e lirë nga e kaluara...

MIKELI: Mos e mendo më! Le të jemi dy shokë të mirë dhe kaq.

(Najada buzëqesh. Në derë shfaqet Elira. Ajo është e dehur. Sheh nga Petriti, i shkon pranë dhe e puth në faqe. Sheh Najadën teksa e vështron dhe i imiton ecjen. Mikeli ngrihet në këmbë gjithë ankth. Elira ec dhe këmbët i ngatërrohen. Fillon të qeshë. Sapo bëhet të bjerë, e kap Mikeli dhe e mban fort me duar. Elira e puth. Ngrihet këmbë. Përpiqet të fitojë drejtpeshimin. Shkon tek banaku dhe puth dhe kamarierin. Ndërkohë Petriti është duke i bërë me shenjë kamarierit për t'i dhënë ndihmë.)

ELIRA: Kështu të pëlqejnë femrat ty Mikel? (qesh)

MIKELI: Qenke dehur!

ELIRA: Nuk të pëlqen? Femër moderne, s'ka fjalë!

MIKELI:Ç'kërkon të thuash me këtë?

Elira: Hiç!

(Elira e sheh Mikelin të mërzitur e tepër serioz dhe qesh. Afrohet tek dritarja. Sheh lart nga qielli. Humbet shikimin e saj në Hënë dhe yje. Zgjat dorën t'i prekë. Bën sikur i ledhaton. Vendos dorën në zemër. Ndjen dhimbjen e saj. Mendohet dhe sheh Hënën sërish...)

ELIRA: 'Hëna bëhet diell, diell .. DIELL'? Po unë pse nuk të shoh ashtu? Ti nuk më ke falur kurrë ngrohtësi. Je shumë e ftohtë për mua, Hëna ime. Je e trishtë. *(Pauzë. Mikeli përpiqet ta ulë në karrige, por ajo sa ulet, çohet menjëherë pa ia ndarë sytë Hënës.)*

A nuk është e çuditshme ideja se ngrohja globale sa vjen dhe rritet, ndërsa njerëzit bëhen gjithmonë e më të ftohtë?! *(Pauzë.)*

(Petriti e dëgjon dhe gëlltitet me zor.)

MIKELI: Po, ashtu është, po hajde ulu.

ELIRA: *(Pa ia vënë veshin)* Pse vallë, kur dielli puth zenitin, ne bëhemi të ftohtë, të egër, të ashpër,... harrojmë ekzistencën tonë dhe zhytemi në monotoninë e jetës?! *(Pauzë.)* Ndërsa kur ti, Hëna ime, që veten ha mes dhëmbësh për çdo krim, fillon të shfaqesh në horizont, ne fillojmë të mbushemi me mall, nostalgji, trishtim, dashuri... flirtojmë me kujtimet, ëndrrat apo mashtrimet... Mbushim shpirtin e boshatisur të ditës me iluzionin tënd të natës. Përse? *(Pauzë)* Pse vallë jemi në një përpjesëtim kaq të zhdrejtë me ngrohtësinë qiellore?

MIKELI: Sepse kjo është jeta, zemër. E njëjtë për të gjithë!

ELIRA: *(Pa ia vënë veshin)* Pse vallë njerëzit kanë harruar të dashurojnë?

MIKELI: Jo zemër jo, por secili dashuron sipas mënyrës së vet!

ELIRA: *(Pa ia vënë veshin, duke vazhduar bisedën me hënën)*

Pse vallë janë bërë kaq të pandjeshëm ndaj thirrjeve të shpirtit? Dikur ka qenë ndryshe, apo jo? Mos vallë vrapimi ynë drejt rrugëve të botës filloi të ftohë edhe ndjenjat tona? *(Pauzë.)*

Hapat tanë rrahin shkujdesshëm trotuaret çdo çast, por ne, kurrë nuk i numërojmë. Kemi harruar t'i numërojmë. *(Pauzë.)*

MIKELI: Sepse koha ka përshpejtuar ritmin e saj. Sepse ne ia përshpejtuam këtë ritëm asaj!

ELIRA: Nuk e kuptoj pse të dua ty. *(Kthen vështrimin nga Mikeli)* Pse më mundon mungesa jote? Kur jam me ty irritohem, zemërohem, trishtohem. *(Duke vendosur dorën në zemër)*

MIKELI: Hmm... Mirë... Hajde të shkojmë në shtëpi!

ELIRA: Në shtëpi? Hahaha! Tek cila shtëpi? Te ajo me kangjella apo tek ajo pa kangjella?

MIKELI: Tek ajo pa kangjella!

ELIRA: Po pastaj?

MIKELI: Pastaj do të dalim bashkë... unë dhe ti.

ELIRA: Ti më gënjen!

MIKELI: Jo, aspak!

ELIRA: Po ajo? *(Duke treguar me gisht Najadën dhe duke imituar ecjen e saj delikate.)*

MIKELI: *(Duke hedhur vështrimin jashtë)* Ajo do të ikë larg, shumë larg. Ndërsa unë dhe ti do të jemi bashkë. Hajde çohu! Ikim!

ELIRA: Kujton se jam e dehur? *(Duke iu marrë këmbët)*

MIKELI: Jo, aspak! Po hajde, ikim tani?

Elira: Hahahahhahahaah! (bënë sikur ka një pistoletë në dorë dhe bërtet) Pauuuuuuuuu!

MIKELI: E paske me bubullima të pirën ti! Hajde pra të ikim... hajde pra...

(Mikeli afrohet ta marrë për krahu Elirën, kurse ajo i kthehet e irrituar)

ELIRA: Po pastaj? Pastaj do të kalojmë dhe një natë të ëmbël e cila 'aksidentalisht' nuk do të të bjerë më në mend të nesërmen... Ndërsa Hëna *(duke e parë me xhelozi)* do të studiojë me imtësi lëvizjet tona. Do t'i shkruajë dhe në një ditar, e të nesërmen, ashtu si dhe ti, do të shtiret se s'ka parë asgjë!

MIKELI: Hajde ikim tani!

ELIRA: Jam e lodhur! E rrënuar! E kupton?!

MIKELI: Po, e kuptoj!

(Në derë shfaqet e panjohura e cila mban në dorë një pistoletë.)

E PANJOHURA: Kujtove se do ia hidhje lehtë? Jam unë! Vajza jote e ëndrrave! E mban mend si më braktise? I mban mend premtimet? Nuk kishte femër në botë që do të mund të më zëvendësonte! Apo jo?

MIKELI: Mira? Ti je?

(E panjohura hesht dhe përpiqet të mbulojë fytyrën me tylin e zi.)

MIKELI: *(I habitur)* Nuk ka mundësi! Të njëjtët sy! I njëjti shikim! Të njëjtat mollëza të ëmbla! Ti je MIRA! Mira ime!

(Ai bën ta përqafojë. Ajo i drejton pistoletën dhe i bën me shenjë të zmbrapset.)

E PANJOHURA: Mira... Mira... Mira... Mirën e qava qëmoti, por kjo ka pak rëndësi për kriminelë si puna jote *(drejton më e vendosur pistoletën drejt tij)*

(Najada klith dhe struket pas Petritit. Kamarieri e sheh dhe shkon mbrapa banakut ku është dhe telefoni. Elira qesh, përpiqet të ruajë seriozitetin, por nuk mundet. Mikeli i tronditur.)

KAMARIERI: *(Me zë të ulët)* Policia, policia, hajdeni, shpejt! Po, po, tek "Blue Star"! Shpejt, ju lutem!

MIKELI: Prit...-

E PANJOHURA: Prit? Kam pritur shumë për këtë çast, ku ti duhet të paguash për mjerimin tonë! *(Pauzë.)* Humba jetën time! Frutin tonë! U rrit pa nënë dhe pa baba! Vallë këtë meritoja?

(Sheh nga Elira. Mikeli ndjek me dyshim shikimin e të panjohurës dhe përfundon tek Elira. Elira sheh nga të dy dhe qesh me të madhe. Mikeli shokohet).

MIKELI: Jooo! Mos ma thuaj këtë!!!

E PANJOHURA: Isha e pafuqishme të dëgjoja thashethemet dhe intrigat e njerëzve! Aq më tepër që ti mungoje... gjithmonë mungoje!

MIKELI: Mira?!

E PANJOHURA: Por ti vazhdoje të luaje me femrat e tjera pa patur as interesin më të vogël për mua dhe frutin tënd. Në çastin më të vështirë ti na braktise! Ndërsa kur gjithçka kishte përfunduar, befas, u shfaqe! Por ç'vlerë kishte ardhja jote më pas?

MIKELI: Përse nuk ma ke thënë këtë gjë?

(Mikeli shtrëngon kraharorin. Ndjen dhimbje. Sheh nga e panjohura dhe nuk u beson syve. Sheh nga Elira dhe fillon t'i merret fryma.)

E PANJOHURA: Nuk ta kam thënë? *(Pauzë.)* Ti doje vetëm veten tënde! U bëre egoist. Braktise gjithçka me shpresën se një ditë do të ishe i pasur, do të fitoje milionat e tua të fëlliqura, që tashmë nuk e vë në dyshim që i ke.

MIKELI: *(Duke vazhduar të shtrëngojë kraharorin)* Më thuaj se nuk është e vërtetë!

E PANJOHURA: Sikur! Kam kohë që ju ruaj. *(E përlotur)* U përpoqa t'ju ndaloja jo pak herë, duke tërhequr vëmendjen tuaj, por nuk gjeja fuqi për t'u përballur! Tashmë s'ka më vlerë!

(Mikeli shtrëngon kraharorin gjithmonë e më shumë. Sheh

Elirën dhe ndjen dhimbshuri. Sheh Mirën dhe ndjehet fajtor.)

MIKELI: Mjaft! Të lutem, mjaft!

E PANJOHURA: Të vret e vërteta?!

MIKELI: Më vret sekreti që ti fshehe ndaj meje!

E PANJOHURA: Të vret gënjeshtra që ti fshehe për shumë kohë! Ajo e cila bëri të mos dije të vërtetën!

MIKELI: Për çfarë e ke fjalën?

E PANJOHURA: Po po! Ti e di mirë për çfarë po flas!

MIKELI: S'po të kuptoj!

E PANJOHURA: Gjatë gjithë kësaj kohe të kam parë mirë se sa bukur je sjellë! E ç'mund të mendoja tjetër veçse kisha shërbyer si një lojë në dorën tënde?

MIKELI: Gabon! Unë të kam dashur dhe prapë të dua!

E PANJOHURA: Gënjeshtar! Kujton se të besoj?

MIKELI: Vërtet!

(Mikeli dhe e panjohura shihen sy më sy. Ajo heq sytë nga ai dhe sheh nga pistoleta. Duke qarë e drejton ndaj Mikelit. Duart i dridhen.)

MIKELI: Qetësohu!

E PANJOHURA: Të kujtohet si më the dikur? Çdo fillim e ka dhe një fund!

(Ajo drejton dorën për ta qëlluar Mikelin, por ai turret vrap dhe e përqafon. Ajo e grushton dhe kërkon të largohet prej tij, ndërsa ai nuk ia heq duart. Dëgjohet arma të shkrehet. Të dy ngelën pa frymë dhe me fytyrë të tronditur. Najada, Petriti dhe kamarieri klithin "MOS" njëzëri. E panjohura bie në gjunjë dhe më pas në tokë. Mikeli sheh duart e tij me gjak dhe ende nuk po merr vesh çfarë ndodhi.)

MIKELI: (Duke parë Mirën) MOS!!!

(Bie mbi trupin e saj dhe fillon të qajë. Dëgjohen sirenat e policisë që afrohen gjithmonë e më shumë. Të panjohurës i bie

nga dora fotografia. Elira e sheh dhe e merr në duar.)

ELIRA: Uaaa! Po kjo jam unë!

(Mikeli kthen kokën drejt saj)

ELIRA: Ç'është kjo? Ti ia ke dhënë?

(Mikeli sheh nga Mira dhe vazhdon të qajë. Është i pafjalë. Të gjithë janë të heshtur. Elira rrëmbehet dhe fillon të hedhe të gjitha karriget dhe tavolinat përtokë me inat.)

ELIRA: Të poshtër! Kriminelë! Mashtrues!

(Mikeli e sheh dhe vendos dorën në kraharor. Sheh nga pistoleta. E merr dhe kërkon ta mbushë. Elira e sheh dhe klith...)

ELIRA: MOS!!! Mos ma bëj këtë! Si mund të jetoj pa ty?

(Policia mbërrin. Shohin Mikelin me pistoletë në dorë dhe i drejtojnë pistoletat ndaj tij.)

POLICIA: Ndal! Mos bëjë asnjë veprim.

(Ai i sheh. Lë pistoletën në tokë dhe nxjerr duart para.

Elira fillon të qajë. Kamarieri i shkon pranë. Ndërkohë policët kërkojnë të marrin Mikelin dhe t'i vënë prangat. Mikeli nuk bënë asnjë shenjë proteste.)

ELIRA: (Ndjek me sy Mikelin, e frikësuar, dhe fillon të qajë) Ndalni! Nuk është faji i tij! (Nuk e vrau ai atë!)

MIKELI: *(Duke e parë me dhembshuri.)* Çdo fillim ka dhe një fund, Elira! Përpiqu të mësohesh me këtë tani! *(Duke u drejtuar nga policët.)* Shkojmë!

(Elira do të shkëputet nga krahët e kamarierit, por nuk mundet. Petriti dhe Najada vazhdojnë të rrinë në këmbë të heshtur, duke parë nga e panjohura e shtrirë përdhe dhe duke përcjellë me sy Mikelin që janë duke e marrë policët.)

ELIRA: Ç'vlerë ka jeta?

KAMARIERI: Jeta do të ketë sërish të njëjtën ecje.

ELIRA: Pa Mikelin?

KAMARIERI: Po. Pa Mikelin!

(Kamarieri e ka ulur në prehër dhe i ledhaton kokën, teksa ajo ka vendosur kokën tek qafa e tij.)

ELIRA: A do të ketë diell nesër?

KAMARIERI: Po, një diell të shndritshëm, si dhe sot.

ELIRA: Të ngrohtë?

KAMARIERI: Dielli gjithmonë është i ngrohtë!

ELIRA: Po hënë?

KAMARIERI: Po, edhe hënë...

ELIRA: Kam ftohtë!

(Kamarieri e ngjesh më fort pas gjoksit. Balerina shfaqet në skenë duke e përshkruar me një hap të shlirshëm. Këtë radhë fytyra e saj nuk është e lyer me bojë...)

(Bie perdja)